

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 81-të i botimit
Nr.12



SHTABI I PËRGJITHSHËM

Gjeneralmajor Jeronim Bazo,
kreu i ri i ushtarakëve shqiptarë

INTERVISTA

- 13** Gjeneral Hodges: Kur shikoj një ushtar shqiptar, shikoj një ushtar të NATO-s

BASHKËPUNIMI

- 15** KLSM, vlerësime dhe sugjerime nga pjesëmarrësit

STUDIMI

- 24** Doktoratura e Marenglenit, dhuratë për Shtetin...

KULTURË

- 41** "Himni Kombëtar", tashmë edhe në faqet e një studimi...

STAFI

Drejtor i Publikimeve:
Lavdrim LITA

Kryeredaktor:
Albert HITOALIAJ

Gazetarë:
Alba MUSARAJ
Leonard QUKU
Ermal Kaçaniku

Redaktore korrektore:
Elona Shimaj Mako

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Shtypur në shtypshkronjën:
"Kristalina KH"



4 SHPFA

Merr detyrën shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm të FA

Në mesditën e datës 8 nëntor 2013, në Ministrinë e Mbrojtjes u zhvillua ceremonia e marrjes...



6 KREMTIMI

101-vjetori i krijimit të Forcave të Armatosura shqiptare


Ministria Kodheli: Mbetem besimplotë se të gjithë gratë dhe burrat me uniformë, kudo ku ata shërbejnë...



8 KRONIKA

Kryeministri Rama viziton Forcat e Armatosura

Paraditen e datës 11 nëntor 2013, kryeministri i Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, bëri një vizitë në FA...



30 SPECIALE

Të rikthejmë librin në bibliotekat ushtarake

Konferenca për librin dhe bibliotekat që organizoi QLMI i ngjan këmbanave të alarmit...

Sfidat e pritshme të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo

Gjeneralmajor Jeronim Bazo është Shef i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura i 24-t në historinë 101 vjeçare të Shtetit Shqiptar. Gjeneralmajor Bazo prej 28 vitesh shërben me devotshmëri dhe ka spikatur gjatë gjithë karrierës së tij të nisur në pragun e shkollës “Skënderbej”. Në fjalimin e parë si kreu i FA gjeneralmajor Bazo ka deklaruar se, “Objektivi kryesor si Shef i Shtabit të Përgjithshëm, do të jetë frymëzimi i çdo anëtari të Forcave të Armatosura me një qëllim të qartë e një dëshirë të zjarrtë për të dhënë maksimumin dhe për t’u bërë më të mirët e asaj çka ata mund të jenë”. Padyshim sfidat që aktualisht përballemi janë të një spektri të gjerë që lidhen me stërvitjen, pajisjen, modernizimin, përmbushja e detyrimeve ndaj NATO-s si dhe kontributit në Operacione dhe në ndihmë të popullsisë. Por në këtë kuadër, qëllimi SHSHP të FA-së është arritja e nivelit më të lartë të mundshëm të përgatitjes individuale dhe aftësive praktike në të gjithë spektrin e Forcave të Armatosura. “Përmbushja e detyrimeve kushtetuese por edhe atyre të NATO-s në kushtet e vështirësive financiare, përbën një sfidë të veçantë. Iniciativa e NATO-s “për të bërë më shumë me më pak” apo “Smart Defence”, mund të përbëjë një shembull shumë të mirë për të rritur bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e misioneve të përbashkëta kushtetuese, ndërkohë që duhet të rritet edhe “llogaridhënia” dhe transparencja për veprimet e ndërmarrja”, bëhet me dije nga zyrat e Shtabit të Përgjithshëm. Po ashtu modernizimi i forcave tona, si pjesë përbërëse e Planit Afatgjatë koherent, do të kërkojë një planifikim të mirë të kostove të menaxhimit të ciklit jetësor, kërkesat për trajnime, aftësitë mirëmbajtëse dhe riparuese si dhe shumë faktorë të tjerë të spektrit të menaxhimit. Ky planëzim duhet të jetë gjithëpërfshirës, i koordinuar dhe me prioritetet që do të fokusohen në rritjen e aftësive të Forcave të Armatosura. “Objektiva e Kapaciteteve, një detyrim ndaj NATO-s, së bashku me dhënien e kontributeve për operacionet e drejtuara nga Aleanca, janë parë si sfidat dhe detyrimet më të rëndësishme në planin afatmesëm e afatgjatë të zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Kjo, jo vetëm për faktin e vërtetimit të “besueshmërisë” në sytë e Aleancës, por edhe sepse përmbushja e këtyre detyrimeve i shërben Shqipërisë dhe FARSH në realizimin e misionit të tyre kushtetues, kjo në bazë edhe të konceptit “single set of forces” që ne përdorim. Pra, përmbushja e tyre, e bën Shqipërinë një aleat më të besueshëm dhe për më tepër më të ndërveprueshëm për Aleancën, me qëllim që kjo e fundit të arrijë Nivelin e saj



Lavdrim Lita
Drejtor

të Ambicies”, thekson zyra e Shtabit të Përgjithshëm të FA. Padyshim vazhdimi i angazhimit të FARSH-it në operacione të ndryshme jashtë vendit ka qenë një ndër prioritetet dhe arritjet më të dukshme gjatë këtyre viteve. Ndërkohë, angazhimi i FARSH, do të vazhdojë edhe pas tërheqjes së NATO-s nga Afganistani, në mbështetje të operacionit “Resolute support”. “Ne do të vijojmë të menaxhojmë burimet njerëzore në mënyrë koherente e të përherëshme, duke përgatitur politika e metoda që përmirësojnë aftësitë e çdo pjesëtari të Forcave të Armatosura. Kjo do të mbështetet në një sistem të mirëorganizuar, transparent, dhe llogaridhënës. Ngritja e forcës tërësisht profesionale është një hap domethënës në modernizimin e Forcave të Armatosura. Transformimi në një organizim tërësisht profesionist ka një ndikim pothuajse në të gjithë aspektin e jetës ushtarake. Ai siguron mundësi të reja që deri tani nuk kanë ekzistuar për përmirësimin e trajnimit dhe përmbushjen e misionit në nivele më të larta për individët edhe njësitë”, garanton Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneralmajor Jeronim Bazo. Gjithashtu Forcat e Armatosura, në mbështetje edhe të misionit të tyre kushtetues, janë vazhdimi të angazhuara në operacione në ndihmë të popullsisë. Në fund të mesazhit zyra e Shtabit të Përgjithshëm bën me dije se Gjeneralmajor Jeronim Bazo i përket atij lloji ushtarakësh që besojnë fort në maksimumin që u mësohet kadetëve të rinj qyshse hyjnë për të shërbyer në FA. Ajo thotë pak a shumë se “lidërshipi ndërtohet mbi besim dhe besimi ndërtohet mbi nder!”. Besoj fort!

SHTABI I PËRGJITHSHËM

Merr detyrën shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm të FA

Në mesditën e datës 8 nëntor 2013, në Ministrinë e Mbrojtjes u zhvillua ceremonia e marrjes së detyrës nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneralmajor Jeronim Bazo, i cili u dekretua nga presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm: ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, gjeneralë, drejtorë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Forcave të Armatosura. Ceremonia ka nisur me pritjen me truproje nderi dhe kalimin në revistë nderi të ministres së Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe gjeneralmajor Xhemal Gjunksi. Më pas, ministrja e Mbrojtjes, znj. Kodheli, lexoi dekretin e presidentit të Republikës, z. Bujar Nishani, për emërimin në detyrën e shefit të

Shtabit të Përgjithshëm të gjeneralmajor Jeronim Bazo. Ceremonia ka vijuar me ceremonia-lin e dorëzimit nga gjeneralmajor Xhemal Gjunksi, të flamurit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ministres së Mbrojtjes Kodheli, e cila ia dorëzoi shefit të ri të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Në përfundim të ceremonisë përshëndetën të pranishmit gjeneralmajor Xhemal Gjunksi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Jeronim Bazo.

**Jetëshkrimi i SHSHPFA,
gjeneralmajor Jeronim Bazo**

Gjeneralmajor Jeronim Bazo është diplomuar në Akademinë Ushtarake "Skënderbej", në Tiranë, Shqipëri dhe është titulluar oficer aktiv





i Forcave të Armatosura në vitin 1985. Gjatë viteve të para të karrierës së tij, ai ka shërbyer si komandant toge, komandant kompanie, zëvendëskomandant batalioni dhe instruktor në Shkollën e Trupës.

Gjeneralmajor Bazo ka shërbyer si shef Sektori në Drejtorinë e Personelit, në Ministrinë e Mbrojtjes në periudhën 1993-1995. Në vitin 1996, ai u diplomua nga Qendra Europiane për Studimet e Sigurisë, "George C. Marshall", për Studime mbi Sigurinë dhe Ekonominë e Mbrojtjes. Më pas, ai ka shërbyer si shef i Drejtorisë së sapokrijuar për Sigurinë Kombëtare në Akademinë e Mbrojtjes.

Prej vitit 1997-2000, gjeneralmajor Bazo ka kryer detyrën si oficer ndërlidhës me NATO në Ministrinë e Mbrojtjes. Një vit më pas, ai u emërua komandant i Akademisë së Nënoficerëve, ku ai shërbeu deri në tetor të vitit 2002. Në vitin 2003, ai u komandua në Akademinë e Mbrojtjes duke udhëhequr përpjekjet për të transformuar shkollën ushtarake pasuniversitare në Universitet Ushtarak. Ai kreu detyrën e komandantit të Universitetit Ushtarakë deri në qershor të vitit 2005.

Në vitin 2007, gjeneralmajor Bazo u ngarkua për të planifikuar dhe iniciuar Kursin e Lartë Rajonal për Studimet e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Pjesëmarrja ndërkombëtare në këtë kurs mbështeti përpjekjet shqiptare dhe ato të vendeve të tjera të rajonit për t'u bërë anëtarë të NATO në vitin 2009.

Gjatë periudhës 2010-2012, gjeneralmajor Bazo drejtoi Drejtorinë e Planifikimit të Mbrojtjes dhe Monitorimit (J-5) në Shtabin e Përgjithshëm. Kjo ishte një periudhë e rëndësishme për FARSH, si anëtar i ri i NATO. Gjatë drejtimit të tij, janë përbushur një numër i madhe detyrash, të cilat kanë qenë momente themelore për integrimin e plotë në NATO.

Disa prej tyre kanë qenë, zbatimi i strukturës së re të FARSH, konferencat e integritit Shqipëri-NATO, paraqitja e Studimit të Planifikimit të Kapaciteteve të Mbrojtjes, konsultimet/takimet dypalëshe dhe shumëpalëshe Shqipëri-NATO, Konferencat e Transformimit me NATO dhe takimet e Komitetit Ushtarak të NATO në formatin e SHSHP.

Gjeneralmajor Bazo është diplomuar, në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm nga Kolegji Ushtarak i Ushtrisë së SHBA, klasa e vitit 2006, master shkencor në Studime Strategjike.

Gjithashtu, ai ka marrë pjesë, ka kontribuar dhe ka mbajtur kumtesa në shumë konferenca dhe grupe pune kryesisht për çështje të Mbrojtjes, Sigurisë dhe Arsimimit. Gjeneralmajor Bazo ka publikuar artikuj në gazeta dhe revista të specializuara dhe është autor e bashkautor në shumë shkrime dhe artikuj.

Gjatë karrierës së tij, gjeneralmajor Bazo u gradua kapiten në vitin 1991, major në vitin 1994, nënkolonel në vitin 1995 dhe kolonel në vitin 2006. Ai u gradua me gradën gjeneral brigade në vitin 2012 dhe kreu detyrën e këshilltarit për Mbrojtjen dhe Sigurinë të presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Së fundi, me dekret të presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 8372, ai u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe u gradua me gradën gjeneralmajor.

Gjatë karrierës së tij, për punë dhe kontribute të shquara, gjeneralmajor Bazo është vlerësuar me dekorata të ndryshme, përfshirë edhe Medaljen Ushtarake të Meritës dhe urdhra të tjerë.

Gjeneralmajor Bazo është i martuar dhe ka dy fëmijë.

101-vjetori i krijimit të Forcave të Armatosura shqiptare

Ministrja Kodheli: Mbetem besimplotë se të gjithë gratë dhe burrat me uniformë, kudo ku ata shërbejnë, nuk do të reshtin asnjë çast përpjekjet për të arritur standardet më të larta, për ta bërë Forcën tonë të Armatosur pjesë dinjitoze të Aleancës



Paraditen e dates 4 dhjetor, në sallën e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua një konferencë solemne me rastin e 101-vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Më 4 dhejtor të vitit historik 1912, pak ditë pasi patrioti i madh Ismail Qemali shpalli më 28 nëntor 1912 në Vlorë pavarësinë e Shqipërisë, u krijua edhe Ministria Kombëtare e Luftës, duke shënuar kështu edhe krijimin e Forcave të Armatosura shqiptare. Në këtë veprimtari ishin të pranishëm: ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, gjeneralë, drejtorë të drejtorive të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, si dhe ushtarakë të tjerë të lartë të Forcave të Armatosura. Gjithashtu ishin të ftuar dhe morën pjesë edhe ish-ministra të Mbrojtjes ndër vite, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, ushtarakë veteranë, si dhe mjaft të ftuar të tjerë. Në fjalën e hapjes që mbajti shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, u ndal në rrugën

101 vjeçare përmes së cilës kanë ecur FA shqiptare, në zhvillimet dhe reformimet që ato kanë pësuar ndër vite deri në ditët tona, ku ato janë bërë pjesë dhe janë integruar tërësisht në strukturat e NATO. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli duke përsëndetur në këtë përvjetor theksoi, se është një kënaqësi e veçantë, por njëkohësisht edhe privilegj për mua, t'u drejtohem sot në cilësinë e ministres së Mbrojtjes, me rastin e 101-vjetorit të krijimit të Forcave tona Armatosura. Pas 28 nëntorit 1912, dita kur Ismail Qemali së bashku me patriotët e tjerë themelues të shtetit të ri shqiptar, shpallën pavarësinë e Shqipërisë, 4 Dhjetori 1912, është data që shënon një ndër aktet më madhore në historinë e shtetit shqiptar, atë të krijimit të Ushtrisë Kombëtare. "Ne jemi të vetëdijshëm se çdo ditë që kalon e lartëson edhe më tepër atë akt patriotizmi, vendosmërie dhe mençurie në kujtesën tonë kombëtare, së bashku me atë gjeneratë atdhetarësh, të cilët në rrethana tepër të vështira ndërsa interesat jetike të kombit shqiptar ishin të kërcënuara, me besim të patundur në idenë e tyre madhështore, krijuan shtetin

e ri shqiptar, ngritën qeverinë e parë dhe Ministrinë Kombëtare të Luftës, duke i dhënë kësaj kombit shqiptar, shtetin e tyre të lirë, qeverinë dhe ushtrinë e tij”, nënvizoi znj. Kodheli.

Më tej, ministrja Kodheli vlerësoi lart rolin dhe kontributin e patriotëve të mëdhenj shqiptarë, duke theksuar se, burra shteti si Ismail Qemali, Mehmet Pashë Dërralla e shumë të tjerë, me vizionin dhe largpamësinë e tyre përcaktuan mbrojtjen dhe sigurinë si një çështje me rëndësi jetike për shtetin e sapoformuar. Të vetëdijshëm për rëndësinë e krijimit të instrumenteve mbrojtës të shtetit, që në mbledhjen e parë të qeverisë, ata shpallën formimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare.

Duke evakuar rrugën historike mëse një shekullorë të ushtrisë shqiptare, znj. Kodheli theksoi: “Në një shekull me histori të trazuar, ashtu si të gjitha institucionet e shtetit shqiptar, edhe ushtria është përballur me sfidat që ka ofruar koha. Në këtë ditë të veçantë, të gjithë shqiptarët bashkohen në falënderimin dhe mirënjohjen ndaj kontributit të gjithë atyre të cilët hodhën themelet dhe hapën rrugën e krijimit të ushtrisë moderne, që sakrifikuam gjithçka që shqiptarët sot të jetojnë të lirë, të barabartë mes të barabartëve”. 101 vjet më pas, ka vijuar më tej ajo, dita e Forcave të Armatosura përkujtohet në kushte krejt të ndryshme. Mbrojtja dhe siguria e vendit për herë të parë në histori është e garantuar. Që nga prilli 2009, Shqipëria është anëtare e Aleancës më të madhe politiko-ushtarake të kohëve moderne, NATO. Shqipëria, me politikën e saj largpamëse është shndërruar në një faktor të rëndësishëm të stabilitetit, paqes e sigurisë në rajon e më gjerë.

Në vijim, ministrja e Mbrojtjes Kodheli është ndalur në punën e bërë, përpjekjet dhe përkushtimin e vazhdueshëm gjatë këtyre 23 viteve të fundit në procesin e reformave për të ndërtuar një Forcë të Armatosur, të vogël në numër por profesioniste dhe efëcente, e aftë për të përmbushur misionin e saj kushtetues, përpjekje të cilat u kurorëzuan këtë vit me integrimin e plotë të tyre në strukturat e Aleancës. Në këtë kontekst, ajo ka vlerësuar rolin dhe kontributin e pazëvendësueshëm dhe u ka shprehur mirënjohjen e thellë qeverisë së SHBA dhe të gjithë aleatëve e partnerëve që kontribuuan për ristrukturimin dhe modernizimin e Forcave tona të Armatosura. Gjithashtu një përshëndetje dhe mirënjohje të veçantë znj. Kodheli u ka drejtuar kon-

tingjenteve të FA, të cilët kanë shërbyer dhe shërbejnë me përkushtim e dinjitet në operacionet e drejtuar nga NATO, ISAF në Afganistan dhe në KFOR Kosovë, si dhe në operacionin e drejtuar nga BE, Althea në Bosnje dhe Hercegovinë, duke i siguruar edhe njëherë se lidhshipi politik dhe ushtarak i Ministrisë së Mbrojtjes do të bëjë të gjitha përpjekjet që ata të kenë në dispozicion gjithçka të nevojshme për të qenë në lartësinë e misionit të tyre fisnik, në lartësinë e shërbimit dhe nderit që i bëjnë vendit.

Mbetem besimplotë, - ka theksuar më tej ministrja Kodheli, - se të gjithë gratë dhe burrat me uniformë, kudo ku ata shërbejnë, nuk do të reshtin asnjë çast përpjekjet për të arritur standardet më të larta, për ta bërë Forcën tonë të Armatosur pjesë dinjitoze të Aleancës. Ky angazhim i yni do të mundësojë kryerjen e një reforme të thellë në Forcat e Armatosura nga pikëpamja doktrinale, konceptuale dhe strukturore, me qëllim rritjen e profesionalizimit. Kjo reformë do të përfshijë rishikimin dhe rregullimin e legjislacionit dhe procedurave, zhvillimin profesional të shtabeve për të promovuar praktikën më të mira. Po ashtu, edukimi dhe trajnimi janë kyç për të ndërtuar kapacitete dhe transformuar institucionin e mbrojtjes. “Megjithë vështirësitë financiare të trashëguara, qeveria e re ka vullnet të palëkundur politik për të mbështetur këtë reformë të domosdoshme për Forcat tona të Armatosura. Vetëm në këtë mënyrë, historia e tyre në vitet e ardhshme do të jetë një histori suksesi. Ky është nderimi më i madh që ne u bëjmë të gjithë atyre që kanë kontribuar për t’i sjellë Forcat e Armatosura në stadin aktual të zhvillimit të tyre”, ka përfunduar fjalën e saj ministrja e Mbrojtjes Kodheli.

Në fund të këtij takimi, u bë promovimi i nënoficerit më të mirë për vitin 2013. Për herë të parë këtë vit trupa e nënoficerëve prej më se 2700 vetësh, iu nënshtrua një proces rigoroz përzgjedhjeje, ku në fund u përcaktuan 10 nënoficerët më të mirë nga të gjitha forcat dhe njësitë e tjera mbështetëse të FA. Nënoficeri më i mirë për vitin 2013 u shpall rreshter Albert Kuçaj, efektivi i Batalionit të Operacioneve Speciale. Me këtë rast ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli i dorëzoi nënoficerit Albert Kuçaj certifikatën “Nënoficeri më i mirë i vitit 2013”.

Burimi: mod.gov.al



Kryeministri Rama viziton Forcat e Armatosura

Paraditen e datës 11 nëntor 2013, kryeministri i Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, bëri një vizitë në Forcat e Armatosura. Me këtë rast në sheshin kryesor të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes u organizua një ceremoni e veçantë. Kryeministri Rama u prit me Truproje Nderi nga ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin komandantët e Forcave, gjeneralë dhe drejtorë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë, si dhe trupa ushtarakë të rreshtuara nga të gjitha llojet e Forcave. Pas ekzekutimit të Himnit Kombëtar, fjalën e mori shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Jeronim Bazo, i cili që në fillim theksoi se, ndihej i nderuar dhe privilegjuar që kishte marrë detyrën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA të vendit tonë dhe se këtë detyrë e kishte pranuar me ndjenjë përlulje, shprese dhe vendosmërie. Duke folur për procesin e integritimit në NATO, gjeneralmajor Bazo theksoi se, prej vitit 2009, Shqipëria ulet si anëtare me të drejta të plota në tryezën e Aleancës, ndërkohë që prej tetorit të këtij viti, FA finalizuan procesin e integritimit të plotë në këtë

organizëm. Gjeneralmajor Jeronim Bazo në fjalën e tij është ndalur edhe në çështje të tjera të rëndësishme si në menaxhimin e burimeve njerëzore, sistemin e edukimit dhe arsimimit, stërvitjen, modernizimin e mëtejshëm, etj. Më pas, të pranishmit në ceremoni i përshëndeti kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama. Ai garantoj të gjithë ushtarakët shqiptarë se qeveria që ai drejton do të bëjë të gjitha përpjekjet që Forcat e Armatosura shqiptare të kryejnë me sukses të plotë procesin e reformimit dhe modernizimit të tyre. Duke vlerësuar se nderi, përgjegjshmëria dhe merita janë themelore për të qenë pjesë e FA, kryeministri siguroi se përzgjedhja e shefit të ri të Shtabit të Përgjithshëm, është bërë me vëmendjen më të madhe, duke garantuar përmes figurës së tij, profesionalizëm dhe integritet të lartë në drejtimin e këtyre Forcave. Kryeministri Rama theksoi se qeveria shqiptare i jep rëndësi të posaçme partneritetit strategjik me SHBA. Për kryeministrin, mishërimi i këtij partneriteti në frontin e NATO, nga llogoret e Irakut dhe të Afganistanit, tek përpjekja për të çarmatosur pa luftë regjimin vrapar në Siri, është jo vetëm detyrim i patjetërsueshëm, por dhe burim krenarie për shqiptarët.





Ministrja Kodheli takon ministrin FSK-së, z. Agim Çeku

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, në datë 22 nëntor 2013, priti në një takim kortezie ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës z. Agim Çeku. Gjatë këtij takimi, ministrja Kodheli dhe ministri Çeku, diskutuan për fushat e bashkëpunimit mes dy vendeve tona, veçanërisht në atë të mbrojtjes. Bashkëbiseduesit u ndalën gjerësisht tek diskutimi i temave dhe çështjeve të cilat do të jenë pjesë e mbledhjes së përbashkët të dy qeverive, asaj të Kosovës dhe të Shqipërisë në javët në vijim. Të dy ministrat u angazhuan që të dy qeveritë të punojnë fort për të arritur të gjitha objektivat në kuadër të proceseve integruese të vendit.

FA marrin pjesë në aksionin kombëtar "Të pastrojmë Shqipërinë në një ditë"

Forcat e Armatosura, në datë 22 nëntor 2013 u përfshinë në aksionin kombëtar "Të pastrojmë Shqipërinë në një ditë". Me këtë rast, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli ishte pranë trupave dhe mjeteve të strukturave të Forcës Tokësore që u angazhuan për pastrimin e plazhit të Tales në Lezhë, ku është pritur nga komandanti i kësaj force, gjeneralmajor Zyber Dushku. Ministrja Kodheli është shprehur së në aksionin që po bëhet sot për pastrimin nga mbetjet e ndryshme, vërehet se në bregdetin tonë gjenden shumë mbetje të rrezikshme spitalore, jo vetëm për ambientin, por edhe për qytetarët. Sipas saj, këto mbetje vijnë përmes lumit Mat dhe përfundojnë në det. Në këtë aksion të madh kombëtar trupat, mjetet dhe pajisjet e strukturave të Forcave të Armatosura në përputhje me Planin e Veprimit, u angazhuan jo vetëm për pastrimin e vend-dislokimeve të tyre të përhershme, por në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor edhe për pastrimin e mjediseve të tjera publike në disa qytete dhe zona të vendit tonë. Kështu Forca Tokësore me mbi 500 forca dhe 24 mjete të ndryshme mori pjesë në mbështetje të Prefekturës së Shkodrës, duke u përqendruar sidomos përgjatë rrugës nacionale Lezhë - Shkodër dhe aksit tjetër rrugor Shëngjin

- Lezhë, si dhe të Prefekturës së Fierit dhe asaj të Beratit, kryesisht në akset rrugore Berat - Fier dhe Berat - Lushnjë. Baza Ajrore e Farkës mori pjesë me 60 forca dhe 4 mjete në mbështetje të komunës së Farkës në Tiranë, ndërsa mbi 80 forca dhe 15 mjete të ndryshme të Brigadës së Mbështetjes Rajonale vepruan në mbështetje të Prefekturës së Durrësit në rrugën Rinas - Krujë dhe përgjatë autostradës Durrës - Golem. Po kështu, Qendra e Stërvitjes në Bunavi u përfshi me forca dhe mjete në mbështetje të Prefekturës së Vlorës në rrugën Panaja -Komuna Qendër, Vlorë.

Përmbillet me sukses projekti i ripaketimit të lëndëve kimike

Në repartin ushtarak në Qafë Mollë është zhvilluar në datën 20 nëntor 2013 një ceremoni me rastin e përfundimit me sukses të fazës së parë të projektit të ripaketimit të lëndëve kimike. Në këtë ceremoni ishte e pranishme ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, ambasadori i OSBE në Tiranë, z. Florian Rauning, ambasadori i Republikës Çeke, z. Bronislava Tomasova, ambasadori i Spanjës, z. Rafael Tormo Perez, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Viktor Berdo, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, përfaqësues të Zyrës së CUBIC, si dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm.

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli në fjalën e saj, pasi ka falënderuar personelin që ka punuar për realizimin e këtij projekti, theksoi se, realizimi i projektit shënon një arritje tjetër në bashkëpunimin e frytshëm midis OSBE dhe Ministrisë së Mbrojtjes, bashkëpunim i cili ka filluar vite më parë. Duke folur më tej mbi rëndësinë e këtij projekti, ministrja Kodheli u shpreh se, në më pak se dy muaj OSBE dhe Ministria e Mbrojtjes përfunduan projektin, i cili synonte ripaketimin e materialeve të rrezikshme të gjendura në vende të ndryshme, si në Shkozë, Poliçan, Laboratorin Ushtarak në Tiranë, Gramsh, Elbasan dhe



momente të rëndësishme në bisedën me homologun e saj grek. Ajo kërkoi që qeveria e Athinës të krijojë lehtësira më të mëdha për emigrantët shqiptarë, të cilët jetojnë dhe punojnë në shtetin fqinj. "Dua të theksoj se edukimi është çështje bazike për mua. Ndaj duhet një vëmendje e veçantë për edukimin e fëmijëve të emigrantëve edhe në gjuhën shqipe". Ajo vlerësoi bashkëpunimin e ngushtë dhe kërkoi mbështetjen e Greqisë në perspektivën europiane të Shqipërisë. Një çështje tjetër e rëndësishme gjatë takimit ishte

Qafë Mollë. Me këtë rast, ajo ka shprehur një falënderim dhe mirënjohje të veçantë për ndihmën e dhënë nga vendet mike gjatë gjithë këtij procesi shumë të vështirë si: SHBA, Kanadaja, Zvicra, Republika Çeke, Turqia, Danimarka, Holanda, Finlanda, Gjermania, Greqia, Italia, Suedia dhe prezencën e OSBE në Shqipëri. Ndërsa ambasadori i OSBE Rauning theksoi se ky projekt, me planifikimin, zbatimin dhe rezultatet e tij, përbën një shembull të besimit reciprok dhe bashkëpunimit efektiv midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe prezencës së OSBE në Tiranë. Por, theksoi ai më tej, ky është vetëm hapi i parë, ne duhet të gjejmë një zgjidhje për shkatërrimin e këtyre kimikateve. "Aktualisht OSBE po kërkon një fond shtesë prej 250 mijë euro për t'i transportuar kimikatet tashmë të paketuara në mënyrë të sigurtë për t'u shkatërruar në impiantet e asgjësimit të kimikateve jashtë Shqipërisë. Këtë javë, disa ekspertë nga Vjena do të vijnë në Shqipëri për të ndihmuar që të përgatishim fazën e dytë të projektit", - është shprehur ambasadori Rauning. Ministria Kodheli, e shoqëruar nga ambasadorët dhe ushtarakët e lartë të FA, inspektuan nga afër mjediset e repartit dhe kontejnerët ku janë vendosur të paketuara lëndët kimike.

Ministrja Kodheli, takon ministrin e Mbrojtjes së Greqisë, Dimitrios Avramopoulos

Pasditën e datës 4 nëntor 2013, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli priti në një takim të veçantë ministrin e Mbrojtjes së Republikës së Greqisë, z. Dimitrios Avramopoulos, i cili ndodhet për një vizitë zyrtare në Shqipëri. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe ambasadori i Greqisë në Tiranë, z. Leonidas Rokanas. Gjatë takimit, ministrja Kodheli dhe homologu i saj grek Avramopoulos diskutuan rreth një sërë çështjesh të rëndësishme. Ministria Kodheli theksoi se, për ne është e rëndësishme që të instensifikojmë marrëdhëniet mes dy vendeve tona si fqinjë, por edhe si vende që kemi shumë të përbashkëta. Të zgjidhim ato çështje ende të pazgjidhura mes nesh dhe të shohim përpara për një të ardhme më të sigurtë, -është shprehur, ndër të tjera, znj. Kodheli. Në vijim, ministrja e Mbrojtjes Kodheli u ndal në tre

edhe ajo e toponimeve, për të cilën ministria Kodheli mori garancinë e Avramopoulos se po punohet për zgjidhjen e saj sa më shpejt dhe në mënyrë përfundimtare. Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes i Greqisë, z. Dimitrios Avramopoulos, ka falenderuar ministrin Kodheli për pritjen që i rezervoi dhe nënvizoi mbështetjen e plotë të qeverisë greke për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. "Ne kemi qënë mbështetësi juaj për anëtarësimin në NATO. Ne do të vazhdojmë të ju mbështesim edhe në rrugën drejt integritimit në Bashkimin Europian. Ne nuk mund ta imagjinojmë BE-në pa vende si Shqipëria. Të punojmë së bashku si dy popuj në Ballkan dhe të bëjmë të mundur që të çballkanizojmë Ballkanin e ta bëjmë pjesë të Europës"- është shprehur ministri grek Avramopoulos.

Ministrja Kodheli priti zëvendësndihmës sekretarin e Shtetit të SHBA, Hoyt Yee

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, ka pritur në datën 30 tetor 2013, në një takim të veçantë zëvendësndihmës Sekretarin e Shtetit të SHBA, z. Hoyt Yee, i cili ndodhet në Tiranë për një vizitë zyrtare. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe ambasadori i SHBA në Tiranë, z. Alexander Arvizu. Ministria Kodheli vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera mes SHBA dhe Shqipërisë. Ajo theksoi se, qeveria shqiptare dhe Ministria e Mbrojtjes janë të angazhuara për të luftuar korrupsionin dhe për të përmirësuar klimën e biznesit. Gjithashtu ministrja Kodheli foli për mundësinë e shtrirjes së bashkëpunimit të mëtejshëm midis dy vendeve tona dhe Forcave të Armatosura, si dhe kërkoi mbështetjen e SHBA për integrimin e vendit në BE. "Shqipëria dhe shqiptarët janë përkrahës të përhershëm të SHBA", ka nënvizuar më tej ajo. Znj. Kodheli u ndal edhe tek situata e vështirë ekonomike në dikasterin e Mbrojtjes. "Ne jemi në vështirësi të mëdha financiare. Dy përqindëshi nuk mund të arrihet. Kjo nuk do të thotë që nuk do të realizojmë objektivat. Ne jemi të vendosur të rrisim efikasitetin dhe të luftojmë korrupsionin pa kompromis", është shprehur ministrja Kodheli. Ministria e Mbrojtjes e siguroi zyrtarin e lartë amerikan se në vijim të bashkëpunimit në fushën e trajnimit dhe rritjes së kapaciteteve të FA,



ne do të forcojmë kriteret dhe rregullat e përzgjedhjes për personelin që do të nisët në trajnim, përfshirë dhe kandidatët që do të ndjekin programin e përgatitjes së oficerëve të rinj, në bashkëpunim me Gardën e New Jersey. Zëvendësndihmës Sekretari Amerikan i Shtetit, Hoyt Yee, garantoj ministren Kodheli për mbështetjen e padiskutueshme të SHBA ndaj Shqipërisë, duke u shprehur se "Ne do ju mbështesim në proceset integruese të Shqipërisë në BE dhe për këtë kemi folur me partnerët tanë europianë për çeljen e negociatave në dhjetor për marrjen e statusit të vendit kandidat". Më tej, ai kërkoi një angazhim më të madh të burimeve financiare për arritjen e standardeve dhe kërkesave të NATO. Në fund të takimit z. Yee dhe ambasadori amerikan në vendin tonë, z. Aleksandër Arvizu, shprehen edhe një herë tjetër vullnetin e SHBA për të mbështetur Shqipërinë në rrugën e saj të integritimit.

SHSHP, gjeneralmajor Jeronim Baze priti komandantin e FT të NATO, gjenerallejtënant Frederick Ben Hodges

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, ka pritur në datë 11 nëntor 2013 në një takim të veçantë komandantin e Forcës Tokësore të NATO, gjenerallejtënant Frederick Ben Hodges. Vizita e komandantit të Forcës Tokësore të NATO, gjenerallejtënant Frederick Ben Hodges, zhvillohet në kuadër të vizitave të tij në vendet e Aleancës. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, pasi i ka uruar mirëseardhjen në vendin tonë, e ka prezantuar komandantin e Forcës Tokësore të NATO me të gjithë drejtorët e drejtorive në Shtabin e Përgjithshëm.

Gjeneralmajor Bazo priti z. Boland, drejtor i Planifikimit në Shtabin Ndërkombëtar të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, në datë 26 nëntor 2013 priti në një takim të veçantë z. Frank Boland, drejtor i Planifikimit në Shtabin Ndërkombëtar të NATO-s, i cili kryeson

ekipin e NATO-s, në takimin dypalësh Shqipëri-NATO. Gjeneral Bazo, pasi bëri një përmbledhje të arritjeve më të fundit të Forcave të Armatosura Shqiptare, vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin e suksesshëm me strukturat e NATO. "Shpreh angazhimin se FARSH do të përfshihen sa më cilësisht në procesin e planifikimit të Mbrojtjes së NATO, nëpërmjet përmbushjes së detyrimeve të paketës së kapaciteteve, duke u fokusuar kryesisht në ngritjen dhe implementimin e grup-batalioneve", është shprehur ndër të tjera gjeneral Bazo. Nga ana e tij, z. Boland ka vlerësuar progresin e deritanishëm të FA Shqiptare në përmbushjen e detyrimeve të deklaruara në NATO.

Atasheut ushtarak turk, kolonel Nizamettin Dogar, pritet nga SHSHPFA

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, priti datë 26 nëntor 2013, në një takim kortezie atasheut ushtarak të Republikës së Turqisë, kolonel Nizamettin Dogar, me rastin e marrjes së detyrës. Kolonel Dogar, shprehu bindjen se niveli i bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona në fushën e mbrojtjes, do të vazhdojë të njihin progres. Nga ana e tij, gjeneral Bazo ka falënderuar për mbështetjen e fuqishme të Republikës së Turqisë për integrimin e vendit tonë në NATO, si dhe ka vlerësuar nivelin aktual të bashkëpunimit ndërmjet Forcave të Armatosura Shqiptare dhe Forcave të Armatosura të Turqisë në fushat e arsimim-stërvitjes, modernizimit dhe logjistikës. Gjeneral Bazo dhe kolonel Dogar ndanë bindjen se marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe të Turqisë do të intensifikohen edhe më tej në të ardhmen, jo vetëm në nivel dypalësh por edhe në kuadër të Aleancës Euroatlantike.

Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar z. Cannon, takim kortezie me gjeneral Bazo

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, në datën 25 nëntor 2013, ka pritur në një takim kortezie ambasadorin e Mbretërisë së



Bashkuar të akredituar në vendin tonë, z. Nicholas Cannon. Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar z. Nicholas Cannon, i ka përcjellë gjeneral Bazo letrën e urimit të SHSHP të Mbretërisë së Bashkuar, gjeneral Sir Nicolas Houghton me rastin e marrjes së detyrës së lartë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të RSH. Gjeneral Bazo ka vlerësuar maksimalisht nivelin aktual të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona në fushën e Mbrojtjes, si dhe ka falënderuar z. Cannon për mbështetjen e tij personale në këtë drejtim.

Gjeneralmajor Bazo, takon atasheun ushtarak të Mbretërisë së Spanjës

Në datën 25 nëntor 2013, shefi Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, priti sot në një takim atasheun ushtarak të Mbretërisë së Spanjës, kolonel Julian de Pablo Martin, rezident në Ankara. Gjeneral Bazo, pasi vlerësoi mbështetjen e dhënë nga Mbretëria e Spanjës gjatë fazës së integritimit të Shqipërisë në NATO, e njohu kolonel De Pablo, me zhvillimet më të fundit në FA Shqiptare, të tilla si përfundimi i Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, angazhimin në përmbushjen e objektivave të forcës dhe përdorimin me efikasitet të burimeve të mbrojtjes.

Zhvillohet takimi i 17-të të SHSHP të Vendeve të Iniciativës së A-5

Në takimin e 17-të të shefave të Shtabeve të Përgjithshëm të Vendeve të Iniciativës së A-5, që u zhvillua në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, në datë 20 nëntor 2013, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo ka riafirmuar faktin se Shqipëria do të vazhdojë të mbështesë angazhimin në Afganistan, do të jetë pjesë e misionit "Resolute Support" në mbështetje të qeverisë afgane, për të trajnuar e këshilluar Forcat afgane të Sigurisë, për të kontribuar kështu në sigurimin e

paqes, stabilitetit dhe në ndërtimin e institucioneve. Ky kontribut është deklaruar edhe nga ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli në Ministerialin e Mbrojtjes të NATO në muajin tetor në Bruksel.

Gjeneralmajor Jeronim Bazo zhvillon një takim me KLSM

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, në datë 27 nëntor 2013 ka zhvilluar pasditen e sotme një takim me pjesëmarrësit e Kursit të lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM), i cili është duke u zhvilluar pranë KDS në periudhën 9 shtator-6 dhjetor 2013. Gjeneral Bazo ka shkëmbyer mendime me pjesëmarrësit e KLSM, si dhe është njohur nga afër me programet akademike të këtij kursi të lartë, i cili ka për qëllim krijimin e marrëdhënieve sa më të mira të vendeve të rajonit, si dhe zhvillimin e përqsasjeve sa më objektive sa u takon sfidave të paqes dhe të sigurisë në rajonin e Ballkanit, por edhe më gjerë.

Inspektohen trupat xheniere të angazhuara në ndihmë të pushtetit vendor në Shkodër

Në datën 27 nëntor 2013, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, pas vizitës në batalionin e parë të këmbësorisë në Vaun e Dejës në Shkodër, ka zhvilluar një takim me efektivat e batalionit xhenier të Brigadës së Mbështetjes Rajonale, të cilët prej disa ditësh janë duke kryer punime në interes të pushtetit qendror dhe vendor në rrugën Shkodër-Hani i Hotit. Gjatë kësaj vizite SHSHPFA, gjeneralmajor Jeronim Bazo shoqërohej nga komandanti i FT, gjeneralmajor Zyber Dushku dhe komandanti i BrMR, gjeneralbrigade Muhamet Buçpapa. Gjeneral Bazo ka falënderuar efektivat xheniere për punën e madhe që kanë realizuar, duke treguar edhe njëherë se Forcat e Armatosura janë gjithnjë e më pranë qytetarëve.

“Kur shikoj një ushtar shqiptar, shikoj një ushtar të NATO-s”

Intervistë me komandantin e Forcës Tokësore të NATO-s, gjeneralletenant Frederick “Ben” Hodges (USA-A)

Intervistoi: LAVDRIM LITA

Në një intervistë për revistën *Mbrojtja*, gjeneralletenant Frederick “Ben” Hodges, komandant i Forcës Tokësore të NATO-s flet për arritjet e Shqipërisë në anëtarësimin e plotë në Aleancën e Atlantikut të Veriut, flet për domosdoshmërinë e transformimit të vazhdueshëm, për sfidat e ardhshme të FARSH dhe vlerësoi heroin kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Konferenca e fundit e integritimit në NATO dhe firmosja e deklaratës bilaterale ACT-FARSH disa ditë më parë, ishte një moment i rëndësishëm për Forcat e Armatosura Shqiptare. Ky moment vjen pas 4 vitesh përpjekjesh të shumta, reformash dhe standardesh të reja. Cilat janë komentet dhe vlerësimet tuaja në lidhje me këtë çështje?

“Kur shikoj një ushtar shqiptar, shikoj një ushtar të NATO-s. Integrimi përfundimtar tregon faktin se Forcat e Armatosura shqiptare kanë treguar kompetencat dhe af-

tësitë e tyre ushtarake si një nga anëtarët e aleancës më të suksesshme në historinë moderne. Nëpërmjet procesit të anëtarësimin, ato i kanë treguar Aleancës vullnetin për të punuar me të tjerët, për të zhvilluar kapacitetet e tyre në përputhje me kërkesat ushtarake që duhen arritur për një anëtarësim të plotë në Aleancë. Aftësia e tyre për t’u adaptuar me kushtet paraprake doktrinare, organizative, stërvitore, arsimore dhe teknologjike të NATO-s brenda një kohe kaq të shkurtër, tregojnë përpjekjet dhe një angazhim për t’u admiruar të lidhshpimit politik dhe ushtarak dhe dëshirën e ushtarëve tuaj për t’u përmirësuar. Urimet e mia për përfundimin e procesit sfidues të integritimit. Imagjinoj se lidhshpimi i Forcave të Armatosura shqiptare duhet të jetë mjaft i kënaqur kur shikojnë se përpjekjet e tyre kanë qenë mjaft frytdhënëse”.

Transformimi është sfidë e vazhdueshme. Çfarë duhet bërë në mënyrë që të jemi të sigurt që kapacitetet dhe trupat tanë t’u përgjigjen në nivelin e duhur kërkesave të Aleancës?

“Transformimi gjithmonë kërkon vullnet dhe aftësinë e





duhur nga Aleanca për të investuar në mënyrë të zgjuar në burime që janë të nevojshme për të arritur kërkesat operacionale në një mjedis sigurie që ndryshon në mënyrë dinamike, sidomos gjatë një periudhe masash shtrënguese ekonomike. Është thelbësore që të ruhet ndërveprimi që ne kemi arritur së bashku në 12 vitet e fundit në Afganistan, kur përfundoi edhe misioni i ISAF. Liderët e mëparshëm ushtarakë përgjatë rrugëtimit të Aleancës janë të ndërgjegjshëm për faktin, se pjesa më e madhe e vendeve të NATO-s po reduktojnë strukturën e forcave të tyre, prandaj ne do na duhet të varem nga njëri tjetri më shumë se asnjëherë. Një nga mënyrat për ta bërë këtë është të bashkojmë të gjitha shtabet tona të përgjithshme në zonat tona më të mira të trajnimit, në bazat më të mira logjistike dhe në qendrat e arsimit që vendet tona tashmë kanë – gjithashtu, dua të them, nëpërmjet ushtrive tona- të bëhemi edhe më të bashkuar. Ne do të jemi me eficientë në aspektin ekonomik dhe efektiv duke investuar në sistemet moderne të komunikimit, të cilat do të na mundësojnë të komunikojmë bashkë hap pas hapi. Ne gjithashtu duhet të arsimojmë dhe trajnojmë shtabet tona të përgjithshme dhe ushtritë kombëtare mbi bazën e një standardi të përbashkët, në mënyrë që të planifikojmë dhe bashkëpunojmë në përgatitjen e operacioneve me kontingjente të një tipi të caktuar. Më shkurtimin e stafit të shtabeve tona dhe forcave tona të përherëshme, është thelbësore që ne të zhvillojmë dhe të fuqizojmë oficerët tanë të rinj për të maksimizuar talentin dhe potencialin që ata kanë treguar herë pas here si udhëheqës të njësisë të vogla, që kanë luftuar në Afganistan, pa mbikëqyrjen direkt të oficerëve të tjerë më të lartë. Çdo vend i NATO-s duhet të vazhdojë të përpiqet për të arritur bashkim dhe bashkëpunim ndërkombëtar mes Aleancës dhe me forcat e vendeve partnere në nivelin më të lartë të mundshëm, në mënyrë që të arrihen normat e Nivelit të Qëllimit dhe Konceptit Strategjik. Ne duhet të vazhdojmë të investojmë në arsimimin e oficerëve dhe nënofficerëve tanë në shkolla, akademi, kolegje, të cilat kanë anglishten si gjuhë bazë. Anglishtja dhe frëngjishtja janë gjuhët zyrtare të NATO-s, ndërkohë që anglishtja është gjuha e punës në të gjitha selitë e NATO-s. Gjithashtu do të inkurajoja një shkëmbim të shpeshtë eksperiencash mes akademive dhe kolegjeve për stafin ushtarak të vendeve të tjera”.

Si e vlerësoni rrugëtimitin që kemi përpara dhe cila mund të ishte sfida më të cilën Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mund të përballen?

“Përfundimi i procesit të integrimit nuk përbën stadin përfundimtar... ky proces është një gur themeli në rrugën tuaj në përmirësimin e kapaciteteve tuaja ushtarake, bashkimin dhe ndërveprimin për të arritur një standard të NATO-s dhe për të forcuar sigurinë kombëtare të Shqipërisë. Mendoj se Shqipëria do të përballlet me sfida ekonomike të vazhdueshme, ashtu si edhe pjesa tjetër e vendeve të NATO-s dhe vendet Partnere për Paqe (PfP), prandaj dhe ruajtja e gatishmërisë dhe e kapaciteteve do të jetë e vështirë. Gjetja e mënyrës për t'i ruajtur këto do të kërkojë inovacion dhe kreativitet. Një qasje rajonale për Ballkanin mund të konsiderohej mjaft e vlefshme. Disa iniciativa si SEEBRIK (Brigada e Europës Juglindore) tashmë janë aty ku duhet dhe kanë potencialin për edhe më shumë efekte pozitive. Selia ime ka në plan të ftojë SEEBRIG t'i bashkohet EX TRIDENT LANCE –ve tona, që do të kryejmë në Grafenwoehr, Gjermani, në dhjetor të vitit 2014. Mendoj se ka nisma të tjera rajonale të cilat gjithashtu mund të paguajnë dividendë dhe të zvogëlojnë shpenzimet e përgjithshme për Shqipërinë dhe vendet e tjera ballkanike - një akademi rajonale e nënofficerëve apo një kolegji rajonal i mbrojtjes, për shembull. Kam qenë kohët e fundit në Estoni dhe vizitova Kolegjin Baltik të Mbrojtjes në Tartu. Ky është një shembull i shkëlqyer i rezultateve që patën vendet baltike dhe disa partnerë të tjerë, si Suedia, kur bashkuan burimet e tyre për ngritur një kolegji për majorë dhe kolonellejtënantë. Ndoshta ky koncept mund të funksionojë edhe për Ballkanin. Në mënyrë të ngjashme, një qendër rajonale trajnimi ose simulimi mund t'i mundësojë vendeve të Ballkanit që të kenë një strukturë trajnimi të një cilësie të madhe dhe të përballueshme duke qenë se kosto ndahet mes disa vendeve. E kuptoj që këto ide duken të lehta në teori dhe mund të mos jenë aq të thjeshta sa mund të mendohet, por unë mendoj se është me vlerë të merren në konsideratë në funksion të sfidave ekonomike”.

I nderuar Gjeneral, a mund të jepni një mesazh publik për strukturat e FARSH në këtë ditë të veçantë për to?

Që nga koha e Gjergj Kastrioti Skënderbeut, luftëtarë nga Shqipëria kanë treguar vlerën e tyre në beteja në mbrojtje të atdheut. Heroi juaj kombëtar, nëse do të ishte gjallë sot, do të ishte shumë krenar për atë që Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë arritur me pranimin e saj të suksesshme në NATO. Jam i emocionuar në lidhje me të ardhmen tuaj dhe që ju kemi një anëtar të vlefshëm të Aleancës. Kam parë ushtarë shqiptarë të kryejnë detyrat e tyre shumë mirë në një sërë sferash. Kam një kolonel shqiptar në stafin tim, që është një nga oficerët më të mirë në shtabin tonë. Lidershipi juaj në ministrinë e Mbrojtjes, shefi juaj i Mbrojtjes dhe lidershipi i ushtrisë më kanë impresionuar me vizionin e tyre, me energjinë pozitive dhe vendosmërinë për të arritur që Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jenë efektive dhe të ndërveprueshme brenda NATO-s, që do të jenë administratore të mira të mbështetjes që japin tatimpaguesit dhe që do të bëhen një institucion i besueshëm për popullin shqiptar. Ky është një lidership pozitiv i atillë, që mund të kapërcejë çdo sfidë. Urime përsëri për suksesin tuaj dhe mbi atë çka e ardhmja premtton për ju.

BASHKËPUNIMI



KLSM, vlerësime dhe sugjerime nga pjesëmarrësit

Me rastin e mbylljes së Kursit të Pestë të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM), revista "Mbrojtja" sjell një përmbledhje vlerësimesh dhe sugjerimesh nga personat e huaj dhe shqiptarë që e kryen këtë Kurs



Kolonel Nizamettin Dogar,
Atasheu i Mbrojtjes
i Republikës së Turqisë

• Vlerësoj Kursin e Lartë për Studime në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes si një shembull shumë të mirë bashkëpunimi rajonal nën ombrellën e NATO-s. Pjesëmarrja në këtë kurs ishte një mundësi shumë

e mirë për mua për të rritur aftësitë e miya profesionale në lidhje me vlerësimin e mjedisit të sigurisë globale, nëpërmjet sigurimit të një pamje shumë të gjerë nga ndryshimet klimaterike e deri tek krimi i organizuar dhe terrorizmi. Këto dije ishin të një game të gjerë globale si dhe të fokusuar në rajonin tonë (Ballkan). Vlen të theksoj seancat e hapura të diskutimit në kurs, krijuan mundësi që të gjithë të pranishmit të shkëmbejnë idetë e tyre. Për më tepër, kjo veprimtari ishte me mjaft efikasitet për nga mënyra e të kuptuarit të ngjarjeve, rrahja e mendimeve dhe gjetja e rrugëzgjdhjeve mes nesh për të mundësuar parandalimin e shumicës së konflikteve. Nëpërmjet kësaj metode, mundësohet një shërbim mësimi në interes sigurisë në përgjithësi. Në këtë kontekst, sigurisht që ne jo vetëm patëm mundësinë për të zgjeruar kapacitetet tona profesionale dhe intelek-

tuale, por edhe krijuam hapësirat e duhura për një ambient të përshtatshëm bashkëpunimi rajonal për të ardhmen. Mbjajtja në konisederatë se një pjesë e vendeve të ballkanit janë në tranzicion dhe drejt reformave të fuqishme integruese, e shoh me vend dhe të rëndësishëm zhvillimin e këtij kursi në Shqipëri. Vendi juaj po e drejton mjaft mirë këtë veprimtari, e cila për mënyrën e menaxhimit të saj shpreh bindjen se do të jetë një model shumë i mirë edhe për vendet e tjera të rajonit. Unë jam i sigurt se Turqia do të japë çdo kontribut të nevojshëm për të mbajtur këtë kurs në drejtimin e duhur. Në emër të Forcave të Armatosura Turke, shpreh mirënjohje të thelle për ministrin e Mbrojtjes së RSH-së, shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA, komandantin e KDS-së, komandantin e Akademisë së FA, si dhe gjithë personelin që u angazhua drejtpërdrejt në realizimin me sukses të këtij kursi, me vlera të mëdha për vendin dhe rajonin.



**Kolonel Aleksandër Andruco,
Greqi**

•Kursi i Lartë NATO-jan nën kujdesin e FASH/TRADOK, u organizua dhe u realizua në mënyrë të shkëlqyer. Qysh në fillim vërejta se kolegët oficerë shqiptarë shpenzuan shumë orë punë për përgatitjen e tij. E njëjta gjë ndodhi siç u vërtetua gjatë gjithë tre mujeve që zgjati kursi, (shtator-dhjetor 2013). Ata treguan peshën e tyre të veçantë si liderë të aftë.

Drejtimi

Gjithçka, si qëndrimi ynë, strehimi, mbështetja e përditshme, shqetësimi i vazhdueshëm për jetesën tonë të huajve në KDS, ishte në nivel të shkëlqyer, më të lartin të mundshëm. Jam prekur sinqerisht, nga sinqeriteti, fisnikëria, mirësia, me një fjalë nga njerëzillëku i kolegëve oficerë shqiptarë, por edhe i civilëve të cilët puna i lidhi me ne. Nuk do të harroj kurrë bashkëstudentin tim, shefin e Shtabit të KDS, kolonel Riza Zaja, person veçanërisht modest dhe shumë i dashur, ashtu siç e kisha marrë përshtypjen edhe nga ushtarët dhe drejtuesit e KDS-së. Kolonel Zaja, gjithnjë fytyrëqeshur, në lartësinë e funksionit që ka, pyeste përditë për ne, për jetesën tonë në garnizon dhe në qytetin e Tiranës... Gjithashtu nuk do të harroj n/kolonelin Adrian Lulaj, person veçanërisht krenar, i cili kishte ngarkesën e rëndë të organizimit të përditshmërisë së studentëve, bazuar në tekst, gjithnjë me program. Adriani ishte, siç kushtet e kërkonin, bazuar në detyrat e tij, skrupuloz deri në detaj dhe korrekt. Mendoj se ai arriti të jetë e të përbëjë koeficientin bazë të suksesit të Kursit, nga ana teknike. Nuk do të harroj as n/kolonel Behar

Mara, i cili interesohet për sigurinë tonë personale dhe për sigurinë e sendeve tona. Së fundi, nuk do të mungoj të përmend Zonjën që ishte përgjegjëse për ne në hotel, por edhe zonjat që kujdeseshin për ne në mence. Ishin të gjitha të shkëlqyera. Gjithë të lartpërmendurit, por edhe shumë të tjerë-të cilët pa dashje i harroj, me qëndrimin dhe sjelljen e tyre se rrezatuan dhe do vazhdojnë të rrezatojnë, fytyrën e re të vendit të tyre, Shqipërinë e kohës së re. Këtë çast, dëshiroj të përmend komandantin e KDS-së gjeneralbrigade Bardhyl Hoxha, serioziteti dhe figura ushtarake e të cilit (sigurisht bashkë me cilësitë e drejtuesve të mësipërm), mundësuan këtë përfundim të shkëlqyer të Kursit. Ky rezultat, doemos është një tregues pozitiv për FASH.

Procesi mësimor në Shkollë

Niveli i Shkollës (shkollë e nivelit strategjik), ishte më i larti i mundshmi! Më lejoni të nënvizoj këtu, se nuk ekziston një shkollë e tillë, asgjëkundi tjetër në Ballkan. Pedagogu përgjegjës, gjen/rez, zoti Zija Baja duke ndjerë rëndësinë e këtij Kursit për FASH dhe për Shqipërinë, por kryesisht misionin e Kursit për hedhjen e bazave për bashkëpunimin dhe paqen në Ballkan, u interesua që të mbështetet dhe të përforcet niveli strategjik i shkollës, me:

a-Të drejtën, në kuadrin e respektimit Lirisë Akademike, të cilën na e siguronte ne si studentë.

b-Zgjedhjen e thelluar e të nivelit të lartë të mësimeve dhe temave që zhvillonte përherë, duke qenë vetë ai njohës i mirë i një plejade akademike të studimeve të kohës.

c-Me njohjen me themel të temave që lektroheshin në klasë, por edhe me nivelin e lartë kritik të pikëpamjeve, më ndihmoi në shumë raste të ndjehem problematik dhe të kërkoj drejtime të reja, zgjidhje të reja...

d-Përzgjedhjet e shkëlqyera të lektorëve që realizonte, sigurisht edhe me mbështetjen e organeve drejtuese.

e-Vizitat e përzgjedhura nëpër reparte dhe shërbime të ndryshme shtetërore, SHSHP, Forcat Speciale, MPJ etj.

Në këtë moment, do të dëshiroja t'i kërkoja falje, nëse në kuadrin e "lirisë akademike", disa herë kam tejkalluar caqet. Veçse kjo përbën...vetë vulën e procesit të të mësuarit!

Gjithashtu desha ta falenderoj, sepse ai ndihmoi që unë të ushtroj edhe më tej nervat e mia, brenda një "mjedisi familjar". Këtë mjedis familjar gjenerali u përpoq ta zhvillojë, jo vetëm sepse e kërkon NATO, por sepse si Mësues Akademik, ai e beson thellë këtë. Pedagogun gjeneral Zija Bahja, do ta kujtoj gjithnjë me respekt, e përmes këtij vlerësimi, e FALENDEROJ.

Rekomandime / Propozime

Do të doja t'i rekomandoj Komandës së TRADOK për Kursin që ndoqa:

a-T'i atashohen një deri në dy asistentë pedagogë (të diplomuar në Universitetin Shtetëror shqiptar apo në ato të jashtme, në Degët e Studimeve Strategjike (experts), me specializim nëse

është e mundur, në Çështjet Ballkanike, pedagogut Përgjegjës Zija Baja. Këta të dy asistentë pedagogë të specializuar në Çështjet Ballkanike, përveç të tjerave, do të jenë në vazhdimësi... "bubuzhina shpirtërore" të studentëve të ardhshëm".

b- Të gjendet mënyra që studentët të mundën të shikojnë të gjithë... tabelën në klasë, atje ku shënon projektori. Vendosija e klasës duhet të jetë në formë amfiteatri.

c- Do të ishte mirë që ndër të përzgjedhurit lektorë të ishin edhe më shumë personalitete të larta të jetës politike, ekonomike e shoqërore të vendit, pse jo, edhe nga nivelet e larta të NATO-s.

d- Do duhet për mendimin tim të analizohet më mirë prezenca e sllavëve mes studentëve, dhe këtu e kam fjalën konkretisht për serbët, pasi sllavë të FYROM-it marrin pjesë. Duhet bërë kjo, me qëllim që me kalimin e kohës të thyhen ca "tabu". Kjo do të mundësojë integrimin gradual të tyre në strukturat e Aleancës Euroatlantike. E di që kjo është e vështirë, por tamam këtu-vlerësoj- se garantohet plotësisht statusi strategjik i Kursit.

Në këtë mënyrë do të vijë ngadalë-ngadalë një përjasje më e mirë mes objektivit të Kursit dhe Aleancës ("End State"), ç`ka është mirëkuptimi reciprok ndërmjet liderëve të Gadishullit Ballkanik. Kontakti me "tjetrin" dhe "të ndryshmin" dhe ecuria e bashkëpunimit, një fakt që në të ardhmen do të mund të parandalonte ndoshta disa situata të mundshme negative, përderisa këta liderë do të mund të kenë poste të larta drejtimi, do të mundnin të influencenin në procesin e vendimmarrjes politike në vendet e tyre.

dh- Komanda e KDS, të rekomandojë më tej përmirësimin e gjendjes ekonomike të Shkollës, me qëllim që t`i shërbehet më mirë objektivit të Shkollës, por edhe të NATO-s, duke u rritur numri i drejtuesve pjesëmarrës në Kurs.

e- NATO-ja duhet të mbështesë dhe përforcojë këtë Shkollë në të gjitha drejtimet, e më së pari në anën ekonomike, sipas rekomandimeve të palës shqiptare, përmes KDS-së. Kjo Shkollë duhet "t`i imponohet" Ballkanit, duke e shndërruar atë (pra Shkollën) në një Qendër-Shembull për Studimet Strategjike të Mbrojtjes dhe Sigurisë, në gadishullin Ballkanik.

Të ndryshme

a- Si një grek, i cili punoi në vitin 2006 në NHQ-Tiranë, për hyrjen e Shqipërisë në NATO, do të dëshiroja të shkruaj me gjithë forcën e shpirtit tim, se u ndjeva mirë veçanërisht, jo sepse u ndodha pranë vëllezërish - siç besoj se jemi, grekë dhe shqiptarë-duke pasur prejardhjen e përbashkët prej pellazgëve, duke qenë se jemi dy popujt historikisht autoktonë të kësaj zone. Por edhe për një arsye tjetër: -Nga sa dëgjova dhe pashë prej qëndrimeve të politikanëve, ushtarakëve, policëve-të cilët përbëjnë "veglat e arta" të vendit, kam krijuar mendimin se Shqipëria dëshiron të vijë në realitetin evropian

e çliruar nga peshat e së kaluarës, të cilat e patën stigmatizuar mes kombeve të tjerë për shumë vite. E konsideroj të sigurtë duke pasur parasysh forcën dhe krenarinë e popullit shqiptar, e nëse këto cilësi të tij përthyhen në realitet, se Shqipëria, sigurisht me dhimbje dhe djersë, për pak vite do të bëhet një shtet absolutisht modern, e ndoshta pas pak dhjetëvjeçarësh pse jo, një shtet model për Europën në të cilën bën pjesë! Nevojitet durim dhe punë!

b- Duke përfunduar, falenderoj nga zemra:

- NATO-n që organizon dhe mbështet këtë Shkollë, student i së cilës pata nderin të jem.

- FASH, shefin e Shtabit të Përgjithshëm të tyre, secilin veç e veç drejtuesit e zotë të KDS-së, për mikëpritjen e tyre dhe për dashurinë me të cilën na rrethuan.

-Shefin tim SHSHP gjeneral Mihal Kostarako, i cili më përzgjodhi të studioj në këtë Shkollë dhe i jam personalisht mirënjohës për këtë.



**Kolonel Mikahel Kavaxidis,
Greqi**

•Jam i shumë i kënaqur jo vetëm për ftesën vëllezërore në kurs, por edhe për organizimin dhe drejtimin e këtij kursi. Jam i surprizuar gjithashtu për programin e kursit kurrikulat përkatëse dhe mbi të gjitha mbi mënyrën e prezantimit, drejtimin profesional dhe të veçantë nga gjeneralbrigade në rezervë Zija Baja. I rëndësishëm gjatë zhvillimit të kursit ishte shkëmbimi i ideve me përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrës, kryesisht me ato kufitare. Mbi bazën e kësaj eksperience dhe duke krijuar një kuptim akoma më të qartë mbi sigurinë dhe mbrojtjen, mu krijua mundësia që të jap një kontribut më të plotë e profesional në vendin tim dhe pse jo në rajon për të ardhmen tonë. Veçoj se ky kurs është një vlerë e veçantë për Shqipërinë, pasi është nga të veçantit në rajon që zhvillohet me një program të tillë duke shtuar faktin se ai zhvillohet në gjuhën angleze.

Rekomandime

Profesor Zija Baja, mbetet një aset që duhet të jetë në përdorim të FARSH. Ai zotëron njohuri të plota akademike, ai reflekton vlera intelektuale dhe menaxheriale që krijon mundësi për kursantët për studim, mbi të gjitha përfitim të njohurive të duhura duke siguruar dhe një bashkëpunim mirëkuptues dhe të frytshëm. Vizita në veri të vendit si dhe në rajon do ta konsolidojë më shumë këtë kurs duke e bërë konkures në llojin e tij. Si një kurs i vlerësuar "NATO listed Course", rekomandoj mbajtjen në konsideratë përdorimin nga të gjithë lektorët të emrit të pranuar nga NATO "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë". Kjo në respekt të rregullave të NATO-s dhe njëkohësisht të Greqisë.



**Prof. Assist. Dr. kol.
Metodija Dojcinovski,
Maqedoni**

• Republika e Shqipërisë është një faktor paqej dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor. Organizimi i kursit të lartë për studime të sigurisë dhe mbrojtjes nga 09.09.2013-06.12.2013, tregon një përkushtim të qartë për të monitoruar përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të krijuar dhe për të ruajtur paqen në nivel lokal, rajonal dhe global. Kontributi në promovimin e paqes dhe bashkëpunimit rajonal, është një investim i vyer, kryesisht në mbështetje të politikës së sigurisë, zhvillimin e sistemit të arsimit të lartë, standardizimin e sigurisë dhe mbrojtjes, duke mbështetur integrimin euroatlantik për të arritur sigurinë rajonale të projekteve. Programi i disiplinave multikurrikulave, lejon dëgjuesit për të sjellë standardet dhe normat europiane në përdorimin e metodave të mësimdhënies. Njëkohësisht merren në konsideratë në mënyrë objektive vendimmarrja në nivelin strategjik dhe operacional, përgatitja e analizave, raporteve, vlerësimeve dhe mbështetja e interesave kombëtare. Gjatë kohës së implementimit/zhvillimit të kursit të lartë të studimeve të sigurisë dhe mbrojtjes, Shqipëria u bë anëtare e plotë e NATO-s. Kjo ngjarje shkaktoi emocione dhe një kujtesë që nuk mund të harrohet, pasi u arrit qëllimi final. Pjesëmarrja me të drejta të plota në vendimmarrjen politike dhe ushtarake së bashku autoritetet dhe vendet e NATO-s, bashkimi në këtë familje të madhe. Anëtarësimi i plotë i Republikës së Shqipërisë në NATO, siguroi reduktimin mundësitë për rreziqe dhe kërcënime ndaj sigurisë në rajon. Komanda e Doktrinave dhe Stërvitjes (KDS) në përbërjen, e të cilit është organizuar aktiviteti në fjalë, është "qendra e gravitetit" në aspektin e trajnimit dhe edukimit të personelit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Qasja bashkëkohore e shkencës dhe proceset vijuese lejuan pjesëmarrësit e kursit për të fituar njohuri të shkëlqyera për problemet aktuale të sigurisë në rajon e më gjerë. Kompleksiteti i programit lejon futjen e qartë për çështjet e zonës së sigurisë në një kontekst më të gjerë të politikës dhe sigurisë (çështje të brendshme të mbrojtjes, të ligjit ndërkombëtar, menaxhimit e krizave, ndërveprimit, etj.) dhe më shumë. Vizitat e bëra në kuadër të bashkëpunimit të institucioneve shtetërore ishin dëshmi se Republika e Shqipërisë po bën hapa në rrugën e duhur për arritjen e qëllimeve dhe axhendën europiane. Mësimet e mësuara, e prezantuara gjatë kursit, provuan se ligjëruesit dhe studentët kanë një përvojë të madhe, e cila mund të transmetohen jo vetëm në rajon, por në të gjithë botën, veçanërisht në vende dhe rajone që janë të prekur nga kriza ose

situata pas konflikteve. Sfidat e reja në botën moderne dhe ndikimin e ndryshimeve globale, përbëjnë sfida për procesin e arsimit të lartë në Shqipëri. Sistemi, moderniteti kërkon përdorimin e mjeteve të reja moderne dhe zbatimin e proceseve për të mbështetur dhe për të përmirësuar arsimimin e personelit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë, të mbrojtjes dhe të sigurisë në vendet fqinje dhe në rajon do të kontribuojë në arritjen e qëllimeve udhëheqëse në arsim dhe promovimin e paqes dhe sigurisë së vërtetë në rajon. Procesi tremujor arsimor, puna bashkëpunuese, koordinimi dhe shkëmbimi i përvojës ishin të mjaftueshme për të parë mundësinë e arritjes së hapave të tjerë në fushën e bashkëpunimit midis institucioneve të arsimit të lartë të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Në Akademinë Ushtarake "Gjeneral Mihailo Apostolski" - Shkup, aktualisht janë duke studiuar kadetë të Maqedonisë, Malit të Zi, Bosnje-Hercegovinës dhe Kosovës. Kjo akademi edukon personelin në një cikël të dytë të arsimit (shkallës master dhe specializim). Bashkëpunimi i Akademisë së FA Shqipëtare me këtë akademi (mes këtyre dy institucioneve) do të jetë një kontribut i madh për motivimin për të promovuar njohuri të reja të mësuara, forma të reja të bashkëpunimit në rajon dhe madje edhe në promovimin e paqes dhe sigurisë rajonale.



**Nënkolonel Laurentu Rusan,
Atasheu i Mbrojtjes i
Republikës së Rumanisë**

• Pjesëmarrja në Kursin e 5-t të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes ka qenë një mundësi e mirë dhe njëkohësisht një privilegj për mua personalisht. Së pari, pata shansin të studioj në institucionin më të rëndësishëm të FARSH, në Akademinë e Mbrojtjes. Kjo më bën mua të jem krenar pasi studiova në kursin ku kanë studiuar gjeneralët e Forcave të Armatosura Shqiptare si dhe gjeneralët e ardhshëm të tyre. Ky kurs ishte një mundësi reale për të parë realitetin në sy, se sa lart është rritur ky institucion, jo vetëm brenda, por dhe jashtë vendit. Së dyti, pata një mundësi të përfitoja nga lektorët të institucioneve civilë e ushtarake shqiptar, por edhe të ftuar nga qendra ndërkombëtare studimore, përfshi vizionin e dhënë nga një numër i konsiderueshëm ambasadorësh resident në Tiranë. Mund të veçoj shkëmbimin e ideve, eksperiencat e ndryshme, brenda grupit mësimor, pyetjet e adresuara dhe opinionet respektive për përgjigjet e mundshme. Në këtë kushte krijohet një mundësi e mirë e të kuptuarit për sfidat e ardhshme të sigurisë dhe mbrojtjes. Së treti, pata mundësi të takoj pjesëmarrës nga vende të ndryshme të ra-

jonit, duke përfiturar jo vetëm eksperiencën ushtarake, por edhe vlerat dhe kulturat e këtyre vendeve dhe identitetin përkatës. Në këtë këndvështrim kuptohen më mirë çështjet që na shqetësojnë të gjithëve dhe zgjidhjet e mundshme, për të arritur objektivat strategjike rajonale. Mbi bazën e këtyre arsytimit, jo vetëm pjesëmarrja në këtë kurs, por gjithashtu dua të inkurajoj lidhshmërinë e MM për të vjuar në rrugën e konsolidimit të mëtejshëm të këtij kursi për një bashkëpunim më të gjerë me vendet e rajonit dhe veçanërisht me FARSH të këtyre vendeve për ta përdorur si një mekanizëm të shkëlqyer në interes të paqes dhe sigurisë në rajon.



**Kapiten I Rang II
Shahin Bakhishov
Përfaqësues i Republikës
së Azerbajxhanit**

•Mora pjesë në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes si përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Azerbajxhanit. Ishte një kënaqësi të vizitoja Shqipërinë dhe akoma më shumë të ndiqja Kursin më të Lartë të Sigurisë që zhvillohet në Shqipëri. Në emër të autoriteteve të vendit tim dhe timin personalisht vlerësoj drejtuesit e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes për ftesën e bërë për pjesëmarrje në kurs, e cila më dha mundësinë të takoj, shkëmbej ide dhe mendime me kolegë nga vendi juaj dhe pjesëmarrësit e tjerë të rajonit. Përgjatë kohës në kurs ne patëm mundësi të marrim njohuri mbi çështje të sigurisë dhe mbrojtjes si për rajonin ashtu edhe mbarë globin. Në të njëjtën kohë patëm mundësi të përfitojmë njohuri bashkëkohore në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen të vendeve të rajonit. Ky ishte një shans për të marrë njohuri të domosdoshme duke zhvilluar aftësitë tona për të ardhmen. Së fundmi, më lejoni që t'ju falenderoj për mikpritjen, krijimin e kushteve të shkëlqyera për gjatë gjithë kohës së qëndrimit tim në Shqipëri.



**Nënkolonel Ivica Brajkovic,
Kroaci**

•Në momentin që Ministria e Mbrojtjes Kroate më ofroi mundësinë e pjesëmarrjes në Kursin e lartë të Sigurisë që u zhvillua në Shqipëri, pranova me kënaqësi ta ndjek atë. Më tej mora kontakt me personin i cili ka ndjekur të njëjtin kurs vitin e kaluar, i cili më uroi për përzgjedhjen e bërë. Njëkohësisht më dha informacionin e duhur, pse duhet të ndiqja

këtë kurs dhe ja që tani kuptova qartë se kisha bërë zgjedhjen e duhur. Kursi ishte në nivelin e duhur, me një paraqitje të shkëlqyer, duke më dhënë mundësinë e përfitimit maksimal, për të cilën uroj që të punoj në nivele e duhura të larta strategjike, me qëllim të kem mundësinë për dhënien e kontributit tim mbi bazën e njohurive të përfitura nga kursi në fjalë. Për shkak të mundësive të kufizuara financiare, ndoshta si pasoje ndikimit të krizës globale, kuptohet që ka patur një ndikim në mos zhvillimin e disa aktiviteteve jashtë vendit si dhe mungesa e disa lektorëve të programuar. Por dua të nënvizoj se kjo nuk e zbehu zhvillimin e plotë të programit. Për më tepër që patëm shansin të komunikojmë me shumë njerëz të nacionaliteteve të ndryshme dhe të shkëmbejmë mendimet bashkarisht. Rekomandoj që në në kurset e ardhshme të ketë një planifikim realist, duke bërë të mundur në kohë realizimin e programit dhe kryesisht të vizitave brenda dhe jashtë vendit.



**Major Florim Aziri, Ministria
e Mbrojtjes, Maqedoni**

•Premtimet, dëshirat dhe sakrificat sot janë bërë të gjithë NJË. Fakti se arsimi dhe edukimi paraqet bazën e një shoqërie apo të një shteti, stafi i KDS-së me në krye gjeneralbrigade Bardhyl Hoxhën, përmes projektit SCSDS krijoi ura lidhëse mes komuniteteve të ndryshme në rajon dhe më gjërë. Me mjeshtri dhe përkushtim të paparë, organizuan kursin në fjalë duke i dhuruar gjitha institucioneve brenda dhe jashtë vendit, gjeneratë të përgatitur dhe aftësuar në lëmin e mbrojtjes dhe sigurisë. Gjithë kjo, falë përkushtimit të tyre për të ndërtuar njohuri dhe shkathtësi prej profesionit tonë, me qëllim të arritjes së një cilësie me të lartë jetësore për ne dhe shoqëritë tona. Sot, kur në të gjithë vendet e botës ku ka shqiptarë, sheshet fillojnë të zbkurohen me ngjyra "kuq e zi", e ndjej vetën të privilegjuar që mu dha rasti të jem pjesë në realizimin e projektit "Paqe përmes partneritetit", për mes të cilit dëshiroj në mënyrë më modeste, të falenderoj Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, për kontributin e tyre që dhanë në afirmimin, sensibilizimin dhe ndërkombëtarizimin e paqes dhe sigurisë në rajon. Shpresoj se stafi i KDS-së, profesorët dhe ligjëruesit do të vazhdojnë me të njëjtin plan në vitet në vijim në promovimin e vlerave dhe diturisë në dobi të paqes dhe sigurisë, gjithmonë duke pasur parasysh fjalinë e urtë shqipe se, "Çdo gjë që ndahet pakohet, vetëm dituria nëse ndahet shumëohet". Shumë dashuri, paqe dhe lumturi në familjet tuaja.



Kolonel Dilaver Hoxha,
Zëvendëskomandant
i Forcave Tokësore

•Përfundimi me sukses i kursit të Lartë të Studimeve mbi Sigurinë dhe Mbrojtjen, me një pjesëmarrje masive nga vendet e rajonit si dhe mbi të gjitha i vlerësuar me nota mjaft pozitive nga ana e tyre, përbën një risi për Forcat e Armatosura Shqiptare dhe veçanërisht për Komandën e Doktrinave dhe Stërvitjes. Kjo veprimtari kryesore vjetore e Akademisë së FA, ka ndikim mbi të gjitha kolektiv për të gjitha institucionet e edukimit ushtarak ashtu dhe Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA. Në të njëjtën kohë nuk mund të shmanget edhe krenaria individuale e trupës pedagogjike, i të gjithë lektorëve dhe individëve që menaxhuan këtë veprimtari, por gjithashtu dhe personeli që ndoqi dhe u certifikua në këtë kurs. Sot disponojmë 18 ushtarakë të lartë dhe civil ekuivalent, më të mirëtrajnuar, më të motivuar dhe një aset që do të jetë në dispozicion në institucioneve kombëtare dhe rajonale për të shërbyer në strukturat e sigurisë dhe mbrojtjes. Pas një periudhe 3 mujore studimesh diplomohen/certifikohen ushtarakë dhe civilë nga vendi dhe rajoni. Në këtë proces dhanë një kontribut të çmuar lektorët më të mirë ushtarakë dhe civilë në vend dhe nga disa qendra ndërkombetare studimore, përfshi lektorë të Qendrës Amerikane të Sigurisë në Garmisht të Gjermanisë. Po kështu ne patëm mundësi të marrim leksione nga disa autoritete të larta të politikës dhe mbrojtjes në vend. E them me plot bindje se çdo pjesëmarrës, pati mundësinë të zhvillojë njohuritë me informacion bashkëkohor në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen, kombëtare, rajonale dhe në shumë fusha ndërkontinentale. Për më tepër, mjafton të nënvizoj disa prej tyre me të cilat po ndeshet bota sot si: kriza financiare, terrorizmi, konfliktet ndëretnike dhe fetare, shterimi i burimeve natyrore dhe energjitike, ngrohja globale dhe kufizimet ujore, operacionet në përgjigje të krizave, etj. Të gjitha këto janë parë në kondvështrimin e efekteve që po japin në rajon dhe mjedisin ndërkombetar dhe parashikimet për zgjidhje në të ardhmen. Po kështu zgjerimi i njohurive dhe shkëmbimi i mendimeve në fusha si: korrupsioni, trafiket ilegale, ndikimet kulturore etnike dhe fetare, krijuan një diapazon më të gjerë për eksplorim, informim dhe kontribut për parandalim në interes të sigurisë dhe paqes. Parë në këndvështrimin e statusit të këtij kursi. Për mendimin tim, ky kurs është në kondicionin e duhur për të qenë institucion "elitë" në rajon dhe të bëhet sa më shpejt e mundur Kursi Rajonal i Sigurisë dhe Mbrojtjes. Për këtë qëllim programi dhe kurrikulat janë në dimensionin bashkëkohor, trupa pedagogjike ekzistuese ka përvojën dhe njohuritë e duhura, e cila ndoshta mund të kërkojë më shumë zgjerim në numër. Infrastruktura është e

mjaftueshme e cila duhet të ruhet në nivelin aktual me qëllim përmirësimin dhe jo nënvleftësimin e saj. Siç edhe shefi i SHP të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim bazo theksoi në takimin e vçantë e organizuar nga pjesëmarrësit e këtij kursi, "Një fushatë sensibilizuese për promovim dhe marketing në rajon, mbetet sfida për lidhshimin e FARSH". Së fundmi, përgëzoi punën profesionale e të gjithë strukturave që menaxhojnë dhe mbulojnë këtë veprimtari, nga komandanti i KDS dhe Akademisë së FA deri tek trupa pedagogjike dhe menaxherët përkaëts që arritën të realizojnë me sukses këtë aktivitet mjaft të rëndësishëm në sistemin e Arsimimit dhe Kualifikimit të FA.



Kolonel Riza ZAJA
Pjesëtar i KLSM-së,
shëf i Shtabit të KDS-së

•Nuk është një ekzagjerim apo vetëkënaqësi, por tashmë një e vërtetë që duhet thënë me të madhe dhe një realitet i prekshëm: Kursi i Lartë i Sigurisë dhe i Mbrojtjes që zhvillohet në AFA përbën pikën kulminante të arritjes së objektivave në nivelit teorik ,profesional dhe praktik arsimor në nivelet më të larta të përfaqësimit. Tashmë ky kurs ka fituar përfaqësimin dinjitoz dhe vlerësimet maksimale si nga pjesëmarrja në të të pjestarëve të FA të RSH apo strukturave të tjera të Sigurisë dhe të Mbrojtjes në RSH, ashtu dhe një pjesëmarrje në rritje të ushtarakëve të huaj nga vende të ndryshme të rajonit. Fakti i të qenit kurs "Listed by NATO", zhvillimi i të gjithë programit mësimor në gjuhën angleze, pjesëmarrja e lektorëve të shquar dhe me reputacion nga vende të ndryshme të rajonit, si nga Qendra Marshall, SHBA-ja, Greqia, Maqedonia, Italia, Kosova, pjesëmarrja e një sërë personalitetesh të vendit dhe të huaj si lektor apo "Guest speaker", e bënë zhvillimin e këtij kursi sa të rëndësishëm aq dhe të larmishëm. Duke patur fatin e madh të jem një nga pjestarët e këtij kursi, unë pashë me sytë e mi dhe jetova konkretisht organizimin, zhvillimin dhe mbështetjen maksimale të të gjithë stafit që u angazhua për mbështetjen e këtij kursi dhe realizimin me sukses të programit të tij. Vlerësoj dhe çmoj në maksimum rëndësinë e zhvillimit të temave shumë të rëndësishme dhe bashkëkohore të sigurisë globale, temave që kanë lidhje me ndryshimet dhe zhvillimin e koncepteve të reja për mbrojtjen në kuadrin e Aleancës, temat në lidhje me ndërhyrjet humanitare, situatat politike, ekonomike dhe ushtarake në rajon dhe më gjërë, trajtimi i këndvështrimit të rajonit të ballkanit, sipas qeverive të rajonit e më gjërë. Falenderoj Aleksandrin dhe Michailin nga Greqia, Nizametin dhe Abdullahun nga Turqia, Metodija dhe Florimin nga Maqedonia, Granitin nga Kosova, Ivica nga Kroacia dhe Russan nga Rumania, të cilët manifestuan një

qënim korrekt, dinjitoz dhe sollën eksperiencën e vyer nga vendet respektive, në trajtimin e temave të programit mësimor si dhe një shkëmbim të rëndësishëm të kulturave të vendeve respektive. Një vlerësim maksimal shkon për n/kolonel Ardjan Lulaj, puna, përkushtimi, angazimi dhe serioziteti i të cilit bëri të funksionojë çdo gjë normalisht. Nënkolonel Ardjan Lulaj, një oficer shumë punëtor, dinjitoz për një oficer të një ushtrie të NATO-s, i cili për tre muaj ka mbuluar jo vetëm pjesën programore dhe organizative e administrative, por dhe atë kulturore. Çdo strukturë do ta kishte për nder ta kishte në rradhët e saj këtë kuadër, respekt dhe mirënjohje. Profesori i nderuar gjeneral © Zija Bahja, njohuritë, metoda dhe puna e të cilit meriton vetëm falenderime dhe mirënjohje. Gjatë tre muajve, grupi mësimor ndjeu nga afër si transmetimin e njohurive, ngrohtësinë e tij ashtu dhe pjesëmarrjen e tij aktive gjatë vizitave të ndryshme. Së fundmi falenderoj gjithashtu kapiten Valzim Lika, specialist i ndërlidhjes në Shtabin e KDS-së, major Ilir Latifi dhe toger Kurt Zhukri, civile Anila Miraka dhe pse jo fotografën Alban Bushin, të cilët me angazhimin e tyre të vazhdueshëm bënë që çdo gjë të shkonte normalisht. Shpresoj dhe besoj në fjalën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm gjatë takimit me KLSM se ky kurs jo vetëm që do ta vazhdojë rrugëtimin e tij përsëri, por do të merren të gjitha masat që arritjet të çohen më tej.



Kol. Msc. Editson Zarka

•Përfundimi me sukses i Kursit të 5-të të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes tregoi edhe njëherë konsolidimin e strukturave tona të arsimit të lartë ushtarak, duke kontribuar ndjeshëm në rritjen e bashkëpunimit rajonal e më gjerë. Ky kurs është një kapacitet i veçantë i Forcave tona të Armatosura, i cili përbën një vlerë të shtuar për të cilin të gjithë duhet të jemi krenarë. Ai përbën gjithashtu një armë të fortë në fushën e diplomacisë ushtarake për konsolidimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, rritjen e mirëbesimit me vende të tjera të rajonit e më gjerë, si krijimin e urave të bashkëpunimit të komunitetit të sigurisë dhe mbrojtjes. Pjesëmarrja nga vende të ndryshme të rajonit, si dhe nga institucionet të tjera të sigurisë së vendit tregon vitalitetin e këtij kursi dhe interesimin për të marrë pjesë në njohjen, debatin dhe diskutimin për sfidat e sotme të sigurisë dhe ato të ardhme. I listuar nga Komanda e Aleancës për Transformimin (ACT) ky kurs është pararendëse e certifikimit dhe akreditimit nga NATO, duke rritur prestigjin dhe duke konkuruar në "tregun" e mendimit të përparuar ushtarak dhe atë të sigurisë midis vendeve të tjera anëtare. Përveç pjesës teorike, e cila u dha nga lektorë të shquar vendas dhe të huaj, diskutimi me pje-

starë të forcave të armatosura të vendeve aleate dhe atyre partnere i dhanë këtij kursi një dimension të ri, real dhe praktik. Analiza dhe sinteza për sfida të rajonit, debate dhe diskutime lidhur me tendencat e zhvillimeve drejt strukturave euro-atlantike, dhënia e rekomandimeve për zgjidhje opurtune në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes e bëjnë unike këtë kurs, i cili është maturuar nga viti në vit. Shpreh bindjen time që asete të tilla do të vlerësohen edhe në të ardhmen nga lidhshipi ynë civil dhe ushtarak, duke kontribuar nën moton e "smart defense", iniciativë në fushën e arsimit dhe kualifikimit në fushën e sigurisë e mbrojtjes.



Major Granit Fetahu
Shef i stafit të drejtorit të
Përgjithshëm të Policisë,
Republika e Kosovës

•Duke qenë shumë krenar për pjesëmarrjen në Kursin e Lartë për Studime të Sigurisë dhe Mbrojtjes (kurs i nivelit NATO-LISTED), fillimisht dëshiroj të shfrytëzoj rastin që publikisht të shfaq falenderimin më të lartë për Republikën e Shqipërisë, posaqërisht Forcat e Armatosura të Shqipërisë, që janë mikëpritës dhe organizues të kursit në fjalë si dhe për garantimin e vendeve për pjesëtarë të institucioneve të sigurisë së Republikës së Kosovës për të ndjekur këtë shkollë akademike aq të rëndësishme. Falenderim të veçantë personal gjithashtu i dedikoj drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës për përzgjedhjen dhe caktimin tim për të jetuar një eksperiencë kaq të mrekullueshme. Shumëllojshmëria e pedagogëve specialist të kualifikimeve të ndryshme, temat e ndryshme strategjike të elaboruara dhe diskutuara, si dhe diversiteti i studentëve pjesëmarrës nga vende të ndryshme, e bëjnë këtë kurs të një rëndësie të posaçme. I përfaqësuar nga vende të ndryshme, kursi paraqet një mundësi për të thelluar bashkëpunimin dhe partneritetin ndërkombëtar. Është gjë e sigurtë se kolegët e mi pjesëmarrës në kurs, ashtu si edhe unë, tani i shohim çështjet e sigurisë globale, me një sy tjetër. Jemi ngarkuar me dituri dhe eksperiencë të cilat, jam i sigurtë, do t'i shfrytëzojmë për të kontribuar për një botë më të mirë, më të sigurtë dhe më paqësore. Jetojmë në epokën kur njerëzimi përballet me sfida të ndryshme të sigurisë dhe kërcënime të nivelit global, siç janë terrorizmi dhe ngrohja globale, të cilat për tu bërë ballë nevojitet mirëkuptim dhe bashkëpunim ndërkombëtar i afërt, i vazhdueshëm, aktiv dhe intensiv, bashkëpunim ky që krijohet dhe vihet në lëvizje përmes aktiviteteve të pjesëmarrjes ndërkombëtare të këtij lloji. Gjëja më e vlefshme dhe e rëndësishme që ne studentët fitojmë nga pjesëmarrja në këtë kurs, është miqësia dhe ndërlidhja që ne krijojmë mes nesh, një vëllezëri e përjetshme. Ndaj opinionin me kolegët e mi

student, që kursi paraqet një pjesë të përgjegjësisë dhe kontributit të mrekullueshëm që Republika e Shqipërisë po përmbush si anëtare e NATO-s, në garantimin e një jetë me prosperitet në planet.



Major Abdullah BAĞCI
(Turqi)

• Si një pjesëmarrës i Kursit të Pestë të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, pata një mundësi shumë të mirë për të ngritur nivelin e njohurive për karrierën time profesionale. Kursi ishte shumë mirë i organizuar që nga fillimi deri në përfundim të tij. Tematika e zgjedhur për diskutim ishin ato që kërkohen sot. Niveli i profesorëve të caktuar

për zhvillimin e mësimit ishin saktësisht të duhur. Klima dhe atmosfera e krijuar në klasë ishte shumë e mirë dhe kjo krijoi mundësi sejcilit nga ne të diskutonte në mënyrë të lirë. Kjo e shoqëruar me një nivel profesional arsimor të lartë si dhe kushte shumë të mira jetese të siguruara nga Akademia e Forcave të Armatosura. Eksperencën që unë fitova këtu jam i sigurtë që do të qëndroj tek unë jo vetëm në zbatimin e detyrave të mija si një oficer i xhandarmërisë së ushtrisë Turke por gjithashtu për gjatë gjithë jetës sime. Përveç të gjithave çështjeve që unë fola më lart, për mua gjëja më e rëndësishme dhe më e paharueshme do të jetë mikëpritja e vëllezërve Shqiptarë. Me gjithshka të shkëlqyera të përmenduar më lart une shpresoj që KLSM do të vazhdoj të jetë çdo vit mirë e më mirë, sepse për herë të pestë KDS e konfirmoi atë, Shqipëria e meriton të drejtoj këtë kurs të akredituar si antar i plotë i NATO.

VLERËSIMI

Sinai: Sfida e KLSM-së, zgjerimi në një inisiativë rajonale të përbashkët

Flet profesori i “Qendrës Marshall”, Tamir Sinai, lektor në KLSM

Tamir Sinai është një profesor i studimeve të sigurisë në qendrën “George C. Marshall European Center for Security Studies”. Në kuadër të bashkëpunimit të “Qendrës Marshall” me KLSM, ai ka qenë një lektor i kësaj qendre, në KLSM. Duke pasur parasysh përvojën e “Qendrës Marshall” menduam se do ishte i vlefshëm opinion i njërit prej profesorëve të saj në lidhje me KLSM. Intervista e mëposhtme jep disa vlerësime dhe ide për zhvillimin e KLSM.

Zoti Sinai ju keni ardhur për të zhvilluar mësime për tre ditë në Kursin e Pestë të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM) nga “Qendrën Marshall”, do të ishte me interes të lexuesve të njiheshin me një përshkrim të shkurtër të karrierës dhe aktivitetit tuaj akademik.

Unë jam një kontraktor që punoj si Manger Programesh për Ushtrimet Praktike në Kolegjin për Studimet Ndërkombëtare të Sigurisë në Qendrën “George C. Marshall”. Në të shkuarën kam punuar për organizata të ndryshme të sigurisë si ajo e NATO, OSBE, në fushën politike kryesisht në rajonin



e Ballkanit. Jam studiu i fushës politike dhe jap leksione në një sërë universitetesh në fushën e Sigurisë Evropiane.

Shumëkush e njih rëndësinë e “Qendrës Marshall” dhe nivelin e saj profesional në fushën e studimeve



të sigurisë, megjithatë, do të ishte me vlerë që ju si pjesë e stafit pedagogjik të saj, të na jepnin një vlerësim të shkurtër në lidhje me kontributin e kësaj qendre në këtë fushë.

Për më tepër se 20 vjet, Qendra Marshall ka krijuar një kapicet të gjerë partnerësh dhe një netëorë të gjerë e cila përfshin më tepër se 10.000 të arsimuar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në 141 vende të ndryshme të botës. Shumë nga këta profesionist janë në kontakt të përditëshëm me njëri tjetrin, ose në grupe të ndryshme, ata ndajnë informacion të ndryshme si në luftën kundër terorizmit, për çështjet e sigurisë kibernetike, mbrojtjen civile, dhe prezantojnë dhe çështje të tjera. Impakti i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i Qendrës Marshall, në pjesë të madhe, me lidhjet midis ish pjesëmarrësve në programet e ndryshme të kësaj qendre si dhe me punën e përditëshme nga stafi dhe trupa pedagogjike, të cilët drejtojnë një mision të mrekullueshëm nëpërmjet programeve të përbashkëta nëpërmjet Gjermanisë dhe Shteteve të Bashkuara.

A e shihni rolin e KLSM-së si një faktor pozitiv në ndërtimin një mjedisi të qëndrueshëm rajonal, për sa i përket bashkëpunimit, sigurisë dhe fushës së mbrojtjes?

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes përfaqëson një forum për ekspert të sigurisë nga një rajon i cili ka mbartur sfida dhe probleme në të shkuarën dhe në këtë kurs studiojnë së bashku dhe shkëmbëjnë këndvështrimet dhe qasje në çështje më interes të përbashkët. Në këndvështrimin tim KLSM realizon kryesisht dy gjëra: Ai përmbush një funksion shumë të rëndësishëm në procesin e krijimit të një kulture sigurie rajonale të përbashkët dhe se ky kurs tregon në mënyrë të qartë se si një vend si Shqipëria mund të ndryshojë nga të qenit një vend që konsumonte siguri në një vend të rëndësishëm të krijimit të sigurisë.

Tashmë është viti i dytë për ju që merrni pjesë në programin e KLSM-së, duke dhënë kontributin tuaj si pedagog. Cila është përshtypja juaj në lidhje me diskutimet e zhvilluara aty dhe me produktivitetin që sjellin këto shkëmbime mendimesh e pikëshikimesh?

Përgjigjen e kësaj pyetje do tja referoja tek stafi

drejtues i KLSM, të cilët nën "zjarrin" e vështresive të ashpra financiare, ishin në gjendje, nëpërmjet një dedikimi absolute profesional të përfshijë pjesëmarrës nga shumë vende si një grup të vetëm të cilën e gjejmë së bashku në KLSM. Diskutimet në KLSM janë të gjalla e reale dhe shpesh mund të themi të zjarta por gjithmonë kolegjiale. Dhe ky kurs krijon mundësi për të diskutuar dhe shprehur dhe gjetur pika të përbashkëta e cila është një kriter bazë dhe themelor për kultivimin e një sigurie të përbashkët.

Nisur nga fakti që jeni pjesë e stafit akademik të "Qendrës Marshall", a e shikoni edukimin në fushën e sigurisë, - kësaj edhe ndikimin e KLSM-së - si një rrugë emancipuese, e cila do të sjellë demokratizimin e mëtejshëm të institucioneve dhe një zhvillim të qëndrueshëm paqësor në rajonin tonë?

Eksperianca e Qendrës Marshall tregon vlerën e ndërtimit të lidhjeve të vazhdueshme dhe të qëndrueshme si në rafshin rajonal por edhe global të ekspertëve të sigurisë. Metodologjia e përdorur nga KLSM, por mund të themi si dhe sfidat me të cilat përballemi si the temat e trajtuara në programet e përbashkëta të vendosura në kuadër kurseve të siguruar nga kurset e Qendrës Marshall dhe KLSM janë shumë të ngashme. Kjo është një tregues që provon mënyrën që paraprin këtyre lidhjeve dhe KLSM po na siguron një shembull të shkëlqyer të kësaj mënyre e cila mundet dhe duhet të vazhdoj brenda një mjedisi rajonal.

Cili do të ishte, sipas jush, një sugjerim për zhvillimin e programeve në fushë e studimeve të sigurisë për një vend të vogël si Shqipëria, në një realitet me dinamikë të lartë si Ballkani; sugjerim i cili do të ishte i vlefshëm, pasi ju vini nga një mjedis akademik i një qendre me nivel të lartë dhe vizionar?

Shqipëria është duke demonstruar një rol të jashtëzakonshëm drejtues dhe iniciues duke organizuar këtë kurs dhe duke e shtrirë atë për pjesëmarrës jo vetëm nga rajoni por edhe më tej duke përfshirë dhe Italinë e Turqinë. Sfidë do të jetë për të zgjeruar programin e bashkëpunimit dhe mundësisht ta bëjë atë një iniciativë rajonale të përbashkët e cila do të jetë vërtet në interes e rajonit si një e tërë.

Doktoratura e Marenglenit, dhuratë për Shtetin...

Dr. Marenglen Kasmi, bazuar në arkivat gjermane, sjell dokumentet që shfaqin veprimet naziste në territorin Shqiptar, që nga dita e parë e pushtimit, deri ditën e fudit të qëndrimit në vendin tonë

Nga Pano Hallko

Edhe këtë vit, një pjesë e politikës shqiptare, "për traditë" e në emër të interesave të kushedi se kujt, e festoi Ditën e Çlirimit jo në datën në të cilën u larguan pushtuesit nazistë, pra më 29 Nëntor, por më datën 28 Nëntor. Është një "nyjë gordiane" inekzistente, e sajuar enkas, fabrikuar kushedi se ku, por që gjithsesi, duhej "të pritej". Këtë nyjë, ka vite që e ka marrë përsipër një historian ushtarak relativisht i ri, Doktor i Shkencave Historike tanimë, major Marenglen Kasmi. Publiku i gjerë pati rastin ta njohë Marenglenin në një sekuencë të kronikës në kanalën më të madh televiziv të vendit tonë. Shkurtazi, përmbledhtas, aq sa e lejon koha televizive, në emisionin qendror të lajmeve. Doktor Marengleni me një ekstrakt të shkurtër e me dokumente të skanuara të Wehrmacht-it gjerman, i (ri)thua publikut të vërtetën e njohur sot e 69 vite më parë: Që ushtria gjermane doli jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë më datën 29 nëntor 1944. Ky vend ka shkolluar shumë njerëz jashtë shtetit, me paratë e taksapaguesve, në degë të ndryshme, por pak, për të mos thënë shumë pak, ky investim madhor i shtetit, është kthyer në kontribut nga ana e përfituesve. Një pjesë e madhe e tyre kanë "dezertuar", pra i kanë braktisur FA-të, -me paratë dhe për llogarinë e të cilave patën shkuar për arsimim. Një pjesë jo e vogël e tyre, nuk arritën të përfundojnë shkollat, pasi u përzgjedhën ndër vite me kriterë militantizmi, apo edhe më keq akoma, me procedura të korruptuara. Ndër të paktët që shkuan, mësuar, "gërmuan" "si gjermanë", për llogari të vendit që i nisi, ishte Marengleni. Ai studioi fillimisht në Akademinë Ushtarake "Skënderbej", pastaj përfundoi Shkollën e Oficerëve të Drezden-it në Gjermani (Offizierschule des Heeres Dresden);



ndërsa Kursin Parauniversitar e kreu në Universitetin Ludwig-Maximilian, Mynih, Gjermani (Studienkolleg, Ludwig-Maximilian-Universität, München), e më në fund Universitetin Helmut-Schmidt Hamburg, Gjermani, Fakulteti i Historisë (Helmut-Schmidt Universität/Universität der Bundeswehr Hamburg).

Pushtues, apo pelegrinë?

Studimi i tij në kërkim të gradës "Doktor i Shkencave" me titull "Pushtimi gjerman dhe vendosja e administratës politiko-ushtarake në Shqipëri 1943-1944 (Një këndvështrim i ri në dritën e dokumenteve gjermane)", kap dhe trajton një gamë shumë më të gjerë periudhash kohore, ngjarjesh e faktesh, si dhe probleme e trajtesa, të cilat kanë vlerat e mirëfillta të një punimi serioz Historik. Studimi i tij



nis qysh në vitin 1925, vit kur ky vend, me gjithë ç`kishte, iu bë dhuratë Italisë së asaj kohe. Punimi trajton në mënyrë të detajuar arsyet e pushtimit gjerman të Shqipërisë, ngritjen e regjimit pushtues në Shqipëri, bashkëpunimin dhe rezistencën ndaj pushtimit, dhe po ashtu, merr në analizë veprimet luftarake të gjermanëve në Shqipëri, ngritjen e Divizionit SS «Skanderbeg», Luftën e Tiranës, e doemos largimin e Wehrmacht-it nga Shqipëria. E veçanta e këtij studimi është trajtimi në mënyrë komplekse dhe gjithëpërfshirëse, gjithmonë bazuar në materiale arkivore gjermane, e periudhës 14-mujore të pushtimit gjerman të Shqipërisë. Dokumentet e konsultuara në Arkivin Ushtarak të Freiburg-ut, jo vetëm që japin një tablo të qartë të pushtimit gjerman të Shqipërisë, por po ashtu, lejojnë trajtimin në mënyrë shteruese të çështjeve të mësipërme. Por, autori argumenton edhe një fakt tjetër historik: Pushtimin e vendit nga nazizmi, si akt juridik shtetëror. "A duhej kjo?" - mund të pyesë dikush. Këto 23 vite ne jetojmë në kohën e paranojës, për shumë probleme. Ndër to, edhe fakti i pushtimit nazist të vendit. Një sezonë e vulgut shqiptar, në fillim me teorinë se... "gjermanët nuk erdhën për të pushtuar vendin e për të luftuar, por qe gabimi i shqiptarëve, që i ngacmuan. Madje - sipas tyre,- Gjermania naziste nuk e paska pasur kurrë në planet e saj Shqipërinë"!!! Kinse "harrohet" fakti që në Shqipëri u dislokuan plot 36.000 forca, e u vranë 2500 ushtarë e oficerë (përfshijto ushtarët turkmenë, armenë, azerë, etj) të cilët ajo Ushtri nuk i kërkoi më në apelin e fundit!

Por vetë gjermanët, me dokumentet e Ministrisë së tyre të kohës, të cilat na i sjell studimi i Maren Glenit, vërtetojnë të kundërtën e atyre që "tirren" rrugëve e pastaj kthehen në doktrinë famëkeqe. Për këtë, le të citojmë pjesë të shkurtër nga punimi: "Në datën 09.09.1943, Komandanti i Divizionit të Këmbësorisë 297 së Wehrmacht-it gjerman shpërndau në njësitë e tij "Urdhrin Nr. 1 të Divizionit për pushtimin e territoreve shqiptare". Në këtë urdhër, krahas urdhrave të tjerë dhe masave paraprake të zakonshme për hartimin e një operacioni ushtarak thuhet në pikën pesë të tij (Disiplina gjatë marshimit): "Der Marsch ist ein Kriegsmarsch!" (Marshimi

është një marshim luftarak!). Titulli i urdhrit dhe mënyra e hartimit të tij tregojnë qartë që ky ishte një urdhër i zakonshëm ushtarak për pushtimin e një vendi, ndonëse me veçori, të cilat trajtohen gjatë studimit. Edhe nga pikëpamja gjuhësore dhe frazeologjike, duke ju referuar fjalorit shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip, dokumentet gjermane të kohës si edhe literatura përkatëse, i referohet gjithmonë fjalës «Besetzung» (pushtim, okupim), «Besatzungsmacht» (fuqi okupuese, pushtuese), «Besatzungszone» (zonë e okupuar, pushtuar) etj".

Patriotë, apo bashkëpunëtorë?

"Çështja e diskutimit nëse ishte pushtim apo jo, ka të bëjë me anën tjetër të medaljes: 1.Nëse Balli Kombëtar dhe Legaliteti luftuan kundër pushtuesit apo u radhitën përkrah tij; 2.Që komunistët provokuan me qëllim një luftë civile për të realizuar synimet e tyre ideologjike,- përbëjnë thelbin e këtij debati. Në këtë këndvështrim, vihet në diskutim edhe termi «pushtim», «okupim» dhe, si rrjedhojë edhe fjala «bashkëpunim» dhe «kolaboracion» merr një dimension të ri. Shqipëria zinte në politikën ekspansioniste të Mussolini-t një vend të veçantë. Kërkesat italiane ndaj Shqipërisë ishin së pari të motivuara ekonomikisht. Shqipëria shikohej si një treg i sigurtë i mallrave të ndryshme italiane. Për më tej, drejtuesit italianë i kishin hedhur sytë edhe te pasuritë e nëntokës shqiptare. Së dyti, Mussolini shikonte te Shqipëria një kryeurë në Ballkan, ashtu siç ajo është. Porë në këtë kontekst, vërejmë ushtrimin e një politike graduale pushtuese, e cila favorizohej jo vetëm nga situata e rënduar politike në Shqipëri por edhe nga politika jugosllave ndaj Shqipërisë. Lufta ndërmjet Beogradit dhe Romës për të përgatitur marrjen e Shqipërisë nën zotërim, do të mbyllej në favor të Italisë nëpërmjet Paktit të Parë dhe të Dytë të Tiranës (Nëntor 1926 dhe 1927). Bashkëpunimi i një pjese të "elitës" shqiptare bazohej mbi filozofinë e okupimit. Formalisht, Shqipëria duhej të kthehej fashiste, por në fakt u shndërrua në një koloni italiane! Më 4 qershor u miratua dhe hyri në fuqi Statuti Themeltar, sipas së cilit fiksioni i një shteti të pavarur ishte vështirë të



FESTA E ÇLIRIMIT

Ministrja Kodheli bën homazhe në nderim të dëshmorëve të atdheut

Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli mori pjesë në ceremoninë e v endosjes së kurorave për 29 Nëntorin tek Monumenti “Nënë Shqipëri”, Varrezat e Dëshmorëve të Kombit. Në fund të ceremonisë ministria Mimi Kodheli e shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm z. Jeronim Baze, ka vendosur një kurore me lule mbi varrin e dëshmorit të atdheut Feti Vogli i cili ra në detyrë gjatë një misioni në Afganistan.







besohej. Gjithë pushteti ishte i përqendruar faktikisht në duart e mbretit, i cili reprezentohet nëpërmjet një mëkëmbësi të tij. Nën këtë person nga hierarkia qëndronte qeveria marionetë shqiptare.

Pikërisht kjo ishte mënyra qeverisëse, e cila në shkencat juridike konsiderohej si prototip i një "Rregulli të ri shtetëror", të cilin diktatorët evropianë e aplikuan në shtetet e pushtuara. Pra gjithë pushteti politik përqendrohej në duart e diktatorit. Ndërkohë që Statuti Themeltar përcaktonte një monarki konstitucionale, në të vërtetë u krijua një diktaturë fashiste ushtarake, autoritare, tepër e centralizuar dhe antidemokratike.

Ndërtimi i një aparati bashkëpunëtor me hapësira të ngushta veprimi për shqiptarët, u shoqërua me italianizmin dhe fashistizimin e strukturës politike dhe ekonomike të Shqipërisë, ndërsa sistemi shoqëror tradicional në Shqipërinë e Veriut qëndroi i paprekur në formën ekzistuese, pasi u korruptuan me parakererët e tyre. Përderisa Shqipëria ishte konsideruar nga Hitler-i gjithmonë si zonë influence e sunduar e Italisë, pushtimi gjerman i Shqipërisë erdhi si pasojë e nevojave të pastra ushtarake. Sidoqoftë, duhet theksuar se kapitullimi i Italisë ishte pikasur shumë herët prej drejtuesve gjermanë. Prandaj qysh përpara se të ndodhte kapitullimi i Italisë, gjermanët dërguan trupa për ruajtjen e aerodromeve shqiptare. Po ashtu ata ishin të shqetësuar edhe nga rreziku i ndonjë zbarkimi të mundshëm të aleatëve në Shqipëri. Urdhri përfundimtar për pushtimin e Shqipërisë u dha më 8 shtator 1943, menjëherë pas shpalljes së kapitullimit pa kushte të Italisë fashiste dhe ushtrisë së saj.


Shqipëria financoi edhe mbajtjen e trupave gjermane dhe instancave të tjera të tyre, gjë që përbënte një ngarkesë shumë të madhe ekonomike për një vend të pazhvilluar. Shuma e parave e paguar nga shqiptarët për Wehrmacht-in gjatë pushtimit, arriti afërsisht në 270 milionë franga. Gjithashtu u mor edhe gjithë ari shqiptar, me një peshë prej afërsisht tre ton. Supozimi që Balli Kombëtar ishte i detyruar të bashkëpunonte me gjermanët si pasojë e fillimit të luftës civile, është i pa besueshëm, sepse ndërmjet partizanëve dhe ballistëve kishin ndodhur deri në fund të tetorit 1943 vetëm përplasje ushtarake sporadike dhe nuk ekzistonte akoma asnjë direktivë e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ për të luftuar kundër Ballit Kombëtar apo grupimeve të tjera jo-komuniste. Siç vërehet, si Balli Kombëtar ashtu edhe Partia Komuniste, kishin të njëjtin shqetësim: sigurimin e drejtimit të vendit pas largimit, tashmë të parashikueshëm, të gjermanëve nga Shqipëria. Bashkëpunimi i Ballit Kombëtar me gjermanët i shërbeu Partisë Komuniste që si fillim, ta demaskonte atë në popull, e më vonë ta godiste përfundimisht. Nga ana tjetër, Balli Kombëtar ndiqte po të njëjtin strategji, pra likuidimin me çdo kusht të lëvizjes komuniste. Kërkesat e oficerëve ndërlidhës britanikë që ndodheshin të atashuar pranë Kupit legalist, për të ndërmarrë sulme luftarake ndaj Wehrmacht-it gjerman, nuk u morën në konsideratë prej zogistëve. Madje, pavarësisht nga qëndrimi antifashist i shpallur dikur në program, zogistët nuk ngurruan që në heshtje të bënin marrëveshje me gjermanët, të ruanin kontaktet me politikanët kolaboracionistë dhe të

përpiqeshin të vendosnin nëpunës e oficerë monarkistë në poste të rëndësishme të administratës dhe në ushtri.

"Ta kishin shkruar një ditë më parë"!

Kështu do të dëshironin ata që festojnë "Bajramin", në ditë "Pashke"! Por ku mund t'ua dinte gjermani midënë qysh atëherë, kur ishin të porsalindur?!? Le t'i referohemi punimit:

"Urdhri për tërheqjen e Wehrmacht-it nga Shqipëria u lëshua më 3 tetor 1944, në të njëjtën kohë me tërheqjen e trupave gjermane nga Greqia dhe Maqedonia. Komandanti i Përgjithshëm gjerman i Juglindjes fluturoi personalisht, më 22 Nëntor 1944 në drejtim të Shqipërisë, për të marrë një vendim për drejtimin e ri në tërheqjen e Korpusit. U vendos, që trupat të ktheheshin në Podgoricë në drejtimin Ura e Bioçes - Vjetarnik - Kolashin - Prijeplje (Serbi), e këto forca do të bashkoheshin me trupat e tjera gjermane që tërhiqeshin nga Maqedonia. Fati i tërheqjes dhe shpëtimi i trupave të Korpamatës XXI përcaktohej nga ura e Bioçes, pranë Podgoricës, e cila u kap prej gjermanëve, ndonëse në gjendje të shkatërruar, më datën 28 nëntor 1944. Kjo urë e ndërtuar mbi lumin Moraça, disa kilometra në jug të Manastirit të Moraçës, me një lartësi prej 50 metrash ishte hedhur në erë, duke u bërë e papërdorshme. Situata e trupave gjermane të "ngëcura" në Shkodër si pasojë e bllokimit të rrugës së



tërheqjes, raportohet edhe në Ditarin Luftarak të Wehrmacht-it për datën 27 nëntor 1944: "Fronti i Adriatikut: Korparmata Malore XXI: presion i vazhdueshëm i bandave (partizanëve - M.K) në pozicionet pengues në jug të Shkodrës. Në jugperëndim të Podgoricës rritje e intensitetit luftarak. Zgjerim i pozicioneve tona në kryeurën Bioçe."

Një ditë më pas, më datën 28 nëntor po në këtë ditar raportohet: "Fronti i Adriatikut: Presion i vazhdueshëm i partizanëve ndaj pozicioneve tona penguese në jug të Shkodrës. Një regjiment i Korparmatës XXI, filloi nga Bioçe më datën 28.11 herët, lëvizjen për të hapur rrugën deri në Matesevo."

Në këto kushte, situata ishte përmirësuar disi për gjermanët, sepse rajoni në të cilin ndodhej ura strategjike ishte marrë dhe lëvizja e trupave të bllokuara në Shkodër, ndërkohë që rruga po çahet me luftim edhe nga drejtimi tjetër, ishte siguruar. Si rrjedhojë, në mbrëmjen e datës 28 nëntor u lëshuan pozicionet penguese në jug të Shkodrës. Në Ditarin Luftarak të Wehrmacht-it lidhur me ngjarjet e datës 29.11.44 është shënuar: "Fronti i Adriatikut: Pozicioni pengues Shkodra është lëshuar nën presionin e bandave në mbrëmjen e datës 28.11. një kompani turkme dezertoi dhe kaloi te armiku. Sulmet e bandave ndaj kryeurës Bioçe janë sprapsur. Hapja e rrugës së tërheqjes është kryer deri në rajonin e Klopotit."

K.V.B. 155
2x
185/XI

Geheim
Tagesmeldung
O.B. Südost
(Ost- u. H. Gr. 2)
an OKW/Wehr. v. 28.11.44.

Bereich O.B. Südost:
1.) H. Gr. 2:
a) Öst-Front:
XXXIV. A.K. s.b.V.:
Jg.-Rgt. - Gruppe 734 mit Anfang Kraljevo eingetroffen. In Abschnitt 7. SS-Geb. Div. (Zurücknahme HKL O Kraljevo auf Stadtrandstellung verläuft ohne wesentlichen Feinddruck. Zäumung der Stadt kann infolge verzögerten Abtransports wichtiger Vorräte - Güter erst Nacht 30.11./1.12. abgeschlossen werden.)
Vor 104. Jg. Div. (Pd.- Angriff 80 Uzice abgewehrt. Bewegung 11. Lw. Feld Div. beiderseits Drina schreitet gut vorwärts. Fischer XXXIV. A.K.s.b.V. unterstellte Fl. 1. Geb. Div. versammeln in Raum Zvornik, um von dort Anschluss an Marschbewegung der Div. zu gewinnen. Voraus- Abt. 11. Lw. Feld Div. 10 SSO Vlasenica auf umfangreiche Straßensperren gestossen.

b) Adria-Front:
XII. Geb. A.K.:
Bandendruck gegen Riegelstellung S Skutari dauert an. Nach Abwehr mehrerer schwächerer Feindvorstöße gegen Br.- Kopf Bioca Gren. Rgt. 523 28.11. früh zu umfassenden Angriff gegen Hochebene Vjetarnik (10 NNO Bioca) angetreten, um von dort Strasse bis Matesevo zu öffnen.

V. SS-Geb. A.K.:
An O-Flügel HKL Mostar wird eig. aktive Kampfführung im Raum Nevesinje erfolgreich fortgesetzt. Feindvorstöße gegen Strasse Sarajevo - Brod bei Susovaca abgewiesen.

c) Marschbewegungen:
Gegen Stadtrandstellung Novi Pazar hat Feind (Bulg.) vorgeführt, Räumung des Ortes Nacht 28./29.11. vorgesehen. Marschbewegungen 41. Pst. Div. und 22. I.D. verlaufen weiterhin planmäßig.
Angriff Rgt. 65 zur Öffnung Jabuka-Paß 28.11. morgens mit Raum 2 N Höhe 1194 (10 NW Prijepolje) erreicht, Feind mit Fln. nach SW ausgewichen.
Wetter: Keine Änderung gegenüber Vortag.

"Faksimile e raportimit ditor sekret në Komandën e Lartë të Wehrmacht-it: datë 28.11.1944"

Më 29 nëntor 1944, trupat gjermane e kishin lëshuar qytetin e fundit më të madh verior të Shqipërisë, Shkodrën. Në raportimin sekret të Komandantit të Përgjithshëm të Juglindjes të datës 30.11.1944 në Komandën e Lartë të Wehrmacht-it, lidhur me këtë ngjarje shkruhet: "[...] b) Fronti i Adriatikut: Korparmata XXI Malore: Shkodra u lëshua, preparoja e div. 297 arriti në Koplík (15 km në veri - veriperëndim të Shkodrës) [...]."

Me këtë veprim kishte përfunduar praktikisht pushtimi gjerman i Shqipërisë dhe trupat gjermane vazhdonin tërheqjen e tyre në drejtim të Gjermanisë. Dokumentet e Ministrisë së Mbrojtjes gjermane nuk heqin dorë të flasin me superlativa për partizanët e Brigadës së Parë (në njërin nga raportimet), edhe pse zakonisht partizanët jo rrallë i quanin "banditë", "terroristë", etj. Pushtuesi foli në gjermanisht, me shkresë të shkruar në 29 nëntor 1944. Ku ta dinte ai (Wehrmacht-i), se ne do të "dëshironim" në fund-shekullin e XX dhe në agun e shekullit të XXI, që ai të ishte larguar më datë 28 nëntor? Ndoshta do të na e kishte bërë këtë "nder" atëherë, edhe pse ishte pushtuesi, edhe pse ishte gjermani skrupuloz... Ndaj do të ishte mirë që kur të botohet libri, nga një kopje t'i shkohet jo vetëm Presidentit, por edhe kryetarëve të partive që festuan çlirimin në Ditën e Pavarësisë. Mbase na shpëton nga kjo dëshirë kobndjellëse, skrupuloziteti (gjerman) i bashkëkombësit tonë, Doktorit të Shkencave Historike, Marenglen Kasmit... Amen!

K.V.B. 168
2x
165
199/XI

Geheim
Tagesmeldung
O.B. Südost
(Ost- u. H. Gr. 2)
an OKW/Wehr. v. 29.11.44.


Bereich O.B. Südost:
1.) H. Gr. 2:
a) Öst-Front:
XXXIV. A.K. s.b.V.:
Nach Hintreffen Jg.- Rgt. - Gruppe 734 in Kraljevo Bewegung 7. SS-Geb. Div. aus Stadtrand- Stellung auf Linie Slatina - Katrap-Preanica angelaufen. In Abschnitt 104. Jg. Div. rege Gef.- Tätigkeit mit Bandenkraften NW Posaqa und N Uzice. Von 11. Lw. Feld Div. keine neue Meldung. Brücke bei Ljubovica 29.11. fertiggestellt. Voraus- Abt. 11. Lw. Feld Div. durch nachhaltige Straßensperren S Vlasenica (Kilometerweit abgesagte Räume) festgehalten, wird zur Fortsetzung weiterer Öffnung Strasse nach Belinjaca durch SS-Regt. Sonderweg vorgetrieben.

b) Adria-Front:
XII. Geb. A.K.:
Räumung Sperrstellung Skutari unter Bandendruck 28.11. abends angelaufen. In Raum Danilovgrad stellten eig. Spätruppe starke Feindbesetzung fest. Aus Resten Gren. Rgt. 363 personelle Neuaufrüstung I./Gren.Rgt. 363 (Stab, 2 Schütz.-Kpn. und eine schwere Kp.) abgeschlossen. Von III. (Turk)/399 eine Turken.Kp. mit Masse zum Feind überlaufen. Btl. wird entwirren. Mehrere gegen -Teil Br.- Kopf Bioca geführte Bandenvorstöße abgewiesen. Angriff verst. gegen Rgt. 523 gegen Hochebene Vjetarnik erreichte gegen Pd.- Widerstand nach Überwindung grösserer Geländeschwierigkeiten Raum um Klopot.

V. SS-Geb. A.K.:
Gegen Bandenbewegungen am linken Flügel HKL O Nevesinje Unternehmen mit III./738 und A.A. 369 angelaufen, Feind weicht nach NW aus. In Raum S Lise mehrere Bandenangriffe, erstmals mit Pa.- Unterstützung, abgewiesen, dabei 1 Pz. abgeschossen. An Hauptstrasse Sarajevo - Brod durch eig. Vorstoss Bandengruppe 80 Susovaca gescheitert. In Raum 20 NW Konjic schloss eig. Truppe in Zusammenarbeit mit Ust.- Einheit den kurzfristigen Säuberungsunternehmen erfolgreich ab. 196 Pd.-Tote gez.; 30 Gewehre und umfangreiche Mun. erbeutet.

c) Marschbewegungen:
XXXIV. A.K. s.b.V.:
Räumung Novi Pazar um 24 Stunden verzögert, im übrigen verlaufen Marschbewegungen flüssig.

"Faksimile e raportimit sekret ditor në Komandën e Lartë të Wehrmacht-it për situatën e datës 29.11.1944"



Libri më i vjetër në bibliotekën e AFA-së

Vendi i librit në FA

Sot jetojmë në një shoqëri të dijes, ku informacioni dhe përgatitja intelektuale prodhojnë një vendimmarrje inteligjente dhe ekzekutim të zgjuar të vendimeve të marra. Vendi ynë ka nevojë për një trupë me ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe punonjës civilë që të kenë vetëdijen e duhur qytetare, atdhetare dhe etike. Njëkohësisht ata duhet të kenë përgatitjen ushtarake, profesionale dhe intelektuale, e mbi të gjitha të janë të vetëdijshëm për rolin e ri kombëtar dhe ndërkombëtar të Forcave tona të Armatosura, kjo edhe në kuadër të mbrojtjes kolektive të NATO-s. Ndaj, në këtë kontekst, vendosja e një raporti më të avancuar të ushtarakut me librin dhe informimin në tërësi është i domosdoshëm. Për të afruar përgatitjen shumë-planëshe të ushtarakëve para një viti u ngrit sistemi i integruar i librit dhe mbështetjes me informacion, i cili si mision ju përcaktua: studimi i nevojave të FA, planifikimi, blerja dhe botimi, menaxhimi e afrimi i shërbimit të librit

dhe informacionit në tërësi. Në koncept paper të miratuara nga Ministria e Mbrojtjes për organizimin dhe funksionimin e QLMI-së në FA është theksuar si detyrë për zhvillimin e konceptit të Sistemit të Integruar të Bibliotekave si dhe të Bibliotekës Dixhitale. Ky sistem integral i menaxhimit të librit dhe materialeve të tjera të printuara do mundësonte harmonizimin dhe studimin e nevojave të njësive të FA, përzgjedhjen dhe miratimin e materialeve, koston dhe buxhetimin, përgatitjen për botim dhe botimin, si dhe në fund distribuimin dhe menaxhimin nëpërmjet sistemit bibliotekar. Sot FA dhe raporti që ka me librin, si atë të botuarin edhe atë dixhital, nuk është ai i duhuri. Konferenca për librin dhe bibliotekat që organizoi QLMI, në zbatim të Urdhrit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, nr. 265, datë 06.05.2013 "Për përmirësimin e punës me Librin dhe Bibliotekat në Forcat e Armatosura", është ngjarje e rëndësishme për FA, pasi ajo i ngjan këmbanave të alarmit.



Të rikthejmë librin në bibliotekat ushtarake



Puna për të ardhmen e librit dhe bibliotekës dixhitale në FA



Njeriu dhe libri në kohën e internetit

Të rikthejmë librin në bibliotekat ushtarake

GJENERAL BRIGADE BARDHYL HOXHA

Konferenca për librin dhe bibliotekat që organizon QLMi, në zbatim të Urdhrit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, nr. 265, datë 06.05.2013 "Për përmirësimin e punës me Librin dhe Bibliotekat në Forcat e Armatosura", është ngjarje e rëndësishme për FA. Të gjithë e dimë që Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes, në misionin e saj, ka prioritet organizimin e veprimtarive mësimore kualifikuese edhe në sektorë të tjerë siç është dhe puna me librin dhe bibliotekat në FA. Këtij qëllimi i shërben dhe kjo konferencë, e cila është një lloji të veçantë, në kuptimin e mesazhit që ajo mbart e përcjell. Kjo konferencë ka përparësi pasi theksin do ta vendos në vendin dhe rolin që ka e duhet t'i jepet librit dhe bibliotekave në strukturat e ushtrisë shqiptare. Punimet e kësaj konference i kemi organizuar në një kohë kur flitet për procese integrimesh e globalizimesh, kur diskutohet për përfaqësim në burime digjitale dhe bëhen përpjekje për krijime portalesh, ndërmerren nisma dhe projekte për përfshirje në rrjetin global jo vetëm të bibliotekave, por edhe të muzeve dhe arkivave. Konferenca shënon një ngjarje jo të zakonshme për zhvillimet e bibliotekonomisë në FA. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë e vijojnë të ndërmerren nisma digjitale, dhe dita-ditës koleksionet me vlerë kombëtare po pasqyrohen gjithnjë e më shumë në portale euro-atlantike, në portale që flasin tanimë edhe shqip. Po ne ku jemi? Është një pyetje që vjen natyrshëm tek të gjithë. Libri gjithnjë ka pasur dhe ka një rëndësi të madhe. Libri është mjet transmetues i mesazhit, kulturës dhe civilizimit brez pas brezi. Libri është mjet i mendimit dhe plotësues i njeriut. Me anë të këtij mjeti mund të matet fuqia dhe potenciali i njeriut nga aspekti shkencor dhe dijetar. Në epokën e sotme masmedia i janë shtuar mjete të ndryshme komunikimi dhe ndërlidhjeje, por libri nuk e ka humbur vlerën e tij dhe nuk është vjetërsuar kurrë. Libri është një trashëgimi e përhershme dhe fenomen tepër i vlefshëm në jetën e njeriut. Libri dhe Biblioteka shpesh janë krahasuar me gjithësinë, që gjithmonë rri hapur para syve tanë dhe shkon drejt një zgjerimi të përhershëm. Bibliotekat mund të ndihmohen

nga arritjet teknologjike, por funksioni kryesor i tyre mbetet të qenit shtëpi kujtese e imagjinate, ku ruhet përvoja e mendjeve më të ndritura të njerëzimit. Në bibliotekë ruhen gjurmët e historisë. Aty bashkohet e kaluara, e tashmja dhe ndrit vizioni për të ardhmen. Shtrohet pyetja: Sa ne i japim sot rëndësi të veçantë botimit të librit, leximit të tij, pajisjes së bibliotekave me libra? Fakti që jemi mbledhur këtu sot është kuptimplotë. Dhe ngritja e Qendrës së Librit është një gur në themelet e "Kështjellës së librit", po a mjafton? Sa kemi biblioteka të hapura në forca dhe njësitë e FA? Sa është fondi i tyre dhe sa furnizohen me botime të reja? Edhe këtu duhet ndalur dhe menduar shumë e shumë për të dhënë një vlerësim të duhur. Ajo që është më karakteristike dhe për t'u shqetësuar, është funksionimi ose mosfunksionimi, pajisja ose mospajisja, furnizimi ose mosfurnizimi i bibliotekave. Në njësi e reparte ekzistojnë biblioteka për të thënë, por ato janë në gjendje jo të mirë. Sa është i përshtatshëm ambienti ku është vendosur. Këtë të gjithë e dimë shumë mirë. Dhe tani: duhet t'i rikthejmë bibliotekat në forca e njësi dhe t'i pajisim ato me libra. Libri duhet të jetë përsëri në duart e ushtarakëve tanë. Duhet t'i japim një rëndësi dhe kontribut të madh për botimin, ruajtjen dhe leximin e librit, sepse ai ka vlerën e vet shumë të madhe dhe të çmueshme. Ne duhet të angazhohemi për të vënë librin në vendin e merituar që ai ka. Duhet të krijojmë kushte në biblioteka, ti pajisim ato me libra, ti lexojmë dhe të mbjellim dashurinë tek gjeneratat e reja ndaj librit, të leximit të tij. Sa i përket bibliotekave dhe librit duke lexuar atë aq më tepër do të jemi më të pasur me dituri, sepse vetëm me lexim dhe dituri do të ecim përpara. Të afrojmë botues dhe dashamirës të librit që të na bëjnë dhurata me libra, për të cilin kemi të gjithë shumë nevojë të domosdoshme. Leximi është ushqim për trurin tonë. Librat na japin dituri. Librat na inspirojnë. Librat na dhurojnë guxim. Librat na mësojnë që të jemi të kujdesshëm ndaj të tjerëve. Duke lexuar libra, ne besojmë, ne mësojmë nga përvojat, dituria dhe ngjarjet dramatike të jetës së shumë njerëzve. Ju lutemi shijoni botën e mrekulueshme të librave që kini para jush! Ne thëllësisht dëshirojmë që në të ardhmen të gjendemi në një rrugë të paqes dhe të lumturisë për të gjithë.

Puna për të ardhmen e librit dhe bibliotekës dixhitale në FA

PROF. ASSOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Sot jetojmë në një shoqëri të dijes, ku informacioni dhe përgatitja intelektuale prodhojnë një vendimmarrje inteligjente dhe ekzekutim të zgjuar të vendimeve të marra. Vendi ynë ka nevojë për një trupë me ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe punonjës civilë që të kenë vetëdijen e duhur qytetare, atdhetare dhe etike. Njëkohësisht ata duhet të kenë përgatitjen ushtarake, profesionale dhe intelektuale, e mbi të gjitha të janë të vetëdijshëm për rolin e ri kombëtar dhe ndërkombëtar të Forcave tona të Armatosura, kjo edhe në kuadër të mbrojtjes kolektive të NATO-s. Ndaj, në këtë kontekst, vendosja e një raporti më të avancuar të ushtarakut me librin dhe informimin në tërësi është i domosdoshëm. Për të afruar përgatitjen shumë-planëshe të ushtarakëve para një viti u ngrit sistemi i integruar i librit dhe mbështetjes me informacion, i cili si mision ju përcaktua: studimi i nevojave të FA, planifikimi, blerja dhe botimi, menaxhimi e afrimi i shërbimit të librit dhe informacionit në tërësi. Në koncept paper të miratuara nga Ministria e Mbrojtjes për organizimin dhe funksionimin e QLMI-së në FA është theksuar si detyrë për zhvillimin e konceptit të Sistemit të Integruar të Bibliotekave si dhe të Bibliotekës Dixhitale. Ky sistem integral i menaxhimit të librit dhe materialeve të tjera të printuara do mundësonte harmonizimin dhe studimin e nevojave të njësisë të FA, përzgjedhjen dhe miratimin e materialeve, kostimin dhe buxhetimin, përgatitjen për botim dhe botimin, si dhe në fund distribuimin dhe menaxhimin nëpërmjet sistemit bibliotekar. Ky sistem integral përqendron procesin, duke e bërë atë më pak të kushtueshëm, të kontrollueshëm, më efikas dhe më eficient në të gjitha pikëpamjet. Procedura e blerjes dhe botimit të librit jo ushtarak është ende me mangësi. Si pasojë e mos planifikimit të integruar të nevojave, nuk ka një fond vjetor të programuar, si për botimet e FA dhe për blerjen e librit artistik dhe studimor. Ndërsa procesi i botimit të materialeve të tjera të printuara, duke përfshirë dhe materialet promovionale,

vazhdon të jetë i decentralizuar dhe nga qendra ende është i pakontrollueshëm. Problematik vazhdon të jetë dhe sistemi bibliotekar. FA kanë aktualisht në administrim biblioteka e minibiblioteka. Titujt e librave që kanë në dispozicion këto biblioteka janë kryesisht të karakterit ushtarak dhe libri artistik është botim i viteve '90-të të shek. XX. Mënyra e organizimit dhe administrimit është e fragmentuar dhe joefikase. Disa komanda dhe reparte kanë bibliotekë me punonjës të dedikuar si bibliotekist, ndërsa të tjera kanë thjesht një magazinë ku gjendet dhe libri. Biblioteka e AFA në KDS-së, ka organizimi dhe është në gjendje të mirë. Si pasojë, ka rënie të nivelit të lexueshmërisë së librit, dhe vështirësi në mbështetjen me informacion të gjithanshëm të personelit në FA. Pse u kërkua dhe u ngrit QLMI ose me thjeshtë sistemi integral i planifikimit, blerjes, botimit e menaxhimit të librit dhe mbështetjes me informacion të FA? Standardizimi i këtij procesi u rekomandua të mbështetej mbi bazën e tre parimeve substanciale: planifikimi dhe programimi; blerja, përkthimi dhe botimi; shpërndarja dhe menaxhimi. E para, planifikimi dhe programimi. Mekanizmi i planifikimit dhe programimit të nevojave të FA për blerje dhe botim të librave u rekomandua të ndahet në dy komponentë, në bazë të specifikave dhe qëllimit të librave të blerë apo botuar. Procesi i hartimit, botimit dhe blerjes së libri të mirëfilltë ushtarak (manuale, rregullore, libra kërkimor ushtarak) rekomandohej të menaxhohej nga një bord i ngritur në Shtabi i Përgjithshëm i FA. Mbledhja e nevojave për librin ushtarak, doktrinave, rregulloreve dhe manualeve në njësitë e Forcave të Armatosura bëhet nga Qendra e Doktrinave në KDS-së. Procesi i përkthimit, hartimit, botimit dhe blerjes së librit civil (literaturë artistike, botime në fushën e sigurisë, filozofi, botime në fushën e estetikës, modës, etj), rekomandohej të menaxhohet nga bordi i librit në QK-MBM. I gjithë ky procesi i harmonizimit të nevojave të FA për libra dhe botime të tjera do të kryhej nga Qendra e Librit dhe Mbështetjes me Informacion të FA. E dyta, botimi dhe blerja e librit. Bordet e librit mbi bazën e planeve vjetore për blerje, përkthim dhe botim të librave e miratojnë te Ministri i Mbrojtjes kërkesa që duhen në FA



për një vit. Qendra e Librit dhe Mbështetjes me Informacion të FA ekzekuton planet vjetore në mbështetje të urdhrimit të Ministrit të Mbrojtjes dhe me buxhetin e përcaktuar për këtë qëllim, bazuar në një procedurë standarde për hartimin, botimin dhe blerjen e librit. E treta, shpërndarja dhe menaxhimi. QLMI-ja duke qenë përgjegjëse për distribuimin e librit dhe materialeve të tjera të botuara në bazë të planeve vjetore të miratuara nga bordet përkatëse të miratuara, duhej që ta menaxhonte këtë procedurë. Ndërsa menaxhimi i librit realizohet nëpërmjet një sistemi të përqendruar të bibliotekave të FA, të cilat do të jenë në varësi të QLMI-së. QLMI u vendos në varësi të KDS-së dhe është e organizuar me tre sektorë: të planifikimit dhe përgatitjes për botim, të bibliotekave dhe të mbështetjes. Sistemi i bibliotekave. Organizimi i sistemit të bibliotekave është mbështetur në parime si: përqendrim të menaxhimit dhe administrimit të bibliotekave; përqendrim fizik në përputhje me përqendrimin e Forcave të Armatosura. Praktikën më të mira të vendeve anëtare të NATO-s dhe jo anëtare tregojnë se përqendrimi i menaxhimit të rrjetit të bibliotekave është mënyra më efikase dhe efektive për përmbushjen e misionit të tyre. Përqendrimi dhe profilizimi. Përqendrimi dhe profilizimi i bibliotekave është bazuar mbi parimet e funksionalitetit të tyre dhe përhapjes territoriale të FA. Bazuar mbi këto principe, FA kanë sot një bibliotekë qendrore, dhe disa biblioteka dhe minibiblioteka të vendosura në garnizonet e FA-së. Automatizimi dhe informatizimi. Automatizimi na çon në krijimin e Sistemit të Integruar të Bibliotekave. Ky është një sistem për menaxhimin e automatizuar të bibliotekave, si dhe lidhet me planifikimin e resurseve për bibliotekat. Sistemi i Integruar i Bibliotekave do të përbëhet nga një database qendror, ky i lidhur e databaset e bibliotekave. Software i sistemit të integruar në QLMI do të ketë si minimum dhe disa modele që e ndihmojnë atë për të menaxhuar informacionin me planifikimin, blerjen dhe botimin. Sistemi i Integruar i Bibliotekave do të vendoset në secilën prej bibliotekave dhe do të ketë si minimum module për të kryer shërbimin e katalogimit, qarkullimit dhe kërkimit. Në këtë formë çdo përdorues i bibliotekës do të ketë një ID unike duke bërë që database të lejojë Sistemin e Integruar të gjurmë aktivitetin e secilit përdorues. Biblioteka dixhitale. QLMI ka si detyrë primare ndërtimin e Bibliotekës Dixhitale të FA. Kjo bibliotekë do të shërbejë për të gjithë personelin

e saj pavarësisht vendndodhjes gjeografike me anë të shërbimit të internetit. Biblioteka Dixhitale do të përfshijë disa kategori të librit (lushtarak, filozofik, artistik etj); dokumentat, manualet, rregulloret; dokumentet zyrtarë (ligje, akte nënligjore, urdhra, udhëzime, direktiva etj); periodikë (Gazeta, Revista etj). Ndërtimi i bibliotekës dixhitale të FA ka filluar me zhvillimin e konceptit, prokurimin e sistemit dhe vendosjen në funksion të këtij sistemi. Nëpërmjet QLMI-së përcaktohet se çdo material, i blerë apo botuar nga MM dhe strukturat në varësi të saj, do të jetë në format print dhe elektronik. Krijimi i bibliotekës dixhitale do të lehtësojë në maksimum aksesin në literaturë dhe informacion të personelit të Forcave të Armatosura. Kjo kontribuon në rritjen e kapaciteteve njerëzore në FA. Qendra e Librit dhe Mbështetjes me Informacion (QLMI) e ka filluar aktivitetin e saj më datën 1 tetor 2012, në kuadër të kalimit të KDS-së në Strukturën e Re. Gjatë kësaj periudhe vëmendja është përqendruar në zbatimin e ligjit për Librin dhe Bibliotekat në RSh, në urdhrat e Ministrit të Mbrojtjes, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe të Komandantit të KDS-së, e kryesisht për organizimin, funksionim dhe zhvillimin e QLMI-së. Së pari, Qendra e Librit dhe Mbështetjes me Informacion ka punuar për konceptimin e misionit, përgjegjësi, si dhe të detyrave të shtruara në vijimësi nga Direktiva e Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe komandanti i KDS-së. Mbi bazën e urdhrimit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, dhe planit të kontrollit nga komandanti i KDS-së, është verifikuar gjendja konkrete e librit dhe e bibliotekave në FA. Mbi bazën e këtij kontrolli dhe të gjendjeve të tyre është bërë dhe një raport i detajuar për Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve. Mbi bazën e këtij raporti në muajin maj 2013 ka dalë dhe urdhri për punën me librin dhe bibliotekat në FA. Së dyti, kjo qendër ka përfunduar studimin si dhe ka bërë preventimi për ngritjen e bibliotekës dixhitale në KDS, në bibliotekën e AFA, si dhe ka bërë planifikimi për vitin 2014 në lidhje me pajisjet për ngritjen dhe zhvillimin e bibliotekës dixhitale për FA. Në vijim është organizuar dhe një seminar me të gjitha strukturat e FA për punën me librin dhe bibliotekat, ku është zëbërthyer urdhri i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve në lidhje me këtë problem. Me vëmendje është ndjekur dhe



janë përcaktuar përgjegjësitë e personelit, si dhe rregullorja e brendshme e QLMI-së, tashmë të miratuara nga strukturat përgjegjëse të saj. Së treti, prej QLMI-së janë iniciuar dhe zhvilluar në bashkëpunim edhe me struktura të tjera veprimtari që kanë të bëjnë me historinë, sigurinë, mbrojtjes, arsimimi dhe kulturën e FA-ve, të tilla si: për jetën dhe veprën e Skënderbeut, për Kosovën, për Ditën e Librit, për Ditën e Evropës, për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, si dhe Ditën e Mjedisit, për Luftën e Vlorës etj. QLMI, ka vendosur një bashkëpunim me Bibliotekën Publike "Marin Barleti" Shkodër, si dhe Bibliotekën Kombëtare në Tiranë. Në vijimësi ka bashkëpunuar dhe me strukturat e AFA, QKMBM, AQFA, MFA etj. Theksojmë se në vijimësi është pasqyruar veprimtaria e saj në organet e shtypit ushtarak, në gazetën "Ushtria", në revistën "Mbrojtja" dhe Revistën Ushtarake. Aktualisht është përfunduar listimi elektronik i librit në FA, të ndarë në zëra si: libri ushtarak, artistik, rregullore dhe libri në gjuhë të huaj, sipas forcave, por dhe e përgjithshme. Kjo detyrë ka kapur një periudhë të gjatë kohore, pasi është evidentuar gjendja e librit në të gjitha strukturat e FA. Tashmë libri është i listuar dhe me modernizimin e bibliotekave të gjendet gjithë inventari në FA. Gjithashtu ka përfunduar dhe përmbledhja e librave të shkruar nga ushtarakë shqiptarë për Luftën e Kosovës, për Skënderbeun, për Luftën e Vlorës, si dhe librat e botuara nga KDS-ja nga viti 2004 e në vazhdim. Nga qendra është kompozuar faqja e internetit e saj, si strukturës e KDS-së dhe kanë përfunduar të gjitha materialet. Së shpejti fillon hedhja e tyre në këtë faqe. Kemi filluar dhe punën për modelimin e dy librave për ngritjen e bibliotekës dixhitale të KDS-së, (Bibliotekës së AFA), për vitin 2014. Por, ende ka probleme me librin dhe bibliotekat në FA, sidomos në njohjen dhe përpunimi e librit ushtarak në tërësi, në njohjen e nevojave dhe të botimeve. Ka probleme në lidhje me promovimin e vlerave të librave ushtarakë, sidomos në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, standardizimit dhe informacioni në vijimësi. Në stadin aktual të procesit të reformimit të FA, botimi i librit ushtarak, përpunimi i tij në biblioteka, standardiz-

imi, si dhe informimi janë probleme të domosdoshme e që kërkohet vëmendje e veçantë në të ardhmen. Aktivizimi i strukturave të FA, në nivel ekspertë, për sistemin e librit në biblioteka, si dhe shfrytëzimin në maksimum të teknologjisë e shkëmbimit të tij "online", për të dhënë e marrë informacion. Qendra, për pasurimin e bibliotekave të Forcave e reparteve, ka kërkuar blerjen e librave shqip dhe të huaj që vlejné për FA. E gjithë kjo sipas fushave përkatëse, të hartuara nga komandat/drejtoritë në MM/SHP, në mbështetje të planit vjetor të standardizimit dhe të propozimeve standardizuese e që burojnë nga programi i standardizimit i NATO-s. Ndoshta ka ardhur koha për rishikimi dhe përmirësimi të mëtejshëm të bazës ligjore, si dhe miratimi të saj, për të siguruar mbështetje të plotë për librin, bibliotekat dhe informacionin në FA. Standardizim i librit ushtarak dhe krijimi i një "Database" të të dhënave elektronike për të gjitha botimet e FA, si dhe sigurimin e publikimit e tyre "online". QLMI-ja strukturë në Komandën e Doktrinës dhe të Stërvitjes, kërkohet që të jetë më bashkëpunuese duhet u ndodhur dhe gjendur në mjaft veprimtari të rëndësishme të FA-ve, do ta luaj më mirë rolin parësor në punën me librin dhe bibliotekat. Roli i QLMI-së në përkujtimin e ngjarjeve historike është i rëndësishëm, pasi Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes është i vetmi institucion i FA-ve me personel dhe kapacitete të larta intelektuale dhe akademike. Përqendrimin i punës për profilizimin dhe dixhitalizimin e gjithë procesit të botimit, blerjes dhe menaxhimit të librave dhe materialeve të tjera të printuara në FA, do të jetë një prej sfidave të saj në të ardhmen. Rëndësia e procesit të menaxhimit të librit dhe të bibliotekave, ka vlera pasi e bën atë më pak të kushtueshëm, lehtësisht të kontrollueshëm, efikas dhe eficient në të gjitha pikëpamjet. Ngritja e bibliotekës dixhitale në KDS, pra biblioteka e AFA; pjesëmarrje në panaire brenda vendit dhe jashtë të librit ushtarak, si dhe çelje të fondit nga çdo strukturë për blerje libri dhe pasurim të bibliotekave të FA- do të jenë përparësitë e saj në vitin 2014 e në vazhdim.



Njeriu dhe libri në kohën e internetit

Elektronika, mik apo armik i leximit?...

NGA PANO HALLKO

Sot, jetojmë në një periudhë tranzitore, në të cilën përmbysen mite(që duhen përmbysur), por më së shumti përmbysen vlerat. Në udhëkryqet e qyteteve vëmë semaforë mitesh, për qarkullimin e miteve. Njerëz të rëndomtë, shpesh me vetëdije haluçinante, shëtisin me veturat më luksoze-të muajit të fundit. Sot, thuajse kudo në botë, Dollari(pse jo Euro sot), është feja monoteiste mbi tërë pluralizmin fetar, mbi gjithçka, mbi jetën dhe vdekjen e secilit, mbi trupin dhe shpirtin, mbi alfën dhe omegën e moralit. Letërsia e vërtetë është rebelim konceptual. S'ka se si të jetë ndryshe. Banaliteti i shoqërisë së konsumit dhe pop-hedonizmit kërcënon gjithçka, por mbi të gjitha letërsinë dhe artin. Post-modernizmi është një dilemë, por s'mund të jetë art. Kjo duhet kuptuar: Perceptimet e pjesshme, nuk janë vetëdije. Dekadencia, sado të përpiqemi, nuk mund të estetizohet. Tani, ky është fenomeni i përbotshëm, por i sjellë keqazi në realitetin tonë. Sepse bota i ka zgjidhur hallet e rënda të saj, për pasojë ajo është në gjendje edhe të mjekojë më lehtë shumë plagë të shoqërisë apo të personit. Gjendja dhe raporti i sotëm të njeriut me librin në vendin tonë, mund të përshkruhet më mirë me thënien e Tertulianit: "verum est, quia absurdum est"(Është e vërtetë, se është absurde). Para Gjon Buzukut, ne shqiptarët nopranë, rebelë të lirisë por jo të vizionit, nuk ishim Popull i Librit. Me Gjon Buzukun, ne u bëmë Popull i Librit. Ky popull, deri para dy dhjetëvjeçarësh, në masën 70%, ishte Mik i Librit. E këtu nuk kam parasysh vetëm ata që me shumë mund e djersë fitonin Çmimet "Miku i Librit" apo deri edhe "Miku i Madh i Librit". Ishte e vështirë të gjeje karrige të uleshe, jo vetëm në Bibliotekën Kombëtare, por edhe në Bibliotekat e Lagjeve. Nuk ishin me orë të tëra të gozhduar në tavolina vetëm ata që studionin për "ngritjen e tyre ideopolitike". Por tek e fundit, edhe këta lexonin, mbanin shënime, pra shkruanin, por shkruanin drejt, pastër dhe pa gabime, pasi përveç njohurive jo të pakta që merrnin në shkollë për Shq-

ipen Standarde, në fund të fundit, e konspektonin ashtu siç ishte shkruar: Dhe librat deri aty nga fillimvitet '90-të, në fund kishin një fletëz të vogël me titull "Ndreqje gabimesh". Domethënë, për gabime drejtshkrimore, nuk bëhej fjalë as teorikisht. Këta njerëz pasuronin njohuritë e tyre, bëheshin njerëz më të kompletuar me të cilët mund të uleshe, e të kishe ç` të bisedoje. Por shumica ishin njerëz të profesioneve të ndryshme të jetës, qysh nga hidrauliku e deri tek agronomi, inxhinieri e kryeinxhinieri që luftonin për të ngritur nivelin e tyre teknik e profesional, për të arritur të merrnin kategorinë më të lartë në profesionin e tyre, pasi kategoria ishte përveç të tjerash, edhe para. Ashtu siç edhe sot, grada në ushtri përveçse vlerësim, besim e dinjitet, është edhe pagë më e lartë. Ata ushtarakë që sot mbajnë gradën Nënkolonel e lart, janë dëshmitarë të faktit se sa orë kanë qëndruar në bibliotekën e Akademisë, sa libra kishin në shtëpi, sa literaturë artistike kanë lexuar. Deri në vitin 1990, Biblioteka e Akademisë sonë ishte e abonuar në 16 Revista shkencore ushtarake të huaja. Sot, asnjë revistë apo periodik nuk hyn brenda saj.

LIBRI, PASQYRË E NJERIUT...

Thuhet se dyshimi është cilësi e njeriut të zgjuar. Por pa lexuar, as mund të bëhet fjalë për zgjuarsin. Dyshimin në trajtë instinkti, për herë të parë njeriu e përjetoi kur njohu pasqyrën. Njëherë, në një vend, ku nuk ekzistonte pasqyra dhe nuk dihej asgjë për të, njerëzit nuk kishin dyshime. Mungesa e dyshimeve qe lumturia dhe vdekja e tyre. Një trill mistik bëri që një pasqyrë të shfaqej diku midis popullit të vetmuar dhe vendit fantazmagorik, ku nuk ekzistonte as ideja më e vogël e pasqyrave.


...Një burrë i ri, luftëtar, në shesh-betejë pas lufte, gjeti një pasqyrë. Dorëdridhur e kapi pasqyrën, e afroi para vetes. Pa fytyrën e tij. Kurrë nuk e kishte parë ndonjëherë këtë fytyrë, ndaj dhe nuk e njohte. U trondit jashtë mase dhe tha: "Paska ardhur vëllai im! Si ka mundësi që nga gjithë trupi i vëllait unë të mbaj në duar vetëm fytyrën e tij?" Imajjioni një fytyrë pa trup! U tremb për vdekje. Nuk mund ta shpjegonte enigmën. E mori pasqyrën dhe e fshehu te sh-

tresat e krevatit ku flinte. Rastësisht gruaja e tij duke rregulluar shtresat, pa formën rrethore e të shndritshme të pasqyrës. U shtang, por nuk e përmbajti veten dhe e mori pasqyrën para fytyrës së saj. Pa fytyrën e një vajze të re që ishte vetë ajo. E mahniti dhe e tmerroi bukuria e fytyrës. O Zot, tha nusja, kjo qenka fytyra e motrës sime. Qenka më e bukur sesa unë. E shkreta ç'më gjeti, im shoq po më tradhton me motrën time, me fytyrën e saj, por pa trupin e saj. U lebetit, nuk dinte ç'të bënte, nuk e mbajti brengën pa shpërthyer dhe shkoi te vjehrra e saj për t'i treguar se djali që ajo kishte për burrë nuk ishte më i dëlirë. e kishte braktisur, e kishte poshtëruar. I tha vjehrrës se kishte gjetur fytyrën e motrës, me të cilën mahnitej tani i shoqi dhe që fshehurazi e kishte mbuluar te shtresat e krevatit. -Nuk është e mundur,-tha nëna e dhëndrit. -Ja prova e fajit,- ia ktheu nusja me ngashërim dhe hakërrim, shihe me sytë e tu tradhtinë, bindu për pabesinë. Atëherë e vjehrra mori pasqyrën dhe vështrroi në të. Pa një fytyrë të plakur dhe të thijnur: dy sy të pikëlluar dhe të lodhur nga jeta. një tendosje midis lumturisë dhe zhgënjimit. Ajo kishte dëgjuar fjalët e së resë për hakmarrje. Fytyra e plakur e zbuti. Mos, i tha nuses, mos u hakmerr, fale, sepse qenka një grua e plakur, nuk është e re si ty. Atëherë vjehrra e hodhi pasqyrën, pasqyra u zhduk dhe vendi që nuk e kish njohur kurrë pasqyrën mrekullisht mbeti pa asnjë pasqyrë. Të nderuar zonja e zotërinj! E solla në bisedën e sotme këtë histori, për t'i mëshuar faktit tanimë të njohur se çdo libër është një pasqyrë. Autori shikon aty fytyrën e tij dhe e ngatërron me një binjak, që nuk ekziston. Edhe lexuesi gjen veten në njërin nga personazhet e shumtë të librit, gjen të përshkruar thujse shumicën e halleve dhe problemeve që ai ka kaluar ose kalon në jetën e vet. Por në varësi të shkrimtarit dhe të veprës, ai në brendinë e librit, gjen edhe rrugëzgjidhjet për hallet e problemet, e më së paku gjen optimizmin për të luftuar me ndershmëri dhe dinjitet. Thuhet se bibliofilia (libërafshi) është e barabartë me instinktet më të fuqishme të njeriut. që janë: uria, etja dhe seksi. Librat janë ndoshta një ndërthurje e këtij triniteti instinktesh. Mendja e njeriut nuk mund të zhvishet nga substanca e instinkteve. Është trupi që e komandon më shpesh shpirtin, e stomaku bëhet kështu furnizues për idetë e trurit. Ky skajim vulgar nuk duhet të na lodhë, as të na revoltojë, e as të na çuditë. Mençuria qëndron në të kuptuarit relativ dhe aspak në të kuptuarit absolut. Njeriu dhe sendet mund të organizohen në një libër. Por nuk mund të jetë vetëm një libër. Një shumësi e librave mund të prezantohet si një libër pa fund, libër, që njeriu. vdekatar i zakonshëm por dhe deliranti gjenial, nuk mund ta lexojë dot kurrë. Vetëm tek e pjesshmja ne mund të gjejmë të përgjithshmen. Ne mund të abstragojmë vetëm të nisur nga realitetet tona. Kështu shkrimtarët shkruajnë libra, të cilët u përkasin më shumë të tjerëve sesa atyre vetë.

A KEMI KOHË PËR TË LEXUAR?

Çdo gjë ka kohën dhe stinën e vet, çdo situatë e ka një kohë nën këtë qiell. Ekziston një kohë për të lindur dhe një kohë për të vdekur; një kohë për të mbjellë dhe një kohë për të korrur; një kohë për të vrarë dhe një kohë për të shëruar; një kohë për të rrënuar dhe një kohë për të ndërtuar; një kohë për të qarë dhe një kohë për të qeshur; një kohë për të vallëzuar dhe një kohë për të mbajtur zi; një kohë për të flakur gurët dhe një kohë për t'i mbledhur gurët; një kohë për të fituar dhe një kohë për

të humbur; një kohë për t'u kursyer dhe një kohë për t'u flakur tutje; një kohë për të grisur dhe një kohë për të qepur; një kohë për t'u dashuruar dhe një kohë për të urreyer; një kohë për Luftë dhe një kohë për Paqe; një kohë për të folur dhe një kohë për të heshtur. Përrjashtoj gjendjen e vdekjes, në të gjitha gjendjet dhe situatat e tjera, njeriu e ka dhe e gjen kohën për të lexuar. Ka një mijë dete dhe oqeanë që nuk mund t'i njohin kurrë gjeografët, por as historianët. Ato janë detet dhe oqeanet e shpirtit njerëzor. Dhe inxhinierët e shpirtit në të gjithë botën, e në përfundim ku ne duam të shkojmë, janë shkrimtarët, romancierët, novelistët dhe poetët. E këtë inxhinieri të tyre, ata e shpallin në veprat artistike që shkruajnë, përkatësisht zhanrit që lëvrojnë. Në Historinë e re të njerëzimit, themeluesi dhe i pari Kryetar, i të parit Kongres të Paqes botërore, ishte njëri nga shkrimtarët më të ndritur, Viktor Hygoi. Kombi ynë, ia detyron ngjizjen e ndërjegjes së tij kombëtare, Rilindësve në përgjithësi; por në mënyrë të veçantë Poetit tonë Kombëtar, Naim Frashërit. Ushtaraku brenda misionit të tij të shenjtë, është edhe mësues, mësues i trupave që ai komandon. E më së pari është mësues i Gjuhës Shqipe, pasi ai në shqip komunikon me vartësit, në shqip e krijon frymën e atdhedashurisë, në shqip e merr misionin dhe në shqip e jep, në gjuhën shqipe i ka hedhur trupat në luftë dhe do t'i hedhë nëse do të lindë nevoja. Pra, nuk mund të nënkuptohet ushtarak brenda misionit të tij, pa njohur shumë mirë gjuhën dhe historinë e kombit të vet. Nëse shikohen në këto vite teste të plotësuara me shkrim dore nga aplikantët për ushtarë profesionistë-të cilët janë edhe me Universitet-më së paku baçelor-të lutem, menjëherë të shkon mendja të...hapësh ...Kurse për... Luftën Kundër Analfabetizmit! Pra, t'ia nisësh nga shkrimi i emrit. Por që të mundësojë realizimin e këtij roli të madh e fisnik, ushtaraku më së pari duhet të lexojë, e kur them




të lexojë, nuk nënkuptoj vetëm rregulloret, manualët apo materiale të tjera, por më së pari, letërsi artistike. Gjuha shqipe është ajo që na ka bërë ne të gjithëve, ne lindim dhe vdesim përmes saj, fizikisht jemi të vdekshëm, gjuhësisht jemi të amëshuar, nuk mund të ndahemi vetëm në të vdekshëm apo vetëm në të amëshuar, jemi të përzier, jemi të dyzuar, jemi vetë kontradikta e mishëruar, jemi vetë përfaqësimi i paradoksit, jemi simbol i gjallë dhe send, jemi ide dhe molekula fizike, jemi ata që jemi, pa harruar se jemi dhe ata që kemi qenë dikur dhe se do të jemi dhe ata që do të vijnë më pas, të ndërlidhur pambarimisht nga fjalët e gjuhës shqipe. Gjuha shqipe është gjuhë fantastikisht e madhërishme, dhe ka një idiomë parahistorike në strukturën e saj. Ajo ruan diçka gjuhësisht të tejlashtë të një gjuhe të vdekur paraardhëse, paraindoeuropiane, pastaj ruan strukturën indoeuropiane, strukturë e cila është më tepër një energji lëvizëse. Gjuha shqipe është formësuar edhe nga një moment antropologjik dhe gjeografik në njëkohësi të plotë, duke mbajtur përherë të zbuluar dhe në dritë mes territ të kohës, burimin e saj indoeuropian.

ELEKTRONIKA, MIK APO ARMIK?...

Në djerrakohën e sotme, ku ritmi është vetëm tautologji dhe vulgariteti modern është një stilistikë e zbrazët; thënë ndryshe rend ceremonial bizantin i shndërruar në sfilata apo në striptizmin e klubeve të natës, kur të gjithë jemi skllëvër të demonit televiziv, e që kjo mund të konsiderohet hakmarrje teologjike, e fundmja gjë që u shkon ndërmend njerëzve, është leximi. Edukimi klasik na shtyn të kërkojmë thelbet e kohëve dhe të epokave, për të kuptuar vijimësinë dhe logjikën e saj të natyrshme. Njeriu sot preferon kompiuterat, në të cilët me pak dyshim gjejnë të dhënat arkivore, jo vetëm të një shekulli, por të shumë shekujve. Në ekran lexohen qartë të vërtetat e regjistruara të an-

ketës vetjake të çdo njeriu. E shkruara është si të krijosh një gjeografi të re. Është fjala për një gjeografi prej guri, e jo për një gjeografi lëvizëse si ajo e reve. E shkruara, gjithmonë duhet të mbetet, t' i shpëtojë shpërbërjes. Perandoritë përmbysen, shumë popuj dhe gjuhë kanë vdekur? Qytetërimi Botëror, më së pari është Qytetërimi i Letrës së shkruar: Shpikja e tipografisë, shtypshkrimi kompjuterik etj., e bënë Perandorinë e Letrës perandorinë më universale, perandori pa emra të bujshëm perandorësh, perandori pa spektra dhe kurora diamantesh, pa mantele ceremonialë të purpurt, pa rituale fetare kurorëzimi, pa luftëra truallpushtuese, pa vrasje masive dhe pa hakmarrje shekullore. Krijuesi i kësaj perandorie, të paktën për qytetërimin europian është patriarku i verbër Homer, i cili vetë nuk dinte të shkruante. Por origjinat e shkrimit dritësojnë nga Lindja e Largët, madje nga legjenda e rebelit hyjnor Promete, që sekretin e shkrimit ua rrëmbeu hyjnive të Olimpikut për t'ua dhënë njerëzve, apo në ngjitjen në mal të profetit Moisi, të cilit Zoti i dha dy pllaka guri me dekalogun e ligjeve morale për njerëzit, të shkruara me gishtin inkandeshent të vetë Zotit. Shkrimit dhe librit gjithmonë i është atribuar një origjinë hyjnore dhe mitike. Në 1558, në një traktat anonim në Europë, thuhet se shpikja e shtypshkronjës u frymëzua nga vetë Zoti për të përhapur në letër mësimet e Krishtit. Sa do të rezistojë Perandoria e Letrës? Ajo që duket e palëkundshme dhe që e përbuz rrezikon, befus mund të paraqitet si e brishtë. Parashikues të guximshëm dhe kokëshkretë tashmë flasin për fillimin e epokës apo erës së qytetërimit pa letër. Është hedhur në diskutim dhe është stigmatizuar jo pa përbuzje dhe gëzim vulgar, prestigji i librit. Kur më 1885 u arrit shpikja industriale e gramafonit, pllakat me regjistrime u bënë elementi i parë jotradicional në bibliotekë pas librit. Gramafoni solli epërsinë e zërit, atë epërsi që dikur e kishin apostujt analfabetë. Magnetofoni dhe mjetet e tjera elektronike të regjistrimit i shtuan "shqisat" e bibliotekës. Ata krijuan një farë krize të librit, por megjithatë rreziku që më tepër iluziv. Kur nisi televizioni eksperimental, shumëkush profetizoi oponencën, madje dhe kritikizmin e papërmbajtur të tij ndaj qytetërimit të letrës. Disku, kasete, mikrofon, mikrofishat, filmi, videokasetat, sistemet audiovizive dhe sidomos interneti krijuan gjithashtu perandorinë e elektronikës, që deri diku po e sfidon perandorinë e letrës. Perandoria e elektronikës, synon qytetërimin pa letër, që do të thotë rrëzim i Perandorisë së Letrës. Shpesh përmendet pyetja tragjike:

"A do të perëndojë fjala e shtypur? "A kanë të ardhme bibliotekat"? A do të na duhen më librat?" Kjo futurologji e zyrtë, na shqetëson dhe na prek. Shumë entuziastë snobë dhe të egër, shpallin pa ngurrim se këtej e tutje nuk ka nevojë për bibliotekat me libra që zënë hapësira të mëdha si vëllim, por do të zëvendësohen nga CD gati në miniaturë, që përfshijnë në vetvete jo 1, por dhjetëra libra. Ndryshon kështu statusi i bibliotekave, interneti dhe sitet e ndryshme të informacionit kufizohen në hapësirë, duke e ngjeshur makrokozmosin dhe mikrokozmosin e elektronikës. Por, nëse perandoria elektronike do të humbasë qoftë vetëm për 1 sekondë, ushqimin e saj që është elektriciteti, atëherë çfarë mbetet prej saj? Konsiderohet si një tendencë postmoderniste përbuzja ndaj librave tradicionalë të shtypur, për të preferuar informacionin kompjuterik.



terik. Kjo do të thotë që ne edhe librin e Gjon Buzukut ta kemi të koncentruar në një CD (gjë që është plotësisht e mundshme të bëhet dhe duhet të bëhet), por kemi nevojë t'i shohim me sytë tanë dhe t'i prekim me gishtat tanë fletët dhe paraqitjen tipografike reale dhe monumentale të ksoblës së vetme që ka mbetur në botë. Çdo modernizim është i kufizuar, kufijtë hapen dhe mbyllen papushim, infiniti është kudo, sepse ka qenë përherë ky infinit. Por është marrëzi e pafalshme në fillimin e Mijëvjeçarit të Tretë, të mendojmë se nuk ka përse të na duhen më librat, as gërmadhat arkeologjike, as ikonat mesjetare, as strukturat skeletore të dinozaurëve, as vizatimet prehistorike të shpellave, as përkrenarja me kokë dhie e Gjergj Kastriot Skënderbeut, as dhe libri i vetëm i Gjon Buzukut. Kam lexuar disa libra për një hipotezë shkencore, hipotezë, që shumica e beson si të vërtetë, kurse disa skeptikë më të fuqishëm nuk e besojnë. Ekziston një informacion historik i kohës se shtypja e të parit libër, që ishte Bibla e Shenjtë prej 42 rreshtash në faqe, në tipografinë e Gutenbergut, është ndërprerë për shkak të një urgjence me karakter politik, për domosdoshmërinë e shtypjes së një pamfleti të vitit 1453, që i referohej pushtimit të Kostandinopojës në brigjet e Bosforit nga otomanët. Ndoshta është koha për të nënshkruar një pamflet për të shpëtuar qytetërimin e letrës, sepse ndihem mirë e i kënaqur në Perandorinë e Letrës. Nuk jemi kundër elektronikës dhe Internetit, por pse vallë duhet që të përjetojmë një ndeshje pa shpresë dhe fatale dinozaurësh midis: -Librit dhe Kompjuterit? A nuk janë edhe Libri dhe Kompjuteri, shprehje të dyfishta të gjenisë dhe intelektit të mrekullueshëm njerëzor?

Kompiuterat, mendja njerëzore i prodhoi përmes zhvillimit të librit, nëpër faqet e mijëra librave, të dhjetëra shekujve, u ngjiz ideja kompjuterike dhe kompjuteri vetë. Profecia e triumfit të qytetërimin pa letër në qytetërimin e letrës, është një profeci me shumë estradeske. Nuk mund të mos e marrësh parasysh, por pse duhet mbivlerësuar, a nuk do të ish kjo gjë një lloj mitizimi apo dhe estetizim i vetëvrasjes?!? Ashtu siç ushtarakët duhet edhe të shkruajnë, kuptohet, jo të gjithë, por ata që e kanë dëshirë. Të shkruarit ka të mirën e madhe sepse... "Qui scribit bis legis" - "Ai që shkruan, lexon dy herë". E leximi veç mirë na bën të gjithëve. Në një botë plot me libra, nuk dihet pse po i besojmë më shumë komunikimit virtual. Çdo kompjuter është një pafundësi referencash, është lëndë, por nuk është shpirt. Dikur matematikani austriak i Universitetit të Këningsbergut Kurt Godel, publikoi një teori tmerruese se vetë universi matematikor është i tillë, që është e pamundur të vërtetosh se brenda kësaj teorie nuk fshihen kundërtënie, sipas thënies se "Zoti ekziston se matematika është koherente dhe Djalli ekziston, se kjo nuk mund të vërtetohet." Ky rezultat u quajt teoria e paplotësisë së Godelit. Zoti për ne tokësorët vdekatarë është ai që prekim me dorë; pra Libri. Pa e flakur, por duke lexuar atë, le të shfletojmë edhe faqet elektronike në xhamin e ftohtë të kompjuterit, për ato që na duhen, për momentin. Esenca e lirisë është fryma, dhe esenca e frymës është liria. Frymë dhe marrëdhënie shpirtërore, emeton vetëm shfletimi i faqeve të një libri, marrëdhënia që krijohet përmes kontaktit të poreve të lëkurës së gishtave me letrën, ndërton atë marrëdhënie të shenjtë e të pavdekshme, marrëdhënien: LIBËR-NJËRI!!

DIXHITALIZIMI

Arkitektura e bibliotekës dixhitale

Teknologjia e aplikuar në zhvillimin e bibliotekave digjitale

ANITA PECANI

Bibliotekat dixhitale nuk lindën rastësisht, ato u krijuan si nevojë e grumbullimit, organizimit, shërbimit dhe ruajtjes së materialeve, apo informacionit, të krijuar apo konvertuar në formë digjitale. Nëse bibliotekat tradicionale, të cilat janë marrë dhe merren me materiale të njohura tashmë, si dorëshkrimet, librat, gazetatat, revistat, fotografitë që të gjitha në formë letre e më vonë edhe deri diku edhe elektronike, konsiderohen si arkiva të ruajtjes së kujtesës së një kombi për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, atëherë të njëjtin rol e marrin edhe bibliotekat digjitale në ruajtjen e materialeve të këtij lloji dhe të tjerave, tani në formë digjitale, për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Në fillimin e tyre, bibliotekat digjitale u krijuan mbi kushtin se kompjuteri jep mundësi të vënies në dispozicion të shumë përdoruesve në të njëjtën kohë po

që se materiali është i ruajtur në një formë apo tjetër në kompjuter. Në fillim ato kanë evoluar edhe si nevojë e përshkrimit, fotografimit apo skanimit të materialeve të vjetra dhe vendosjes së tyre në kompjuter, për t'i ruajtur nga prekja fizike nga përdoruesit, të cilët kanë pasur nevojë për atë material. Pra janë digjitalizuar!!! Më pas me zhvillimin e internetit, pasi bibliotekat e para digjitale u krijuan para ardhjes së internetit, ato materiale u bënë të mundshme të shfrytëzohen nga çdo kompjuterë që kishte lidhje interneti. Për më tepër nga arsyet e mëhershme dhe nevojat pse u krijuan bibliotekat e para digjitale, ato tani merren apo përpiqen të merren me çdo lloj materiale në formë digjitale qoftë të skanuar e konvertuar, qoftë të lindur në formë elektronike në kompjuter apo përmes ndonjë pajisje tjetër. Me zhvillimin e internetit, i cili transformoi edhe më tepër natyrën e dokumenteve të krijuara përmes kompjuterit apo pajisje tjera digjitale, edhe bibliotekat digjitale u zhvilluan, evoluuan e u njohën me emra të ndryshëm, si bibliotekat



virtuale, të cilat do të ekzistojnë vetëm virtualisht në internet, pastaj biblioteka elektronike, të cilat do të merreshin me materiale në formë elektronike, koleksione të revistave elektronike, etj. Biblioteka digjitale është e pajisur me të gjitha tiparet, vlerat dhe funksionet me të cilat i kemi identifikuar edhe vet bibliotekat tradicionale. Të njëjtat qëllime që bibliotekat tradicionale kanë synuar t'i arrijnë përmes funksioneve dhe shërbimeve të tyre duke grumbulluar me kritere materiale tradicionale apo konvencionale, po ato qëllime synon t'i arrijë edhe biblioteka digjitale duke grumbulluar po me kritere dokumente jokonvencionale apo digjitale. Natyra e dokumenteve digjitale është më komplekse. Tashmë kemi dhjetëra e dhjetëra formate e gjuhë programuese të ndryshme në të cilat prezantohen dokumentet digjitale. Sa për të përmendur disa, dokumente të tilla janë ato, si: Word, Excel, PDF, HTML, XML, XHTML, RDF, pastaj GIF, JPEG, TIFF, MPEG4, MP3, CD, DVD, e shumë të tjera. Nga kjo shihet se bibliotekat digjitale kanë të bëjnë tashmë me një natyrë dokumentesh krejtësisht të ndryshme nga natyra e dokumenteve konvencionale me të cilat jemi mësuar. Sa duken komplekse këto formate në të cilat ruhen informacionet, ato kanë një element universal të përbashkët - mënyrën se si kompjuteri e ruan dhe e kupton informacionin e këtyre dhe formateve të tjera. Bibliotekat dixhitale kanë përparuar mjaft në mënyrën e nxjerrjes së informacionit nga dokumentet dixhitale të shkruara në formë teksti. Ata i indeksojnë fjalët të veçuara, kuptojnë renditjen e fjalëve në fjali duke vënë rregulla algoritmike, pastaj i kuptojnë edhe prapashtesat e parashtesat. Kjo çështje ka bërë që bibliotekat digjitale të krijojnë metadata për të ndihmuar procesin të gjetjes së informacionit nga hapësira ruajtëse e kompjuterit. Metadata, që në veprimtarinë bibliotekare si, MARC, RDF, Dublin Core, etj., së bashku me taksonomi e forma të informacioneve, pasi krijohen nga njeriu duke i dhënë sinjal kompjuterit se cilat informacione duhet të indeksohen patjetër. Megjithatë, kjo, në shumë raste, kërkon më shumë njohuri nga përdoruesi për sistemin të cilin e kërkon, e nganjëherë edhe durim.

Teknologjia e aplikuar në zhvillimin e bibliotekave digjitale

Në krijimin dhe zhvillimin e bibliotekave digjitale bën pjesë një numër i gjerë komponentësh teknologjike, prej harduerit e deri te softuerët e ndryshëm komercial e jokomercial. Programet kompjuterike falas (që në anglisht quhen Open Source Software), janë në dispozicion për instalim të secilit individ apo institucion, i cili dëshiron të shfrytëzojë atë teknologji. Ato janë të hapura për ndryshime, modifikime, konfigurime të mëtejshme, si dhe në rastet më të shumta ekziston një bashkësi e cila e përdor, diskuton apo është e interesuar në një program të caktuar. Lista e gjerë e programeve të ndryshme falas në internet, duke përfshirë nga programet për biblioteka digjitale, programe vetëm për katalogim e deri të programe të plota për sisteme të automatizuara bibliotekare. Më poshtë kemi paraqitur disa prej programeve të cilat janë mjaft të popullarizuara dhe në përdorim të gjerë nga bashkësia e bibliotekave digjitale:

Greenstone: Ofron një mjet të fuqishëm në organizimin, menaxhimin dhe gjetjen e informacioneve në biblioteka digjitale. Greenstone zë hapësirë të vogël instaluese në kompjuter, instalohet në të gjitha versionet e Windows, Unix/Linux, dhe Mac OS-X. Karakteristikë tjetër është se mbështet pamje shumë-gjuhësore të programit, pastaj mbështet të gjitha formatet e metadatave, si dhe ofron fleksibilitet të modifikimit e konfigurimit të mëtejshëm. Kjo tregon natyrën fleksibile të programit Greenstone për modifikim, si dhe mundësinë për të renditur koleksionet e digjitalizuara në mënyra të ndryshme – sipas nevojës, të cilat i parasheh biblioteka. Greenstone ka natyrë fleksibel për modifikim, si dhe mundësinë për të renditur koleksionet e digjitalizuara në mënyra të ndryshme – sipas nevojës, të cilat i parasheh biblioteka.

Dspace: është një program tjetër falas në internet dhe mjaft i përhapur nëpër institucione të ndryshme për ruajtjen e koleksioneve digjitale. Mund të instalohet në UNIX ose Linux. Një karakteristikë e Dspace është se bënë ruajtjen e koleksioneve digjitale në dy nivele - në nivelin me bit dhe në nivelin funksional. Ruajtja në nivelin bit mundëson që dokumenti të ruhet në formën origjinale të tij pa pësuar kurrfarë ndryshimi, ndërsa ruajtja në nivel funksional karakterizohet me ndryshimin e file-t me evoluimin e formateve duke bërë të mundur përdorimin e dokumentit në kohë të ndryshme. DSpace mbështet metadatat në Dublin Core, ndërsa janë duke u bërë përpjekje edhe për aplikimin e skemave të tjera të metadatave.

Fedora: Një program tjetër falas, platforma e së cilës mbështetet në katër shërbime: shërbimit të depozituarës, shërbimit të ruajtjes, shërbimit semantik, dhe shërbimit evolues. Ajo ofron veçori nga më të ndryshmet si konvertimi i formateve, integrim me makinat kërkuese, pastaj kontroll në qasje, versione të ndryshme të gjeneruara nga përmbajtja, pamje dinamike të objekteve digjitale, etj., që të gjitha të përfshira në shërbimin e depozituarës së Fedora-s. Ajo ofron mundësi të ruajtjes së dokumenteve të ndryshme digjitale, e në të njëjtën kohë shfaq përmes ekranit apo versione të ndryshme të atij dokumenti. Fedora, po ashtu, integron në vete teknologjinë e internetit semantik për të përshkruar e ndërlidhur dokumentet digjitale në botën e internetit. Ofron mundësi të ndryshme të konfigurimit, modifikimit dhe evoluimit për të qenë vazhdimisht program i kohës. Bibliotekat digjitale u zhvilluan si rezultat i evoluimit të

formateve në të cilat prezantohet tradita, kultura, historia, trashëgimia intelektuale, kreativiteti i njerëzimit. Ato, me një fjalë, vazhdojnë traditën e bibliotekave tradicionale të cilat merreshin me mbledhjen, organizimin, shërbimin dhe ruajtjen e materialeve të prekshme, por tash të një mediami të ri. Nga vet përkufizimi i tyre, bibliotekat digjitale mund të thuhet që kanë po të njëjtin vizion, mision e aspirata që kishin e vazhdojnë të kenë bibliotekat tradicionale, përveç tjerash, ruajtjes së dokumenteve dixhitale për brezat e ardhshëm – ruajtjen e kujtesës së një qytetërimi. Më herët pamë se natyra e dokumenteve digjitale është mjaftë e ndryshme, kemi formate të ndryshme për prezantimin e tyre, formate për tekste, për fotografi, për zëra, etj., por se ato ruhen në kompjuter në bit dhe kuptohen nga kompjuteri duke kryer funksione matematikore. Kjo ka bërë edhe zhvillimin e hovshëm të programeve të ndryshme për të bërë të mundur gjetjen sa më të lehtë të informacioneve. Një zhvillim i suksesshëm është arritur në të kuptuarit dhe manipulimin e dokumenteve digjitale në formë teksti nga kompjuterit. Si çdo bibliotekë tradicionale, edhe biblioteka digjitale mbështetet në burimet njerëzore. Kryesisht, dallohen dy kategori të personelit, ai teknik dhe ai profesional. Personeli profesional bën rregulloret e pasurimit me koleksione, cilësisë së tyre, ofrimin e shërbimeve të ndryshme, lidhë bashkëpunime të ndryshme, etj. Ndërsa, personeli teknik merret me administrimin teknologjik të bibliotekës digjitale dhe zbatimin e të gjitha rregulloreve të bëra nga personeli profesional. Ndonëse mund të thuhet se një bibliotekë digjitale është si një lloj vetëshërbimi, pasi përdoruesi ka mundësi të kërkojë, gjejë, shkarkojë, ruajë e dërgojë dikujt tjetër burime digjitale, personalizojë shërbime, manipulojë me informacionin, shton metadata, anoton, ndërton bibliografi personale, etj., prapë se prapë ekziston një mori punësh e veprimtarish që i mbështesin këto vetë-shërbime, e për të cilat kujdeset personeli profesional dhe teknik. Menaxhimi është një aspekt tejet i rëndësishëm që do shqyrtuar që në fillimet e planifikimit të ndërtimit të një bibliotekë digjitale. Ndonëse jo gjithçka mund të qartësohet që në fillim, duhet të përvijohet vija të qarta të qeverisjes së bibliotekës dixhitale. Në këtë kuadër hyn struktura e menaxhimit dhe vija e raportimit, rolet e bibliotekarëve, rolet e personelit tjetër administrativ. Koleksionet paraqesin bërthamën e bibliotekës digjitale. Pa ta nuk do të kishte kuptim asnjë prej përpjekjeve, shërbimeve, teknologjive moderne të zbatuara dhe as personeli i përfshirë. Meqë rëndësia e tyre është thelbësore, edhe kujdesi për to duhet të jetë thelbësor. Sipas mendimit tim, një bibliotekë digjitale e bënë të pasur disa veçori të koleksioneve të saj, si:

Cilësia, që zakonisht monitorohet përmes një programi të mirëfilltë të zhvillimit të koleksioneve dhe menaxhimit të tyre, përfshirë kriteret e përzgjedhjes sipas misionit të bibliotekës dhe nevojave të përdoruesve që përfshijnë mbulimin e fushave të ndryshme të dijes;

Sasia, që po ashtu tregon se sa e përkushtuar është një bibliotekë për t’ju ofruar përdoruesve të saj informacione;

Organizimi, që kanë të bëjnë me pasurimin me metadata, të qenit ndëroperacional me të gjitha protokollet dhe standardet ndërkombëtare të bibliotekave dhe teknologjive të informacionit, mundësia e kërkimit dhe

qasjes, mundësia e organizimit logjik, tematik, kronologjik, në bazë të formateve, etj., nga vet përdoruesi;

Formatet dhe llojet, që kanë të bëjnë me llojshmërinë e dokumenteve, si: .pdf, .jpg, video, audio, tekst, fotografi, etj., që u përshtaten nevojave të përdoruesve, përfshirë edhe të atyre me nevoja të veçanta;

Ruajtja afatgjate, që përfshin vetë dokumentin dhe lidhjet e tij;

Shërbimet, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me dokumentet, si ruajtja, dërgimi me postë elektronike, përkthimin në gjuhë të ndryshme, dhe manipulimet e tjera në përgjithësi.

Ruajtja dhe Konservimi paraqet një botë mbase më të ndërlikuar të ruajtjes, konservimit dhe shërimit të dokumenteve digjitale në krahasim me dokumentet tradicionale në letër.

Vështirësitë paraqiten në ruajtjen e dokumentit dhe formës së tij të përgjithshme, formatit të tij, vargut të informacionit (bitëve dhe bajtëve), apo edhe të teknologjisë së përfshirë në leximin, përpunimin, manipulimin dhe shfaqjen e atij dokumenti. Pra, kemi nivele të ndryshme të ruajtjes së informacionit që shpeshherë kërkon përkthimin, konvertimin dhe shndërrimin nga një format në tjetrin. Në të shumtën e rasteve, kjo nënkupton ruajtjen e informacionit, por jo edhe të paraqitjes dhe dukjes në formë të dokumentit origjinal. Në bibliotekat digjitale bëhen përpjekje të ruhet gjithnjë një kopje kryesore (origjinale) e dokumentit në një format të caktuar, që zakonisht është në TIFF, dhe kopje të tjera në formate të ndryshme, të cilat mund të manipulohen për t’ju përshtatur nevojave të ndryshme të përdoruesve.

QLMI-ja arriti dixhitalizimin e Librave: “Rregullorja e Lejeve” prodhim i vitit 1921 dhe “Muzeu Ushtarak Kombëtar” prodhim i vitit 2008, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve jo moderne. Librat u skanuan me një skaner të zakonshëm duke ruajtur renditjen e çdo faqeje dhe të depozituara në kompjuter. Pas përfundimit të skanimit të gjitha fletët e librit të paraqitura tashmë në format JPEG u përpunuan për ngritjen e cilësisë nëpërmjet programit Photoshop dhe në format TIFF. Faqosen në programin Indesign cs6 dhe materiali konvertohet në formatin PDF. Programi Eflip Standard nëpërmjet materialit në PDF mundëson shfletimin elektronik të librit kërkimin në faqet e tij, ka opsionet zmadhim dhe zvogëlim të faqes, dërgimin me e-mail, si dhe të mundëson leximin e tij virtual në çdo kompjuter që është i lidhur me internet.



“Himni Kombëtar”, tashmë edhe në faqet e një studimi...

Akademiku Vasil S. Tole, drejtor i QKMBM-së, boton librin studimor “Himni Kombëtar”

Të martën më 26 nëntor, në sallën “Aleks Buda” në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, u zhvillua promovimi i librit studimor “Himni Kombëtar”, i akademikut Vasil S. Tole, drejtor i QKMBM në Ministrinë e Mbrojtjes. Të pranishëm ishin akademikë të nderuar, kompozitorë, deputetë etj. Kryetari i Akademisë së Shkencave, z. Muzafer Korkuti, muzikologja Zana Shuteriqi, akademikët Jorgo Bulo e Gjovalin Shkurtaj por dhe ambasadori i Rumanisë vlerësuan librin për pasurinë e tij dokumentare, për faktet që sjell, analizën e hollësishme etj. Kryetari i Akademisë së Shkencave, z. Muzafer Korkuti, u shpreh në lidhje me botimin se: - “Kjo është një ditë e shënuar e flamurit, 26 nëntori, dita e ngritjes së flamurit në Tiranë e më pas në Shqipëri. Veprimtaria e profesor Toles përfshin të gjitha gjinitë, format e jetës lirike vokale, muzikën dhe letërsinë të botuara në vitin 1997, muzikën me saze në Shqipërisë e Jugut në vitin 1998, folklorin muzikor, polifoninë shqiptare në vitin 1999, enciklopedinë e muzikës popullore shqiptare në vitin 2001, Himnin Kombëtar Shqiptar në vitin 2003, varianti i parë”. Më tej z.Kërkuti shtoi se: - “Sot, jemi mbledhur për veprën e përmbledhur, të plotë të “Himnit Kombëtar”. Do të doja të veçoja kontributin në rang kombëtar të akademikut Vasil Tole në punën që bëri për përgatitjen dhe përfshirjen në trashëgiminë botërore, kryeveprën e trashëgimisë gojore, isopolifoninë. Nëse himni është simbol për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen, isopolifonia që u fut në trashëgiminë botërore besoj se është një himn për të huajt për ta njohur Shqipërinë dhe këtu është kontributi i shquar i Vaso Toles”. Më pas, fjalën e mori ambasadori i Rumanisë, z. Viorel Stanila, i cili pasi falënderoi të pranishmit, tha se: - “Himni kombëtar shqiptar është frymëzuar nga një kompozitor rumun dhe është prodhuar në kontekstin e mërgimit shqiptar në Rumani dhe nuk besoj se kjo ka ndodhur rastësisht, sepse për ne është më shumë një shprehje e lidhjes shpirtërore midis dy kombeve, sepse muzika është një



shprehje e prodhimeve më të thella të shpirtit njerëzor dhe është art më i vlefshëm për marrëdhëniet dypalëshe sesa deklaratat politike apo ngjarje e evenimente të tjera në marrëdhëniet midis dy popujve”. Më pas, në promovim, profesori e akademiku Jorgo Bulo theksoi se: - “Himni i Asdrenit fitoi statusin e Himnit Kombëtar duke përfunduar në ceremonitë e shtetit shqiptar e më pas për t’u bërë pjesë e ceremonive zyrtare në shtetin e monarkisë. Në vitet e pushtimit fashist, rinia antifashiste e këndoi rreth zjarreve partizane dhe në koncertet e koreve të formacioneve muzikore të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, në koncertin e parë të korit të ushtrisë, në ceremonitë e krijimit të brigadave partizane e kështu me radhë. Pas kësaj, himni u përfshi me ligj në protokollin e shtetit dhe së fundi në kushtetutën e vendit, 15 vjet më parë. Me gjithë këtë histori ndryshimesh, himni i flamurit rezistoi të paktën në 7 konkurse. Libri i Vaso Toles veçon faktin se betimi mbi flamur i Asdrenit lindi së pari si himni i kombit për t’u bërë himni i shtetit dhe kënga më e kënduar, më e përhapur, më emocionuese dhe e gjithë-pranuar. Ai i mbijetoi kohës sepse në radhë të parë shprehu shpirtin e të gjithë kombit, u bë pjesë e vetëdijes dhe simbol i identitetit kombëtar.” - tha në fjalën e tij akademik Bulo.

Alba Musaraj

Një rrugë për tu ndjekur, nga SHBA-ja dhe Rusia

NGA DMITRY RYURIKOV*

Kur u takua me presidentin rus, Vladimir Putin në muajin tetor, Henry Kissinger përmendi me humorin e tij karakteristik, që pas udhëtimit në Rusi ai sjell këndvështrimin rus tek udhëheqja amerikane, por që në Shtetet e Bashkuara ky informacionin i tillë jo gjithmonë e ndihmon atë. Kjo është për të ardhur keq. Për Kissingerin ka shumë për t'ju ofruar amerikanëve kur vjen puna tek Rusia. Në Akademinë Diplomatike të Ministrisë së Jashtme ruse, ku Dr. Kissingerit iu dha një doktoratë nderi, mjeshtri i diplomacisë dha një leksion me temën e tij të preferuar: Rendi Botëror. Duke i dhënë tribute sistemit uestfalian si bazë e marrëdhënieve ndërkombëtare, ai theksoi nevojën për të ruajtur parimet e tij në kontekstin e tanishëm që ishte praktikisht një thirrje për sovranitetin dhe barazinë sovraane të shteteve kombëtare në shekullin XXI. Heshtja që mbretëroi në auditorin e Akademisë për të dëgjuar këtë nga një amerikan, ishte një gjë e pazakontë. Ai shkoi më tej, duke i referuar marrëdhënieve të ngushta organike të sotme globale në të gjithë botën dhe në të gjitha

sferat e jetës, ai sugjeroi që çdo shtet duhet të ruajë karakterin e tij kombëtar, të kujtojë historinë e tij. Natyrisht, e gjithë kjo duhet të jetë në aspektin konstruktiv, duke marrë parasysh balancën e interesave dhe kulturave të vendeve të tjera, por edhe kjo nuk ishte e gjitha, duke prononcuar në fillim të ligjëratës fjalën "e jashtëzakonshme", Kissinger buzëqeshi dhe në fund të ligjëratës tha se Shtetet e Bashkuara, Rusia dhe Kina nuk duhet të paraqesin rrezik për njëri-tjetrin, me ardhjen e epokës së re dhe sfidave të reja, ato duhet të rivlerësojnë aftësitë e tyre dhe rolin global si dhe të punojnë së bashku për qëllimet e tyre të përbashkëta. Merrni këtë: Bota nuk është as unipolare, as multipolare me trekëndëshin SHBA-Rusi-Kinë i përshtatur në kohët e sotme në një botë neo-uestfaliane. Pavarësisht popullaritetit të termave të tilla si globalizimi apo komuniteti ndërkombëtar, mbetet fakt i hapur se vlerësimi i ngjarjeve apo fenomeneve nga fuqitë e mëdha botërore shpesh është seriozisht në konflikt me njëri-tjetrin dhe respektivisht qasjet e tyre ndaj politikës. Anët pozitive janë të dukshme: Zhvillimi i vazhdueshëm i njohurive, teknologjive dhe i tregtisë botërore, lidhjet në rritje të gjithanshme midis shteteve dhe popujve, përhapja e gjerë





e informacionit të besueshëm, influenca e zgjeruar e refuzimit të forcës në vendimet politike në zgjidhjet e konflikteve dhe shumë më tepër. Megjithatë, kërcënimet ekzistenciale të njerëzimit janë bërë globale dhe çështja nuk është vetëm tek kërcënimet ushtarake, luftërat dhe armatimet. Mbështetësit militantë të "botës së re", tek të cilët zoti Kissinger, duke gjykuar nga fjalimet dhe artikujt e tij, nuk bën pjesë, besojnë se shteti i së drejtës dhe ndërgjegjja ligjore, e formuar në të kaluarën, duhet të eliminohen dhe se lufta, ndryshimi i regjimit dhe konfliktet e krijuara janë mjete normale për të arritur qëllimet gjeopolitike. Në fushën e "fuqisë së butë", domethënë aranzhimet për jetën në familje të popujve, lufta e filozofëve dhe praktikave është e pagjashme, por jo më pak radikale. Ofensiva kundër fondacioneve jo-materiale, parimeve dhe normave të qytetërimit ekzistues është duke u kryer, matrica e ndërgjegjes dhe nocionet rreth të drejtës dhe së gabuarës po ndryshojnë, bazat ende ekzistuese të familjes, jetës private, shoqërore dhe politike të njerëzve janë duke u anuluar. Normat e sjelljes që dje konsideroheshin të zmadhuara ose edhe kriminale, sot po inkurajohen. Natyra, fushëveprimi dhe qëndrueshmëria sistematike nga risitë sugjerojnë se një projekt global kundër qytetërimit është në rrugë e sipër.

Po në lidhje me ekonominë? Këtu, pamjaftueshmëria e financave globale dhe ekonomisë shton deri në kategorinë e negatives, paradigma e pronës dhe pasurisë mbetet dominuese në sferë, por askush nuk do ta ndryshojë atë. Krizat në ekonomi klasikisht të çojnë drejt tundimeve në politikën botërore. Tendencat drejt konflikteve, ku më shumë e ku më pak, është e pranishme pothuajse në të gjitha rajonet e botës përveç, ndoshta Europës, Amerikës së Veriut dhe në përgjithësi CIS. Për një numër shtetesh, duke përfshirë edhe Rusinë, rreziku i paqëndrueshmërisë në Lindjen e Mesme, lufta në Siri dhe tensionet rreth Iranit do të përbëhen nga kërcënime të reja të sigurisë, me tërheqjen e trupave amerikane nga Afganistani në vitin 2014, trafikun e

heroinës afgane në Rusi që ende pritet të rritet si dhe fluksit të luftëtarëve të xhihadit e kalifatit, të cilët kanë marrë një trajnim të ashpër në Siri, Afganistan, Azinë Qendrore dhe Rusi. Pyetje specifike lindin: Kujt ia ka borxh bota të gjithë këtë? Pse rendi i ri botëror po ndërtohet nga luftëtarët e rinj të Al Kaedës? Vizioni amerikan i situatës dhe perspektivave aktuale në botë është krejtësisht i ndryshëm nga ai rus. Ndryshe nga rusët, amerikanët besojnë se të gjitha ngjarjet dhe zhvillimet janë ndryshime pozitive, luftë për një botë më të mirë dhe, Amerika është në rrugën e duhur. Siç shkroi Thomas Graham në "Izvestia", udhëheqja është pjesë e ADN-së kombëtare të amerikanëve. Megjithatë, ai pranoi se në dekadën e fundit ka pasur gabime në politikën e jashtme të Shteteve të Bashkuara. Në lidhje me gjenetikën politike ruse duket se për shkak të pasojave katastrofike të revolucioneve dhe grushteve të shtetit në shekullin XXI një refuzim ose të paktën një qëndrim shumë i kujdesshëm me konceptet e "qarkullimit", "revolucionit", "rendit të ri" dhe kështu me radhë, u bë pjesë e ADN-së kombëtare ruse. Në të vërtetë, rusët dinë shumë mirë vetëm se çfarë mund të ndodhë nën maskën e parullave "liri", "të drejta të njeriut", "revolucion", "botë e re", "një e ardhme më e mirë". Përvoja historike e Rusisë e ndihmon atë sot për të dalluar interesat reale të aktorëve të tjerë ndërkombëtarë. Mprehtësia e saj qëndron në faktin se ajo nuk nxiton të mbështesë ndryshimin radikal në çdo sferë, nëse ky është një ndryshim i një regjimi i cili papritmas rezulton fajtor për diçka, apo për të flakur traditat kulturore ose normat e sjelljes. Qasja e Rusisë, ligji dhe realizmi, u arrit përmes shumë vuajtjeve dhe testeve të vështira. Rendi botëror ekzistues dhe e drejta ndërkombëtare nuk janë të përsosura, por ato janë të nevojshme për të mbrojtur dhe promovuar interesat legjitime të shteteve. Dallimet ndërmjet qasjeve ruse dhe amerikane janë mjaft të dukshme në rastin e Sirisë. Është thelbësore për Rusinë që të dijë se mbi çfarë bazash do të zbatohet zgjidhja në Siri. Rusia as e idealizon dhe

as e demonizon qeverinë e Bashar al-Assadit. Moska i bën thirrje aktorëve të huaj që të mos ndërhyjnë në punët e brendshme të Sirisë dhe t'i japin sirianëve mundësinë për t'i zgjidhur vetë problemet e tyre. Administrata e presidentit Obama, nga ana tjetër, mori rolin e arbitrit për të identifikuar faktorin, vizatoi një "linjë të kuqe" dhe ishte gati të përdorte forcën pavarësisht nga normat e të drejtës dhe pozitive së shteteve të tjera. Sot, megjithatë, gjëra të tilla nuk janë aq të lehta për t'u miratuar siç ishte rasti i dikurshëm. Presidentit Obama i duhet dhënë një shkak, ai mori vendimin e vështirë për të braktisur sulmet në Siri dhe mbështeti qasjen ligjore që lejon për të krijuar një tablo të saktë të incidentit të armëve kimike dhe vetëm pas kësaj çështjeje dha verdiktin. A do të qëndrojë administrata e tij në përputhje me këtë apo do të ketë kthesa të reja në politikën e saj? Është e vështirë të jesh optimist. Opozita siriane mbështeti një "grusht shteti të personelit", të moderuarit u lanë mënjanë, veprimet politike dhe ushtarake u drejtuan nga trashëgimtarët xhihadistë të Al -Kaedës, Shtetet e Bashkuara dhe "fuqitë e reja të mëdha", Katarit dhe Arabisë Saudite, vazhduan t'u ofrojnë para dhe armë luftëtarëve. Dy duzinat e disa detashmenteve luftarake, kryesisht mercenarë, të cilët Shtetet e Bashkuara i konsiderojnë si opozitë dhe i mbështesin drejtpërdrejt dhe përmes partnerëve rajonalë, refuzuan të merrnin pjesë në bisedimet e zgjidhjes. Çfarë po ndodh në Siri, një luftë asgjësimi në shkallë të gjerë, një ndarje brenda alawitëve, selefitëve dhe zonave kurde, apo ende mund të ketë një rrugëdalje? Nëse marrëveshja ruso-amerikane për armët kimike në Siri do të krijojë një precedent për zgjidhje të tjera, kjo varet kryesisht nga Uashingtoni. Do të ishte për të ardhur keq në qoftë se kjo mundësi strategjike do të humbasë për shkak të presioneve nga lobistët pro-izraelitë dhe sauditë.

Gjasat për paqen botërore në pyetjet iraniane dhe afgane nuk janë më të vogla se gjasat siriane. Në disa parametra, situata iraniane të kujton atë siriane. Në Amerikë dhe Izrael, demonizimi i vendit, regjimit dhe udhëheqësve të tij vazhdojnë, ashtu si dhe deklaratat në lidhje me mundësinë për të ndërhyrë ushtarakisht, për të ndryshuar regjimin, për të rritur sanksionet. Sauditët janë aktivë në çështjen e Iranit: Për ata Irani

shiit është një rival gjeopolitik dhe ideologjik (teokracia suuni kundër teokracisë shiite). Vitet e fundit, Barack Obama ka qenë në gjendje t'i shmangët këshillave imponuese dhe presionit për të nisur sulmet me raketat mbi Iranin, por a është zhdukur kërcënimi i luftës me fillimin e shkëmbimeve amerikano-iraniane në nivel të lartë dhe në nivele të tjera? Si do të silllet administrata amerikane në qoftë se dikush nga "jashtë" organizon një sulm të madh terrorist "nën flamurin e Iranit" apo një sulm ndaj objektivit të Shteteve të Bashkuara ose të Izraelit në mënyrë që ta vendosin Obamën në një situatë të dëshpëruar? Situata në Afganistan është një çështje jetike për Rusinë. Në vitin 2013, RISS ka bërë thirrje në mënyrë të përsëritur lidhur me këtë temë, mbajti një Konferencë Ndërkombëtare për Afganistanin "2014", e cila u ndoq, ndër të tjera, nga një anëtar i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara. Ka pasur kontakte të tjera me amerikanët. Sjellja e SHBA-së në çështjen e Afganistanit ka shumë paqartësi. E vetmja fushë në të cilën pushtimi trembëdhjetë-vjeçar i Afganistanit ka prodhuar një arritje të madhe ishte narko-ekonomia, prodhimi dhe eksporti i heroinës është rritur dhjetëra herë. Tabloja e situatës në Afganistan, pas tërheqjes së trupave të huaja, nuk shkakton asnjë lloj optimizmi, formimi i një sistemi të ri të pushtetit ka të ngjarë të jetë i mbushur me konflikte. CSTO është duke u përgatitur për rastin më të keq, por edhe në qoftë se qeveria e Kabulit, "talibanët e rinj" dhe komanda e trupave amerikane të mbetura bien dakord për ndarjen e interesave dhe të ndërveprimit dhe bashkëpunimit, narko-ekonomia ka të ngjarë të mbetet e paprekur. Rusia nuk është e kënaqur me këtë, Afganistani i ri mund të bëhet edhe më i rrezikshëm se ai aktual. Droga afgane në Rusi ka vrarë tashmë dhjetëra mijëra njerëz. Asnjë lloj kuptimi me SHBA-në lidhur me çështjen afgane nuk duket në horizont. A është ky një partneritet? Ka një ndjesi se objektivat e deklaruara së Shteteve të Bashkuara në Afganistan janë në kundërshtim me politikën reale, e cila ndjek një plan tjetër. Çfarë lloj plani? Rusia dhe Amerika kanë gjëra për të diskutuar, veç e veç dhe së bashku: Parimin e partneritetit dhe përmbajtjen e tij konkrete, çështjet rajonale, sistemin e mbrojtjes raketore amerikane, hapësirën, teknologjitë e reja, lidhësin dhe veçantinë e Amerikë, ringjalljen e Rusisë dhe integrimin euro-aziatik. Në këtë drejtim, ideja e Obamës për të marrë kohë lidhur me reflektimin mbi të ardhmen e marrëdhënieve me Rusinë mund të konsiderohet si një plus. Me gjithë mprehtësinë e problemeve në Amerikë dhe qëndrimin e botës ndaj tyre, një rishikim i strategjisë amerikane duket i pashmangshëm, dominimi dhe përjashtueshmëria në klasën politike amerikane janë ende të forta. Kjo është për të ardhur keq. Është krejt e mundur që përgjigjja ndaj problemeve nuk duhet të bazohet më në një analizë vetë-kritike dhe reflektim, por në rezistencë tradicionale. E ardhmja do të tregojë nëse ideja e trekëndëshit SHBA-Rusi-Kinë, si një bazë për rendin botëror, do të jetë e dobishme në vitet e ardhshme.

**Dmitry Ryurikov është ish-ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë dhe konsulent i kreut të Institutit të Studimeve Strategjike ruse.*

Përgatiti: Alba Musaraj



Kontrolli demokratik i institucioneve të sigurisë dhe bashkëpunimi civilo-ushtarak

Nga: Nënkolonel Arian Osmani

Qëllimi i këtij shkrimi është që të kontribuojë sado pak në përfaqesjen sa më të mirë dhe bashkëkohore të konceptit të demokracisë në marrëdhëniet ndërmjet drejtuesve të zgjedhur dhe institucioneve të sigurisë. Në shtetet demokratike siguria realizohet nëpërmjet tre instrumenteve kryesore që janë forcat e armatosura, policia dhe shërbimet e inteligjencës.

Në fushën studimore dhe atë akademike gjendet literaturë e shumtë dhe raste studimore mbi rolin e forcave të armatosura në tranzicionet demokratike, për faktin se tranzicionet më të shpeshta kanë ndodhur në vendet post-militariste apo regjimet diktatoriale. Por edhe në vendet e Evropës Perëndimore me sisteme demokratike të konsoliduara, gjithnjë e më tepër po i jepet hapësirë sfidave të institucioneve të sigurisë kombëtare në ambientin e ri të sigurisë globale. Edhe pse çështjet e kontrollit demokratik mbi forcat e armatosura, agjensitë e ushtrimit të ligjit dhe rregullit, shërbimet e inteligjencës në këto vende trajtohet publikisht, pak informacion mund të të serviret mbi efektivitetin apo eficensën e tyre. Për më tepër ka të ngjarë që një vëmendje e vogël adresohet në atë çfarë bëjnë këto struktura, përtej mbrojtjes kombëtare. Konstatimi bëhet më interesant po të marrim në konsideratë se tashmë forcat e armatosura dhe institucionet e tjera të sigurisë përgatiten, trajnohen dhe pajisen për të realizuar detyra të një natyre krejt të ndryshme, krahasuar me misionet apo natyrën e konflikteve të mirëfillta ushtarake të së shkuarës.

Studiuesit e kësaj fushe më së shumti kanë trajtuar rolin e forcave të sigurisë në konfliktet e armatosura, duke qartësuar dinamikën e angazhimit të civilëve dhe ushtarakëve, por vetëm në kontekstin e mbrojtjes së vendit. Shkollat perëndimore kanë dhënë dhe vijojnë të japin një kontribut tepër të çmuar për të kuptuar më lehtë dinamikën e ndërveprimit ndërmjet civilëve dhe ushtarakëve, por vetëm në kontekstin e mbrojtjes. Por sot përballëmi me një tjetër panoramë të rolit dhe angazhimit të forcave të armatosura, gjithnjë e më larg rolit tradicional të luftës frontale dhe të mbrojtjes ter-



ritoriale. Marrëdhëniet civile-ushtarake trajtojnë komunikimin e ndërsjellë ndërmjet forcave të armatosura dhe autoriteteve civile në një shoqëri të caktuar. Një nga supozimet tashmë të pranuar gjerësisht në vendet perëndimore është se nëse shtetet drejtohen më së miri nga politikanë profesionistë, atëherë forcat e armatosura janë neutrale politikisht, duke ofruar një shembull të mirë të kontrollit civil në opinionin e gjerë publik. Por sidoqoftë duhet pranuar se këto norma nuk janë të pranuar në mënyrë universal. Shumë shtete që karakterizohen nga mungesa e institucioneve demokratike kanë shfaqur mosbesim, mungesë respekti dhe komunikim të varfër ndërmjet drejtuesve të zgjedhur politikë dhe forcave të armatosura.

Problemet dhe tensione e shfaqura në komunikimin e elitave politike dhe atyre ushtarake shfaqen edhe në vendet e europës perëndimore, për arsye se drejtuesit civilë mund të kenë njohuri jo të mjaftueshme në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare. Po të vërejmë në mënyrë objektive ngritjen e kapaciteteve të nevojshme të sektorit të sigurisë, i cili shkon shumë më larg se aksioma e njohur "stërvit dhe pajis", atëherë do të na duhet të rivlerësojmë edhe njëherë në mënyrë objektive marrëdhëniet ndërmjet forcave të armatosura, qeverisë dhe shoqërisë civile. Përpos të tjerash, një forcë e armatosur e pavarur politikisht dhe profesionalisht e arrirë, duhet të zhvillojë plane afatgjata sigurie



dhe stabiliteti. Sidoqoftë, depolitizimi i forcave të armatosura kërkon ndryshime esenciale ligjore, edukative dhe strukturore, trinom i cili në shumë vende kërkon kohë relativisht të gjatë për t'u implementuar plotësisht. Ushtarakët duhet të pranojnë dhe të provojnë përpara shoqërisë nevojën për paanësi dhe profesionalizëm, ndërsa drejtuesit politikë në anën tjetër duhet të sigurojnë mekanizma efektivë dhe eficientë të kontrollit politik dhe financiar mbi forcat e armatosura. Reforma e sektorit të sigurisë në vendet perëndimore u zhvillua si një reaktion organik ndaj shtrëngesave të marrëdhënieve të komunikimit civilo-ushtarak. Ky proces tashmë ka rezultuar pozitiv dhe me rezultate konkrete në shumë vende apo organizata ndërkombëtare, të cilat kanë në fokus çështjet e sigurisë. Mbështetësit e reformës në sektorin e sigurisë proklamojnë një përjasje më të gjerë dhe më përfshirëse të "komunitetit të sigurisë" në proceset demokratike dhe në marrëdhëniet civilo-ushtarake. Në këtë mënyrë ata shpresojnë që të inspirojnë një kuptim më të plotë të sfidave me të cilat përballlet ambienti i sigurisë, për arsye se çështjet e zhvillimit dhe të sigurisë njerëzore janë të ndërvarura nga parandalimi i kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme, qofshin këto me natyrë ushtarake apo jo ushtarake. Spektri i gjerë i këtyre sfidave shkon nga konfliktet tradicionale, kërcënimet asimetrike, luftën kundër terrorizmit dhe jo më pak të mundshme katastrofat ambientaliste apo emergjencat natyrore, për të cilat nuk mund të përgjigjen vetëm forcat e armatosura. Pra garantimi i sigurisë për qytetarët kërkon një angazhim të ngushtë të të gjithë institucioneve civile dhe ushtarake, të cilët krijojnë bashkërisht sektorin e sigurisë. Duke u përpjekur të sjellim një përjasje sa më të qartë në atë se çfarë nënkupton sektori i sigurisë, mendoj se është me vend të përdorim përkufizimin e shkollarëve të OKB. Sipas Hans Georg Ehrhart dhe Albrecht Schnabel, "sektori i sigurisë përfshin të gjitha organizatat që kanë të drejtë të përdorin apo të urdhërojnë përdorimin e forcës ose të kërcënimit të përdorimit të saj, me qëllim që të mbrojnë shtetin dhe qytetarët e vet, sikurse edhe të gjitha strukturat civile që janë përgjegjëse për menaxhim dhe mbikëqyrje". Pra zbërthyer më konkretisht, sektori i sigurisë përfshin një gamë të gjerë aktorësh, të tilla si forcat e armatosura, shërbimet inteligjence, policinë e shtetit, drejtësinë, organizatat jo-qeveritare dhe media.

Dobishmëria e reformave në sektorin e sigurisë (SSR)

Reforma e sektorit të sigurisë ka dhënë një kontribut të vlefshëm në mbushjen e disa hendeqeve të hasura rëndom në konceptin tradicional të marrëdhënieve ndërm-

jet elitave drejtuese civile dhe strukturore ushtarake. Së pari, SSR nuk përcakton forcat e armatosura si të vetmet asete përgjegjëse në sigurimin e sigurisë kombëtare, po servir një koncept më të gjerë të një sektori të përbërë nga civilë dhe ushtarakë, të cilët duhet që të punojnë së bashku në emër të sigurisë. Së dyti, SSR merr në konsideratë misionet dhe rolet e përkohshme që mund të luajnë komponentët e sektorit të sigurisë në një ambient të caktuar. Koncepti gjithashtu trajton përfshirjen në iniciativa ndërkombëtare të agjensive të sigurisë, të

tilla si operacionet e mbështetjes së paqes (PSO), misionet policore në kuadër të OKB dhe BE, bashkëpunimin në fushën e anti-terrorit të agjensive të inteligjencës, etj. Së treti, konceptimi i SSR orienton qartësisht drejt thellimit të përpjekjeve për demokratizim, promovim të të drejtave të njeriut, parandalimit të konflikteve dhe rikonstruksionit post-konfliktual.

Marrëdhëniet civilo-ushtarake versus kontroll-efikasitet-eficencë.

Kontrolli civil demokratik trajton mënyrën sesi vendoset, zhvillohet dhe mbahet ky kontroll mbi një forcë të armatosur. Por përse të gjithë drejtuesit ashtu si dhe literatura e shumtë në këtë fushë i mëshojnë fuqimisht kontrollit të forcave të armatosura? Përgjigja vjen nga dilema klasike "Kush i ruan rojet? – Who guards the guardians?" Kontrolli është një çështje shumë e rëndësishme ndaj të gjithë aktorëve të sektorit të sigurisë, forcave të armatosura, policisë, përpos të tjerash, edhe ndaj shërbimeve inteligjente, të cilat për nga natyra e punës karakterizohen nga fshehtësia. Kjo bëhet edhe më e evidente po të analizojmë disa nga regjimet jodemokratike apo shteteve militare, në të cilat shërbimet inteligjente realizonin sigurinë e vendit, por edhe mbronin regjimet autoritare nga qytetarët e vet. Efikasiteti në realizimin e misionit dhe të detyrave përbën argumentin e dytë se përse kontrolli demokratik është i nevojshëm për institucionalizimin e marrëdhënieve të shëndosha civilo-ushtarake. Efikasiteti i institucioneve të sigurisë bazohet në analizimin e misionit dhe detyrave që ushtrojnë këto institucione. Institucionet e sigurisë në vendet demokratike realizojnë detyrat e tyre me qëllim realizimin e misioneve kushtetuese të renditura si më poshtë:

Mbrojtja e vendit në raste të konflikteve të jashtme të armatosura; lufta kundër kryengritjeve të brendshme dhe rebelimeve; lufta kundër terrorizmit botëror; lufta kundër krimit; mbështetje ndaj operacioneve humanitare; pjesëmarrje në operacionet e mbështetjes së paqes.

Më e vështirë bëhet çështja kur na nevojitet që të konceptojmë dhe të masim realisht shkallën e efikasitetit në fushën e sektorit të sigurisë. Ajo çfarë mund të jetë e matshme është sasia e aseteve ushtarake apo policore, numri i kontingjenteve të trajnuara, pajisjet e prokuruar, etj. Sidoqoftë, politikë-bërësit duhet të kenë parasysh se kërkesa për të qenë racionalë në analizat financiare sa u takon institucioneve të sigurisë, qëndron pashmangshmërisht përballë një analize të thellë dhe një perspektive strategjike në çështjet e sigurisë kombëtare.

Gjenerali Blasius Schemua, garant i Pavarësisë shqiptare

KOLONEL PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI
MSC AURORA GOLEMI

Shtatmadhori habzburgas feldmarshalli Schemua, ushtaraku madhor me origjinë slovene ishte ndër mbështetësit e parë të shpalljes së Pavarësisë Shqiptare. Kjo vërtetohet nga pritja që ai i rezervoi në 9 nëntor 1912 diplomatit Ismail Qemalit. Feldmarshalli ishte i pari autoritet monarkik, i cili ofroi garanci e siguri ushtarake për pavarësinë e shqiptarëve. Austro-hungarezët me dekret të veçantë ndaluan emigracionin e burrave si dhe daljen jashtë Monarkisë habzburgase në fillim të vitit 1912. Ata përgatitën për mobilizim 900.000 luftëtarë, që do të vendoseshin në kufi me Serbinë në gatishmëri për çdo të papritur. Ndërkohë dy ministrat e Jashtëm të Habzburgëve Leopold Berchtold si dhe ministri i Jashtëm Italian Markez San Guliano kishin marrë vendim: "Shqipëria-shtet i pavarur". Kjo ishte përcaktuar qartë në

marrëveshjen e Monzës "Mbi Shqipërinë", në formë notash diplomatike të shkëmbyera në 20.12.1900. Austro-Hungaria dhe Italia kishin ofruar mbështetje të karakterit politik, diplomatik dhe ushtarak. Gjithë veprimtaria diplomatike ishte e kamufluar dhe ishte vendosur midis këtyre dy fuqive të kohës se, bregdeti shqiptar nuk mund t'i falej ushtrisë serbe. Mbi hapësirën shqiptarë kishin interesa gjeopolitike si Austro-Hungaria ashtu edhe Italia. Feldmarshalli Blasius Von Schemua kishte marrë udhëzime dhe bekimin e Franc Jozefit Monarkut habzburgas 81 vjeçar për çështjen shqiptare. Perandori besonte në suksesin e tij ushtarak, politik dhe diplomatik. Në prag të pavarësisë si dhe në periudhën kur u shpall Pavarësia shqiptare Ministër i Luftës së Monarkisë austro-hungareze ishte gjeneral i Këmbësorisë, Moritz von Auffenberg. Ai e kreu këtë detyrë madhore nga 23 shtator 1911 deri në 12 dhjetor 1912. Pasues i tij në postin ministror ishte Field Marshall Alexandër von Krobotin. Von Krobotin e drejtoi Shtatmadhorinë për pesë vjet, nga



Frano Zefi (Perandori i Austro-Hungarisë Franz Joseph), mbrojtësi i katolikeve të Shqipërisë së verit, 1911




Blasius Schemua Gjeneral i Shtatmadhorisë

12 dhjetor 1912 deri 12 prill 1917. Feldmarshalli Blasius Von Schemua kishte lindur më 2 janar 1856, në Klagenfurt në Carinthia. Ai ishte biri i një ushtaraku të Monarkisë Austro-hungareze që kishte arritur deri në gradën ushtarake "Major" në ushtri. Schemua kishte marrë detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Perandorisë Austro-Hungareze në vitin 1911 pas shkarkimit të gjeneralit Franz Conrad i cili kishte pasur një mosmarrëveshje me perandorin Franz Josef. Shak ishte bërë një ballafaqim i mundshëm luftarak me shtetin italian. Ai u zëvendësua nga Blasius Von Schemua, vetëm për një periudhë të shkurtër. Dhe pikërisht kjo periudhë e shkurtër ka qenë fatlume për shqiptarët jo vetëm për takimin me kryetarin e ardhshëm të shtetit të parë shqiptar Ismail Qemal Bej Vlo- ra, por veçanërisht për mbështetjen për themelimin e shtetit shqiptar. Ka pasur një pakt të pashkruar si dhe një besë burrash shteti midis diplomatit Ismail Qemali dhe ushtarakut shtatmadhor Blasius Schemua. Takimi në shtatmadhorinë monarke në kabinetin e luftës ka qenë sinjali i parë real pozitiv për shtetin e ri shqiptar. Fillim nëntori i vitit 1912, përpara 101 vjetësh solli një klimë tjetër për Shqipërinë e shqiptarët, të cilët kishin luftuar shekuj me radhë. Gjeneralmajor Blasius Schemua ishte njeri i aksionit dhe i veprimit aktiv luftarak që para fillimit të luftës. Ai kishte kërkuar pushtimin e Fushë Kosovës, një trevë tërësisht shqiptare, që në shtator 1912 një muaj para se të fillonte lufta ballkanike. Synimi i ushtarakut madhor austro-hungarez me origjinë sllovene ishte që të mos lejonte bashkimin e Serbisë dhe Malit të Zi, që kërkonin një korridor përmes tokave shqiptare.

E ardhmja e Shqiptarëve është e siguar

Mendimi dhe veprimi intelektual që çoi në aksionin politik të Ismail Qemalit, Hasan Vuçiterna Prishtinës, Nexhip Dragës, Shahin Kolonjës dhe patriotëve të tjerë shqiptare në parlamentin osman "lëkundën" sundimin osman në Shqipëri. Në vitin 1912 ishin 26 deputetë që përfaqësonin gjithë hapësirën shqiptare në Parlamentin osman, por jo tërë hapësirën e Shqipërisë. Pjesë e aksionit politik dhe diplomatik ishte takimi me personalitete politike, diplomatike dhe ushtarake të kalibrit më të lartë të fuqive vendimmarrëse. Këtu shpaloset ai aksion politik, që e bën pavarësinë një "veprim të meçur e një punë plotësisht të pjekur". Ismail Qemali u nis nga skela e Stambollit më 2 nëntor 1912. Ai realizoi mbledhjen e njohur me koloninë e shqiptarëve të Bukureshtit më 5 nëntor 1912; ndërsa më 9 nëntor 1912, Feldmarshalli Blasius Schemua do të priste iniciatorin e lëvizjes politike dhe kryeministrin e parë shqiptar Ismail Qemali në kabinetin e tij të luftës. Feldmarshalli Blasius Schemua kishte kërkuar që synimet e tij t'i shpallte hapur duke ngulur këmbë në realizimin praktik të synimeve austro-hungareze, që në këtë rast synimet dhe interesat e të dy palëve ishin të përbashkëta me ato të shqiptarëve. Për këtë ai kishte në gatishmëri afërsisht një milionë ushtarë. Austriakët kishin ofruar përmes Kontit Leopold Berthold "një bajonetë austriake për të vendosur flamurin shqiptar". Në 10 nëntor 1912 një ditë pas takimit të Ismail Qemalit me Feldmarshalli Blasius Schemua gazeta "Az Est" shkruante: "Udhëtimit të Feldmarshallit Blasius Schemua në Budapest po i jepet shumë rëndësi, pasi shefi i Shtatmadhorisë priti

dje udhëheqësin shqiptar, Ismail Qemalin, i cili e informoi për gjendjen në Shqipëri". Në të njëjtën ditë Feldmarshalli Blasius Schemua do të shënonte në ditarin e tij shqetësimin zyrtar austriak se, "një shtet serb në Adriatik mund t'i shtrinte dorën Italisë në çdo kohë..". Është fakt se menjëherë pas takimit të Ismail Qemalit me shefin e Shtatmadhorisë austro-hungareze Gjeneralmajor Blasius Schemua, Kryetari i ardhshëm i shqiptarëve do të drejtohej tek zyra e telegrafës dhe do të niste një telegram në frëngjisht drejt zyrës telegrafike të Bashkisë së Vlorës, që thoshte: "Arrij me anijen e parë. E ardhmja e Shqiptarëve është e siguar", që ishte një lajm i madh për shqiptarët me sy e veshë nga shpëtimtari diplomat i kombit Ismail Qemal Bej Vlo- ra. Shtatmadhori austro-hungarez do të siguronte beun e Vlorës se, pavarësia e Shqipërisë është e mbështetur plotësisht nga Monarkia habzsburgase. Por gjithë linja ushtarake austro-hungareze gjykonte se ishte e gatshme që të hynte edhe në luftë me Italinë nëse ajo nuk pranonte interesat që kishte Monarkia habzsburgase në Shqipëri. Do të ishte në interes të Austro-Hungarisë që të ruhej feja dhe kombësia, sepse Monarkia austro-hungareze ushtron protektoratin mbi një pjesë të popullsisë dhe se ajo është e angazhuar hapur në këtë të fundit, që ka të bëjë me humbje prestigji...shqiptarët të mbahen afër që të mos shkojnë në krahët e serbizimit. Mendimi monarkik austro-hungarez mbi Shqipërinë e ardhshme ishte se, "Shqipëria nuk mund të jetë zvogëlohet aq sa të humbë ekzistencën e vet.. limani i Vlorës në "altra sponda" është çelësi i detit Mesdhe.. ne nuk mund të pranojmë që Vlo- ra të shkëputet nga trugu i Shqipërisë. Ndërkohë qëndrimi rus ka qenë shumë përbuzës: "..ne as na ngroh e as na ftoh çështja shqiptare. Asnjë popull nuk na intereson më pak se ai". Akoma më thellë shkonin francezët: "Rusët e francezët nuk do të toleronin krijimin e një Turqie të vogël nën protektoratin italian". Pra Ismail Qemali me vetëdije të plotë kishte hyrë në axhendën e diplomacisë dhe prapaskenave historike të Fuqive të Mëdha kur kishte nisur takimet e tij në Vjenë, në kërkim të "Vatanit arnavut" dhe njerëzve të tij "të padisiplinuar, që gjendeshin midis Serbisë dhe Greqisë", që në fakt ishin në kërkim të së drejtës historike. Gjeneral Shemua do të mbështeste idenë e Ismail Qemalit për Shqipërinë natyrale; ndërkohë që lobi greko-serb mohonte krejt Shqipërinë. Grekët thoshin se, "është e pamundur të lejohen shqiptarët barbarë të jetojnë të pavarur në djepin e qytetërimit grek"; ndërkohë që shqiptarët ishin autoktonë përpara të gjithë popullsive të tjera të ardhura në Ballkan, teza që vërtetohej plotësisht nga albanologë të huaj dhe që e mbronin këtë në mënyrë shkencore. Nga ana tjetër Serbët e Pashiqit nuk lanë "gurë" pa lëvizur e veprim diplomatik, por dhe ushtarak, që bënin që të vërtetohej në atë që, "zemra e qytetërimit serb na qënk- ish dalja në portin e Durrësit dhe të Shëngjinit"; dhe se platforma më antishqiptare ishte ajo e gjeneralit serb Janakoviçit shprehej: "paqja më efektive në Shqipëri mund të arrihet vetëm duke shfarosur shqiptarët". Por në kohën kur në krye të shtatmadhorisë austro-hungareze ishte Feldmarshalli Von Shemua erdhi edhe përgjigjja e hapur austro-hungareze: "ne jemi kundër depërtimit të ushtrisë së aleancës Ballkanike në tokat shqiptare sikurse jemi kundër ndarjes së Shqipërisë". Përpjekjet



Ministri i Jashtëm italian, Antonino di San Giuliano (majtas) dhe ai austriak Leopold Berchtold, tetor 1912

diplomate të Përfaqësuesve të qeverisë së Ismail Qemalit si Mehmet Bej Konica, Filip Noga dhe Rasip Dino si dhe mbështetja austro-hungareze bënë që Shqipëria të triumfoje pjesërisht, duke krijuar shtetin me status si dhe kufijtë në 50% të Shqipërisë natyrale në 29 korrik 1913. Mund të konsiderohet sukses i cinguar përballimi i furisë dhe urisë së monarkive ballkanike dhe djallëzive të Fuqive të Mëdha të prirura për të dhënë shpërblim grekëve, serbëve e malazezve nga trojet shqiptare, por edhe të plotësonin interesat e tyre të afërta dhe të largëta.

Ismail Qemali: “Flamurin e kam por nuk kam shtizën ku ta naltoj..”

Austro-hungarezët: “Për shtizë të flamurit tuaj keni merrni një bajonetë austriake”

Pas prishjes së statusqu-osë në Ballkan në axhendën monarkike habsburgase ishte vendosur faktikisht, për “Shqipërinë autonome ose të pavarur, por me kusht që të vihej në veprim nga faktori i brendshëm shqiptar”. Shqiptarët janë mirënjohës për të gjithë ata burra që i kanë shërbyer Shqipërisë. Ata ngelen miq të përherëshëm të saj që meritojnë nderim dhe respekt, meritojnë mirënjohje të të gjithë kombit shqiptar. Tashmë nga analizat historike dhe dokumentare është vërtetuar se, në “turin evropian lotues të Ismail Qemal Vlorës takimi i parë në Vjenë me Feldmarrshallin Blasius Schemua mori rëndësi vendimtare historike”. Kështu sapo ka dalë nga takimi me Shefin e shtatmadhorisë Austro-Hungareze, Feldmarrshallin Blasius Schemua, diplomati mendjemprehtë Ismail Qemali shkruan një

telegram për Vlorën. Ja përmbajtja e tij: “Përpara së premtes jemi në Durrës. Të mbledhurit e Delegatëve në Durrës ose Vlorë është krejt i nevojshëm. I ftoni të gjithë, deri sa të vij unë mbani qetësinë dhe bashkimin. Çështja jonë politike u sigurova fare”. Por në fakt takimi me autoritetin më të lartë ushtarak austro-hungarez dhe as premtimi për “naltimin e flamurit shqiptar në një bajonetë austro-hungareze”, nuk mjaftonte. Kështu mendja e diplomatit mendjehollë shqiptar punonte vrullshëm duke shkuar në gjykim aspektet politike, ushtarake, diplomatike dhe ekonomike të shtetit të ri shqiptar. Kështu më 13 nëntor 1912 Ismail Qemali mori një ftesë nga konti Andrassy. Ismail Qemali u nis menjëherë dhe shkoi në Budapest, ku takohet me kontin Janos Hadik ish-nënkretar shteti. Në të njëjtën vilë në një mbrëmje nëntori takohet me një personalitet të diplomacisë botërore të kohës; me kontin Leopold Berchtold Ministrin e jashtëm të Austro-Hungarisë, nga njerëzit më të fuqishëm të diplomacisë evropiane. Po në 13 nëntor 1912 ish-ministër i Brendshëm i Austro-Hungarisë do shprehej: “Pavarësia e Shqipërisë është në interes të rangut të parë për Monarkinë tonë..”, ndërsa konti

Berchtold duke u shprehur për çështjen shqiptare shprehej: “nëse si Ministër i Jashtëm Austriak do të nënshkruante një deklaratë të tillë (që Serbia të kishte dalje në Adriatik) meritonte të vritej”.

Për çështjen shqiptare garant një milionë ushtarë austro-hungarezë

Në fakt kishte ardhur “ora e Shqipërisë”. Prandaj edhe njoftimet dokumentare bëjnë të ditur se Ismail Qemali ju drejtua me kompetencën e një burri shteti me diplomaci kontit Berchtold, austro-hungarezit që në fakt nuk kishte besim absolut tek bashkëbiseduesi: “Flamurin e kam por nuk kam shtizën ku ta naltoj dhe flamurin pa shtizë e merr çdo erë që mund të fryjë në Ballkan. Përgjigjja e kontit Bertold ishte e prerë dhe e drejt-përdrejtë: “Ismail Bej, për shtizë të flamurit tuaj keni merrni një bajonetë austriake”. Pas takimit me shefin e diplomacisë së Vjenës e Budapestit Berchtold, Ismail Qemali përsëri do t’i shkruante Vlorës, por kësaj here edhe më fort si edhe më i kthjelltë: “E ardhmja e Shqipërisë është e siguruar. Telegrafoni kudo të kenë besim të plotë për fatin e atdheut”. Takimet e Ismail Qemalit që nisën me feldmarrshallin Blasius Von Schemua, i cili kishte në gatishmëri “për çështjen shqiptare një milionë ushtarë”, përfunduan me bisedimet me Berchtoldin, i cili në një farë mënyre dha autorizimin përfundimtar për të ngritur flamurin. Në 101 vjet të shtetit shqiptar shikimi i historisë realisht dhe nën dritën e dokumenteve të reja bën që të rivlerësohet kontributi austro-hungarez për pavarësinë e shtetit të parë shqiptar.

Procesi i udhëheqjes si sfidë ndaj modelit individual

MAJOR MSC. FESTIM ALIMADHI

Për liderin dhe formimin e tij, është folur që në kohën e Greqisë së lashtë nga Platoni, i cili përshkruan rrugën që duhet të ndjekë Mbreti Filozof, virtytet që duhet të zotëroj ky mbret për të qenë një udhëheqës i zoti dhe i dashur nga populli. Por përveç virtyteve ai ka dhe vese, për të cilat ai duhet të ketë edukimin sa më të mirë me vlerat morale të shoqërisë. Prej më shumë se 20 vjetësh në fjalorin e shqipes ka hyrë dhe po qëndron me themele të forta fjalët Lider dhe Leadership. Nëse do të përdornim fjalë më shqip, do të kishim Udhëheqës dhe Udhëheqja, fjalë të cilat kanë qenë më të përdorshme në fushën e politikës gjatë 100 vjetorit të ekzistencës së shtetit shqiptar. Duke mos u futur në analizë gjuhësore, Lideri dhe Leadership, pra individit dhe procesit të udhëheqës, ka qenë dhe mbetet subjekt i studimeve të thelluara në shkollat e menaxhimit të burimeve njerëzore veçanërisht, ose menaxhimi i burimeve njerëzore është pjesë e shkollave të menaxhimit të burimeve, sikundër edhe në institute kërkimore shkencore anembanë botës. Janë të shumta publikimet në lidhje me procesin e leadershipit dhe vlerat që duhet ta karakterizojnë një lider. Por gjithashtu ka dhe shumë keqkuptime në zberthimin e procesit të leadershipit dhe menaxhimit, duke krijuar një ngatërresë midis Menaxherit dhe Liderit, të cilat në përmbajtje dhe proces nuk janë e njëjta gjë. Në këtë analizë nuk dua të përsërisë ato që janë shkruar (dhe ku kopjuar si plagjiaturë) në lidhje me cilësitë dhe virtytet që duhet ta karakterizojnë një lider, por do përqendrohëm në atë që nuk duhet të karakterizoj një lider, sidomos një ushtarak në çdo shkallë të hierarkisë drejtuese – komanduese. Por para se të trajtoj këtë element të rëndësishëm të formimit dhe procesit të leadershipit, mendoj se është e nevojshme të shpjegoj ndryshimin midis Liderit dhe Menaxherit. Lideri konsiderohet si tregtar i shpresës, shitës i një vizioni të dallueshëm në imagjinatën kolektive të ndjekësve të tyre, përbashkues dhe tërheqës i tyre në një aven-

turë të madhe. Lideri frymëzon ndjekësit, nxit dhe motivon ndjekësit për të arritur së bashku vizionin e liderit. Ndërsa thelbi i leadershipit është aftësia për të dalluar dhe përdorur ato modele motivuese që i nxisin njerëzit, të cilët vullnetarisht bëjnë gjëra të cilat në rrethana dhe kushte të ndryshme nuk do ti bënin. Kjo nënkupton që njerëzit normal të mbeten normal në situata dhe ngarkesa jonormale të punës. Ndërsa Menaxheri është personi i cili realizon punën siç duhet, duke arritur të koordinoj burimet materiale, financiare, njerëzore duke i përdorur në njësinë e kohës sipas rregullave të caktuar më parë e të njohura prej tij.

Sindromi (ose kompleksi) i Kontit të Montekristos

Do trajtojmë vesin të cilin shkollat e trajnimit mbi leadershipin e kanë etiketuar si Sindroma i Kontit të Montekristos ose si Kompleksi i Kontit të Montekristos. Në vendin tonë deri tani kjo sindromë ose kompleks deri tani nuk është trajtuar në fushën e burimeve njerëzore sidomos në Forcat e Armatosura, ku jo vetëm në literaturën dhe materialet në përdorim por dhe në kurset arsimore, kualifikuese dhe trajnuese, nuk flitet dhe trajtohet ky problem. Madje do të thosha se për pjesën më të madhe të atyre që po lexojnë artikullin (në mos për të gjithë) ky element do të jetë tërësisht i ri. Por para se të zberthej sindromën në fjalë, le të sjell në vëmendjen e lexuesve shkurtimisht historinë e Kontit të Montekristos, duke e bërë më të kuptueshme sjelljen e liderëve (sidomos ata ushtarakë) të cilët kanë në sjelljen e tyre këtë sindromë ose kompleks. Duke qenë se në Shqipëri ky është një roman i njohur si dhe është realizuar film nga disa regjisor, përsëri po e përsërisim për ta kuptuar më mirë. Konti i Montekristos është personazhi i librit me të njëjtin titull të autorit francez Aleksandër Dyma, i shkruar në dy pjesë në vitet 1844 dhe 1846. Historia flet për një marinar 19 vjeçar të quajtur Edmond Dantes, të cilin tre shokë të tij, një bankier, një prokuror dhe një oficer e kishin zili. Ata i ngrenë kurth Dantes, duke e akuzuar si mbështetës të Bonapartit i cili u përzua në ishullin e Shën Helenës. Ai dërgohet pa dijeninë



e tij në kështjellën në ishullin e Iftit. Aty ai njihet me abat Farian (prift në një shkallë të caktuar të hierarkisë fetare) i cili ishte një erudit në fusha të ndryshme, si ekonomi, politikë, sociologji e filozofi. Ai i jep Dantes 20 vjeçar një edukim të shkëlqyer në fushat e mësipërme, duke i dhënë dhe hartën e një thesari sekret nëse do dilte i gjallë që aty. Dantesi duke ndërtuar me logjik se ç'farë i kishte ndodhur nën këshillimin e abatit krijoi idenë e plotë për fajtoret të cilët duhet të paguanin dëmin e shkaktuar. Ai arrin të arratiset nga ishulli i Iftit ditën që abati vdiq, duke u futur në thesin që do flakej në det me trupin e abatit. Kishte kaluar 21 vjet internim në këtë ishull. Atë e gjejnë disa peshkatarë dhe së bashku me ta arrin të gjej thesarin, duke u bërë i pasur. Ai blen ishullin e Montekristos, duke marrë titullin Konti i Montekristos. Ai kthehet në Paris ku duke përdorur dijet e veta, si dhe duke paguar nën dorë, gjen disa miq të vjetër dhe arrin të shkatërroj ish-shokët e vet të cilët i ngritën kurthin. Tashmë ish-prokurori i ri ishte bërë Prokuror i Përgjithshëm i Francës. Bankieri ishte bërë një bankier i madh. Ndërsa shoku i vet oficer, ishte bërë gjeneral dhe ishte zgjedhur deputet në parlament. Ai ishte martuar me ish të fejuarën e tij, Mercedesin. Dantesi tashmë 43 vjeçar, hakmerret duke u gjetur pikat e dobëta këtyre njerëzve që i kishin shkatërruar jetën, fshehurazi arriti të shkatërroj dhe të realizoj hakmarrjen e vet që e priste prej 23 vjetësh. Madje në këtë histori përmendet dhe Ali Pasha Tepelena, i cili ishte tradhtuar nga oficeri francez, i cili tashmë ishte martuar me ish të fejuarën e Dantesit. Kjo është pak a shumë historia e treguar shkurt për të na dhënë një ide në lidhje me Kontin e Montekristos. Shumë kërkues në fushën e studimeve të liderit mendojnë se liderët që kanë këtë sindromë, nuk kanë qenë fëmijë me fat. Pra ky sindromë ose kompleks fitohet që në vegjëli. Për pasojë kur ata rriten do kenë gjurmë ndjenjash humbjeje, pasigurie dhe pamjaftueshmërie. Problemet që mbarten nga fëmijëria e hershme gjenerojnë ndjenja turpi, faji, përlulësie, inati, zemërligësie, dëshirë për hakmarrje, etje për pushtet dhe status personal në shoqëri, të cilat në moshë madhore mund të përfaqësohen në forma shkatërruese. Duke qenë se kanë pasur inferioritet në shoqëri për shkak të këtyre ndjenjave ata zhvillojnë një ndjenjë të ekzagjeruar vetë-rëndësie dhe vetë-madhështie, e shoqëruar madje me admirim. Kjo shndërrohet më vonë në një fiksion për çështje pushteti, të statusit shoqëror, të prestigjit dhe superioritetit. Për ta jeta dhe puna kthehen në një lojë

me fitues dhe humbës. Ata janë të shqetësuar për të qenë të parët. Shpesh nxiten drejt suksesit nga nevoja për tu hakmarrë ndaj injorimeve të perceptuara dhe të përjetuara në fëmijëri. Këta lloj liderësh konsiderohen narcisë dhe nuk janë të gatshëm të ndajnë pushtetin. Madje në të kundërt me parimet e liderit, ata rrethojnë veten me njerëz që binden për gjithçka. Mostolerimi i kundërshtimeve dhe varfëria e përbaljes me kritikën, bën që liderët të tillë rrallë të konsultohen me kolegët, duke preferuar t'i marrin vetë të gjitha vendimet. Edhe kur konsultohen me të tjerë kjo bëhet sa për ritual ose siç thotë populli sa për sy e faqe. Ata pëlqejnë t'i përdorin të tjerët si kor-orkestre, presin që ndjekësit të bien dakord me gjithçka që ai sugjeron. Këta lloj liderësh mësojnë pak ose aspak nga pësimet e tyre. Kur konstatohen mangësi ai nuk merr përgjegjësi personale; më mirë flijojnë një nga organizata/struktura duke ua lënë atyre të gjithë fajin. Ai mund të jetë mizor dhe verbalisht abuzues ndaj vartësve të tij. Edhe kur gjërat shkojnë mirë, por dhe kur nuk shkojnë mirë, është i prirë të shpërthejë në zemërim. Në këto shpërthime inati vërtetohet një sjellje fëmijërore, e cila e ka origjinën në ndjenjat e hershme të pazotësisë dhe përluljes. Meqenëse kanë një pushtet të atillë, impakti i zemërimit të tyre mund të jetë shkatërrues dhe i frikshëm për ndjekësit, të cilët nga ana e vet zbrapsen nga këto sjellje. Njerëzit në pozicione inferiore, gjithnjë shpresojnë të marrin pak nga pushteti i agresorit. Për fat të keq, gjithçka që arrijnë të sigurojnë është vetë-shndërrimi në agresorë, duke rritur në këtë mënyrë sasinë totale të të agresivitetit organizativ/strukturor. Pikërisht liderët (edhe ata ushtarak) të cilët kanë shfaqur këto elemente në historikun e tyre të arsimimit dhe punës, konsiderohen se zotërojnë sindromën ose kompleksin e Kontit të Montekristos. Shumë veta e konsiderojnë këtë lloj sjellje me etiketimin si Makiavelizëm. Kjo vjen nga shprehja e Makiavelit se "Qëllimi justifikon mjetin". Me termin makiavelizëm nënkuptohet "përfitim i pamëshirshëm dhe hileqar, veçanërisht në politikë. Po ashtu termi Makiavelik që etiketojmë ndonjë person, nënkuptojmë personat që nxjerrin në pah dinakërinë dhe mungesën e çdo lloj skrupulli në marrëdhëniet zyrtare në punë dhe ato shoqërore. Por sikundër Makiaveli e ka thënë vetë "se asgjë nuk është më e dobët dhe më e paqëndrueshme, sesa fama e pushteti, kur ky pushtet dhe kjo famë nuk është fituar me aftësi dhe drejtësi". Njerëzit e mençur e dinë këtë gjë dhe duhet ti qëndrojnë besnik këtij parimi.

